


81H32

T 91



TE

# TREGIME ZGJEDHURA

85A-32

791

BIBLIOTEKA E RINISË

Tregime të zgjedhura

32.25

~~45067~~

~~BIBLIOTEKA E RINISË~~

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»



## NJË BETEJË PA ARMË

— Tregim i jetuar —

Nënë Emineja po gatuante brumin për një byrek, kur Nuria u kthye nga shkolla dhe, pa folur fare, ngjiti shkallët e drunjta.

— Ç'të ketë ndodhur me Nuriën? — pyeti nëna veten dhe nuk priti por i hodhi një napë të bardhë tepsisë dhe u ngjit lart. Ajo shtangu në vend kur pa Nuriën, që kishte rënë përmbys në shilte, në qoshe të dhomës, dhe po qante. Tërë dhembshuri u përkul mbi të bijën dhe i foli me zë të ëmbël:

— Ç'pate, moj Nurie? Pse qan? Me kë je zënë?

Nuria zuri të shfrente më me duf.

— Mos je e sëmurë? Tregoi nënës tënde!

— Ti nënë! Ti! Ti me Qemalin...! — filloi të flasë Nuria, me sy të përlotur.

— Folë, moj bijë, ku e ke hallin.

— Pse ma keni fshehur gjer më sot? Shoqet më treguan. E pashë së largu tek po kalonte mbi një kalë.

— Për atë punë qenke hidhëruar? Ja ku po ta them. Atëhere ke qenë e vogël, nuk i kishe

mbushur të tre vjetët. Tani që je rritur mësoje se të kemi fejuar me Riza Shpatin e Drizës.

Nuria e mblodhi veten dhe ju drejtua së ëmës!

— Për ty, nënë, është më shumë turp se për këdo në shtëpinë tonë, kjo që po më tregon.

— Turp, the? Ë ç'turp qenka për nënën që të fejojë vajzën? Përkundrazi është gëzim.

Nuria e dëgjonte me vëmendje nënën dhe nuk dinte të dallonte nëse i ndjente ato fjalë që thoshte apo fliste se ashtu e donte puna!

— Më fal, moj nënë, se po të bëj edhe një pyetje. A e ke parë ndonjëherë Riza Shpatin, që do të jetë burri im?

— Nuk e kam parë, por kjo s'ka rëndësi.

— Rizai është dyzet e kusur vjeç dhe unë, s'i kam mbushur të trembëdhjetat. Mos doni të më martoni me konakët, me tufën e dhenve të Shpatajve? Ja ku po ta them, unë nuk do të bëhem gruaja e tij.

Nëna e turbulluar nga mendimet e së bijës, i tha se ashtu e donte zakoni i vendit e se po ta merrte vesh këtë gjë Qemali, s'dihet se ç'mund të bënte. Nuk ishte dëgjuar gjer asokohe, në tërë atë krahinë të kishte kundërshtuar një vajzë të fejuarin.

— Unë do të jem e para! — ja preu shkurt Nuria.

Nëna u shkreh në vaj. Por Nurien nuk e mposhtën lotët. Ajo i tregoi së ëmës se ëndërronte të vazhdonte shkollën, se nuk e kishte mendjen te martesja dhe se shokun e jetës do ta zgjidhte vetë.

Nënë Emineja e kuptonte se vajza kishte të



drejtë, por zakonet e maleve ishin të rrepta. Prandaj donte me çdo kusht që edhe Nuria, ashtu si vajzat e tjera, t'i zbatonte edhe pse Riza Shpati e kishte ngrënë livadhin e vet.

1.

Keq i shkoi gjithë ajo ditë edhe Nuries. Sa dolën në oborrin e shkollës, për pushimin e madh, njëra nga vajzat e klasës së shtatë, i tha një shoqes së vet:

— A e sheh atë burrin që po kalon atje poshtë me kalë? Është i fejuari i Nuries. Por shët, mos e përfolë. Nuria nuk di gjë për këtë.

— E shkreta Nurie! Ai qenka më i madh se babai im!

Shoqja e tërhoqi për dore.

— Më duket se na dëgjoi Nuria!

Dhe me të vërtetë Nuria diçka kishte dëgjuar. Ajo u hodhi një shikim të vrazhdë shoqeve dhe iku e menduar. Shoqet e kuptuan dhe ju qepën pas. I kërkuan të falur.

Nuria i hodhi një vështrim njeriut që po kalonte me kalë. I pa vetëm shpinën. Zemra ju mbush plot vrer.

Nuria përpiqej ta përqendronte vëmendjen në librin e historisë por më kot. E la librin mënjanë dhe e shtrirë nisi të mendojë.

...«Mirë është të mos e çoj më gjatë këtë punë. Të mbaroj njëherë shkollën, pastaj duhet të veprojmë! Lutje për të vazhduar shkollën pedagogjike nuk mund të bëj, por do ta gjej mënyrën se si t'ja arrij qëllimit. Këtu ka shokë të partisë



dhe të pushtetit, që do të më ndihmojnë mua, një bareshë nga malësitë e veriut, të bëhem mësuese».

Me këto mendime Nuriën e zuri gjumi.

Të nesërmen, ajo bëri sikur nuk i kishte ngjarë asgjë. U ngrit herët, e ndihmoi nënën të milte dhentë, hëngri mëngjezin dhe u nis për në shkollë. Nënë Emineja, duke e vënë re këtë gjë, u gëzua shumë.

### 3.

Kalonin ditët, javët dhe muajt. Gjatë pushimeve të verës, Nuria u ngjiti në bjeshkë. Me vete mori edhe libra për të lexuar si «Afërdita përsëri në fshat», «Si u kalit çeliku» etj. Përveç romaneve lexonte edhe «Zërin e popullit», që i vinte një fqinjit të tyre. Me romanet dhe gazetatat, asaj i dukej sikur bisedonte, sikur këshillohej.

... Në fillim të shtatorit Nuria zbriti në fshat dhe të nesërmen u nis për t'u paraqitur në shkollë. Kur po ecte, rrugës i doli përpara Qemali.

— Dëgjomë mua, Nurie! Ti në shkollë do të shkosh vetëm sa të shpëtojme nga gjobat, një ditë po dhe dy ditë jo! Për mësimet e di vetë. Nuk të duhen gjë. Mësimet e tua janë dhentë, furka dhe punët e shtëpisë. A e kuptove? Vuri në mend këto porosi! Ti jep vëllai, që të do të mirën!

Nuria u mërzit shumë. Një pengesë tjetër i doli papritmas në rrugën e saj. Duhej kapërxyer.

Një natë Qemali hyri në dhomën e saj dhe, kur e gjeti duke lexuar, tërë inat ja mori librin e ja përplasi në fytyrë.

— Edhe natën lexon ti? Mos të të shoh më se do të të kalb në dru. Të kam thënë një herë se shkolla nuk të hyn në punë! Sa të mbushësh moshën dhe të pret burri në Drizë!

Nuria qau gjithë natën.

Nuk shkuan as tre muaj kur në të hyrë të pranverës, nga Driza erdhën dy thasë me lesh.

— Të ka ardhur punë, moj bijë, — i tha nënë Emineja.

— E ç'punë është kjo! Unë kam librat, kam shkollën, kam dhentë. Ktheje leshin në Drizë.

Nënë Emineja u mërzit dhe filloi ta kërcënonte me hijen e Qemalit. Nuria i mori thasët me lesh dhe i nxori nga shtëpia. I rrokullisi në përrua.

Kjo i ra në vesh Qemalit. Filloi shamata në shtëpi. Nisën kërcënimet. Nuria nuk do ta kishte të gjatë jetën, se, Qemali nuk do ta linte të motrën të koriste fisin e malësorëve rrëzë Shkëlzenit.

Filluan t'i flasin edhe shokët Qemalit, por, siç thotë populli, «Njëqind sëpatë, një ashkël nuk ja hiqnin». Nuria e nuhati gjendjen dhe vendosi të heshte.

Vendimin e saj të vërtetë e dinin vetëm dy shoqe, Shpresa me Hazizen, që e ndihmonin rregullisht për të mos ngelur pas shoqeve në shkollë.

#### 4.

Dhe kështu rrodhi koha. Për Nuriën beteja e provimeve të klasës ishte e lidhur me betejën për të shpëtuar nga kthetrat e «Ujikut të Drizës», siç thoshin Shpresa me Hazizen.



U përpoq mjaft Qemali ta pengonte të motrën për t'u përgatitur për provimet e klasës së shtatë, por pa dobi. Ajo kaloi me nota të mira.

Qemali, porsa dha provimin e fundit, e ngjiti lart në bjeshkë të motrën, bashkë me një vandaq rroba për të punuar. Ishin rrobat që kishte dërguar dhëndrri.

Ajo nuk kundërshtoi. Para se të shkante në bjeshkë, u la porosi Shpresës dhe Hazises: «Po të ndryshoj data 27, më çoni fjalë». Kuptimin e këtyre fjalëve e dinin vetëm ato.

Në bjeshkë punoi e qetë. Shkonte me dhen, filloi të thurte edhe triko se mund t'i duheshin për në shkollë. Ato ditë gushti, nën Emineja kishte zbritur në fshat. Kjo e lehtësoi Nurien për të zbatuar planin e saj. Shpresa me Hazizen i dërguan letër:

— Kishim dëshirë të të shihnim, para se të largoheshim, por ti je në bjeshkë. Më 27 të këtij muaji mblidhemi në qytet. Mirupafshim.

Nuria priste datën njëzeteshtatë gusht dhe ajo erdhi. Atë ditë, në mëngjes, u zgjua shpejt. U tha atyre të shtëpisë se do të zbriste në fshat për të marrë disa plaçka. U nis nëpër pyll. Afër drekës arriti në qytet. Shpresa me Hazizen, e prisnin. Dhe pa bërë as një as dy u nisën për në seksionin e arësimit.

Shefi i priti mirë dhe i dëgjoji me vëmendje. Kur mësoi se ajo kërkonte bursë për shkollën pedagogjike, i tha:

— Mirë, moj vajzë, por ti as lutje nuk ke bërë.

— Unë dua të shpëtoj. Dëshira për shkollë nuk më mungon. Pyetni mësueset.



Kërkesa e Nuries u muarr parasysh. Të nesërmen ajo — bashkë me shoqet dhe shokët zuri vend në autobuz dhe u nis për në Shkodër.

Ndërsa maqina po merrte kthesën në një rrugë të qytetit, ajo vuri re Qemalin, që vraponte për t'i dalë përpara. Por Shpresa me Hazizen u ngritën në këmbë dhe i thanë shoferit:

— Jepi, mos qëndro, se ashtu është puna!

... Qemal Gurra desh u çmend për lodrën që kurdisi motra e vogël. Shkoi tek e motra e madhe që e kishte të martuar në qytet dhe i tregoi planin që kishte thurur.

— Me çdo kusht Nurien duhet ta kthejmë këtu. Ta gënjejme se gjoja nëna është shumë e sëmurë. Pastaj, presim ca ditë dhe e çojmë te burri.

Edhe e motra e aprovoi kurthin, se Nuria sipas saj kishte koritur tërë krahinën, kishte prishur besën e babait.

Qemali shpresonte të realizonte planet, kurse Nuria vazhdonte e qetë mësimet në shkollë. Ajo u kishte hapur zemrën shoqeve dhe shokëve, pedagogëve, njerëzve të partisë. Dhe të gjithë nuk u kursyen për ta ndihmuar. Kështu plani i Qemalit dështoi.

## 5.

As letër, as lajm nuk merrte Nuria nga fshati. Në pushimet verore ajo qëndroi në shtëpinë e fëmijës në Shkodër. Kishte vendosur me çdo kusht të mbaronte shkollën. Më të rrallë, nënë Emineja i shkruante nga një pusullë me ndonjë nxënës dhe ja dërgonte fshehurazi Qemalit me njerëz të besuar.

— Pa tjetër atje do të kthehem, do të shkoj e do të punoj si mësuese për përparimin e mëtejshëm të malësisë sonë, thoshte me vete.

— Erdhi edhe koha për t'i lënë lamtumirën Shkodrës, shkollës pedagogjike «Shejnaze Juka». Nuriën e thirrën në drejtori.

— Në cilin rreth, dëshiron të punosh?

— Në krahinën time, në bjeshkët e Shkëlzenit!

— Po, atje mund...

Nuria i ndërpreu:

— Atje dua ta shpie gjer në fund luftën time për të renë. Mos kini frikë, asgjë nuk do të më ndodhë.

Pas disa ditësh, Nuria, bashkë me shoqet e saj, mësueset e reja të malësisë, hypi në maqinë për në rrugët e largëta të veriut.

...Në qytetin e ri, në mes të maleve, Nurie Gurra filloi të jepte mësim për bijtë e malësorëve. Krahas mësimit ajo filloi edhe luftën kundër së vjetrës që po shembej, po që nuk dorëzohej lehtë.

Luftën e saj e përkrahnin shumë. Por kishte edhe nga ata që thurrnin lloj-lloj shpifjesh për mësuesen e re. Nëna dhe motrat zbrisnin fshehurazi në qytet për të takuar Nuriën, ndërsa i vëllai jo. Ai ngulte këmbë që Nuria të bëhej grua ja e Riza Shpatit. Edhe Rizai nuk hiqte dorë nga e tija, megjithë përpjekjet e shokëve për ta bindur.

Pas dy vjetësh u arrit që Nuriën ta pranonin në shtëpi. Ajo u gëzua shumë, sepse ju dha mundësia të jepte mësim në fshatin e saj. U gëzuan



edhe fshatarët. Vetëm Qemali rrinte gjithnjë i zemëruar dhe nuk i fliste së motrës.

— Do të bindet! — i thoshte Nuria së ëmës.

Nuria e nisi me zell punën në fshat. Ajo ishte aktiviste e shquar e shtëpisë së kulturës. Çdo pasdreke shkonte në ara, ku punonin të rejat e fshatit. Punonte me kazëm a me bel dhe në pushim bisedonte me to. Ajo shpejt u hyri në zemër edhe pleqve e plakave. Gjithshka kishte mësuar në shkollë dhe në jetë, gjatë atyre viteve në Shkodër, përpiqej t'ua jepte njerëzve të fshatit. Ajo zhvillonte edhe kursin e ekonomisë shtëpiake dhe atë të rrobaqepsisë me të rejat e fshatit. Ajo ishte edhe këngëtare në estradë edhe aktore në teatër. Me punën dhe sjelljen e saj, Nuria bëri të shkrinin si vesa thashethemet e gojëkëqinjve.

Në vitin e dytë që ishte mësuese në fshat, ajo njohu për së afërmi Agim Krastën, një bashkëfshatarin e saj që punonte në një minierë aty afër. Të dy e pëlqyen njeri tjetrin. Agimit i folën mirë për Nurien.

Shoqëria dhe miqësia e Nuries me Agimin ishte, e pastër dhe u kurorëzua me lidhjen e tyre për jetë. Kjo gjë i gëzon të gjithë në fshat. Kjo e bindi edhe Qemalin se Nuria nuk kishte qëllim që të turpëronte fisin e krahinën, se kundërshtimi i saj për të marrë Riza Shpatin, nuk ishte ndonjë turp.

Në dasmën e Nuries dhe të Agimit, një dasëm e thjeshtë dhe gazmore, mori pjesë gjithë fshati. Të rejat, sidomos, ishin të gëzuara se martoheshin sekretarja e organizatës së rinisë, ajo që u bë pishtarë për të mposhtur një zakon të



vjetër e të rëndë në anët e tyre, ajo që, e fry-  
mëzuar nga mësimet e partisë, u priu në shtigje  
të reja. Amatorët e shtëpisë së kulturës kënduan  
dhe hodhën valle për shoqen e tyre, këndoi e ho-  
dhi valle gjithë fshati.

## UDHA E BARDHË

Dëborë.

Det dëbore. Dy njerëz dhe pafundësia e natyrës.

Dy njerëz. Njëri përqëndruar në timonin e skodës, tjetri vështron i hutuar në drejtim të pacaktuar. I pari ka flokë të zezë e të ashpër, duar të forta si prej hekuri, që duken të vogla në krahasim me trupin. Ndërsa tjetri është ziosh, syhirtë, flokërrallë, me duar të holla. Ai shtrëngon dhëmbët me zemërim të përmbajtur, sikur do të bluajë klithmën: «lamtumirë, lamtumirë!».

Skoda si një maune e rëndë çan detin e dëborës.

— Do të arrijmë dot sonte? — pyeti udhëtari.

— Pa tjetër.

— Më duket se do të na mbulojë dëbora, ose do të na bjerë ndonjë ortek mbi kokë.

— Përralla. Që kur ke filluar t'u trëmbesh hijeve, Adri? Do të arrijmë sonte gjallë ose vdekur. Kantjeri nuk mund të qëndrojë asnjë sekondë pa punë.

— Po sikur të zihet rruga?

— Nuk do të zihet.

Vështrimi i vagët dhe i mjergullt i Adrit en-



det një copë herë në kabinë. Në ballë të saj, atje ku shoferët zakonisht mbërthejnë ndonjë kukull ose majmun, është portreti i një luftëtareje vietnameze.

Uturima e motorit. Dhe ata të dy.

Një copë herë ndjekin të heshtur vallen e fluturave të dëborës që enden në hapësirë si të verbëra, pastaj përplasen mbi xham të hutuara, të pafuqishme. Ngrohtësia i kthen në brymë të shkëlqyeshme. Një lëvizje e shpejtë e fshirëses dhe pastaj asgjë. Xhami i lagur shpërftyron peisazhin.

— Filloi edhe beteja jonë e fundit. Beteja fitimtare, — thotë Hyseni.

Tjetri hesht, i struktur më thellë në pallton e tij.

— Kur nisëm punimet në hidrocentralin «Lenin», ne ishim fare të rinj dhe asqë guxonim të mendonim kaq shumë! Kisha një shok malsor. Kolë e kish emrin. Më thosh shpesh «A thue, he burrë, do të kena edhe na dritë në kulla tona? «Do të kemi, kudo do të kemi» i thosha unë. Më vjen keq që nuk jetoj deri tani. Ishte minator i rrallë ai. Një nga ata luanët e heshtur të tuneleve, një malësor i vërtetë dhe, kur e mendoj këtë, them me vete, që rruga jonë nuk ka qenë e shtruar me trëndafilë. Do të dëshiroja të jetonte dhe ai tani.

Tjetri nuk i përgjigjet. I trëmbet klithmës së tij të brendëshme; i duket sikur ajo klithmë do ta tradhëtojë dhe do të buçasë pa prituri: «Lamtumirë, grua, lamtumirë!».

«Po kjo është e tmerrshme, që kur kam ma-



rrë në dorë urdhërin e transferimit, unë s'bëj gjë tjetër veçse dëgjoj këtë klithmë: «lamtumirë, lamtumirë!».

Adri nuk do ta mendojë më këtë. Po pa dashur pyet veten: «Përse të më transferonin pikërisht mua? Pak inxhinierë ka? «Ikë vëlla, ikë, shko, shko», po aq u bën atyre nëqoftëse ti mezi e ke krijuar folenë tënde, në qoftë se ti porsa ke krijuar jetën tënde. Po përse xhanëm, përse mua?».

Skoda çan me vështirësi përpara. Ata të dy lëkunden nën peshën e mendimeve të tyre. Në kabinë është ngrohtë. Adri rri i zhytur nën pallton e tij, i lodhur dhe i humbur.

— Unë nuk mendoja kurrë se do të vinte kaq shpejt dita që në kullën e Kolës të shkonte drita — vazhdon Hyseni. — Kur e shpumë trupin e Kolës në kullën e tij, para se të hynim brënda, na ndali plaku dhe pyeti me të rreptë vëllezërit e Kolës: «A na keni koritë, burra, a e keni koritë Kolën tonë». «Jo babë, u përgjegjën ata, asnjë pikë lot». «Atëhere hini brendë!» tha ai prerazi. Pas kaq vjetësh u takuam përsëri me plakun. Ai mbahej akoma i drejtë, thatim, me duar të rreshkura, dridhte cigare njëren pas tjetres. Në tiparet e rrepta dhe të ftohta të plakut, përveç vëmendjes dhe pritjes, s'mund të shikoje gjë tjetër. Ai punoi bashkë me familjen e tij. Hapën gropa, mbajtën shtylla pa pushuar as net as ditë. Unë i njoh mirë këta burra malsorë. Veç atë natë gati nuk po i njihja fare. Edhe të rreptë ishin, edhe si fëmijë të gëzuar, që çuditen dhe presin të shohin një mrekulli. Në shesh kishte më shumë se njëmijë burra dhe gra. Ja, erdhi

çasti: Dritë. Ata mbetën të mahnitur, sikur nuk i besonin atij çasti dhe pastaj-thirrje, gëzim, lot. Plaku i Kolës më mbërtheu krahun. Unë vura re se si i dridhej buza dhe si shtrëngonte nofullat mos t'i rrëshqitnin lotët. Po të tjerët nuk i mbanin. Ata qanin, qanin nga gëzimi. Plaku më tha: «Kur s'më kanë dalë lot sot, kurr, hej, njiherë në jetën teme s'kam me kja».

Adri dëgjon i mënjanuar nga Hysua, gati pa marrë frymë. Atij i merren mënd dhe nuk e ndjen veten mirë.

Skoda ecën me uturimë duke çarë e humbur nëpër dëborë. Udha është tepër e ngushtë dhe e rrezikshme, e mbuluar me një shtresë akulli. Skoda mezi çan. Adri vështron. Kokën e ka të mpirë. Mendon: «Vetëm Hysua mund të udhëtojë në këtë mot të verbër».

Po, Hysua është mësuar. Bashkë me shokët e tij ai ka lënë pas si dëshmi të gjallë një pyll tërë shtyllash tensioni të lartë. Këtë pyll mund ta ndeshësh anës rrugëve me një gëzof të trashë dëbore të ngrirë. Qirinjtë e akujve varen si lodrat e vitit të ri mbi bredha. Bredhat ngjajnë me fidanë me petk të ndritshëm kristali. Fidane që kanë nevojë të mbështesin supat ndër këmbët prej betoni të shtyllave të tensionit të lartë.

Adri është i lodhur me mendime të përgjumura dhe të mpira. Udha ngushtohet më shumë. Era luan në këtë grykë një valle të çmendur dhe të zëmëruar.

Adri shkëputet nga dremitja. Vë re se, Hysua është i shqetësuar. Mbi ballin e tij, zhgaravitur pa kujdes nga koha, mendimet enden si një tufë zogjsh të trembur nga shtërngata. Por



kjo zgjat vetëm një çast. Vetëm një çast. Hysua vendos. Frenon. Hap derën dhe i thotë shokut:

— Dalim të kontrollojmë udhën.

Ai hidhet i pari nga skoda. Era me dëborë u përplasit me tërbim në fytyrë sikur do të hyjë kudo. Rreth tyre ngrihen pìrgje dëbore dhe shtëllunga që të pengojnë të shohësh. Hysua përkulet mbi dëborë për të gjetur gjurmët e udhës së humbur. Kërkon dhe mendon: «Ura është e vogël. Shtresa e akullt e trashë. Dëbora mbulon si mjergull gjithë rrugën. Një pakujdesi e vogël, dhe e gjithë kjo ngarkesë e çmueshme përfundon në humnerë». Shoferi vështron vjedhurazi Adrin. Diç mërmërit. Nuk don ta frikësojë shokun.

Ata shkelin një copë herë dëborën. Adri ka ftohtë dhe i duket sikur do ta rrëmbejë era, do ta flakërijë gjëkundi. E kalojnë urën me kujdes duke sheshuar pìrgjet e dëborës nën zukatjen e fluturave të akullta, që luajnë një valle të egër para syve të tyre.

— Më prit këtu, Adri, — thërret papritur Hysua. Zëri i tij, mezi dëgjohej nga era. — Ki kujdes, mbështetu pas shkëmbit, kështu mund të orientohem më mirë.

Adri mbështetet i kapitur. Vetëm atëhere vë re që ura është prej druri. Ajo duket e brishtë për të mbajtur gjithë atë peshë të rëndë.

— Hyso, Hyso! — thëret ai. Po zëri humbet në tufan, ndërsa Hysua mbulohet nga mjergulla e dëborës.

Adrit i vjen rëndë, turp. As vetë nuk e di pse fillon ta qortojë veten:

«Zemërlepur, ti ke kohë që jeton si zemërlepur. Ti ke harruar fare në strofkullën tënde tu-

3225.  
BIBLIOTEKA E JETËS  
~~XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX~~

fanin, akujt dhe ngricat që çajnë njerëzit me gjoks. Ti vetëm je kredhur në një makth, të ka mbuluar një frikë se mos ikësh nga strofkulla jote, mos vijë ndonjë stuhi e rrëmbyer të të flakë si guackë të vogël dhe pa vlerë në këtë botë të madhe dhe të egër».

Hunda e skodës duket nëpër mjergullën e lëvizëshme të fluturave të dëborës si një përbindsh i madh i fuqishëm, që hungërin dhe kafshon me zemërim, me zinxhir udhën.

«Hysua po kalon vetëm në këtë urë të pa-sigurtë. Ai ka dy net pa gjumë. Edhe ai ka fëmijë, edhe ai ka grua. Vallë nuk mendon edhe ai për ta?» pyet veten Adri dhe fillon të dridhet i tëri sikur ta kishin zënë ethet. Dhëmbët i kërca-sin nga të ftohtit.

Hysua hap derën.

Mbi ballë i shkëlqejnë bula të mëdha djerse.

— Udhë e vështirë — thotë më në fund Adri.

— E vështirë. Është rrugë e re. E sapo ndër-tuar.

— Dhe tí udhëton gjithënjë nëpër këto udhë?  
— pyet Adri.

Hysua qesh.

— Ne kemi kaqë punë! Kur lodhemi, ka rrezik të na zerë gjumi. Sidomos kur udhëtojmë vetëm. Po në të vërtetë, ne kurrë nuk jemi ve-tëm. Shiko!

Afër tyre ecnin një varg njerëzish. Adri fshin avullin e xhamit. Malësorë, burra e gra ngarkuar me shtylla kalonin anës udhës. Vargu dallgëzohej dhe rrukullisej si ortek nga alpet. Siç duket këndonin, se deri në kabinë dëgjohej



diçka si mërmëritje, si një përplasje dallgësh pas shkëmbinjve.

Njerëzit ecnin të sigurtë, të lehtë. Ngjanin me një varg valltarësh që merrnin format më të çuditshme në atë kohë të egër. Siluetat e tyre pasqyroheshin në qetësinë e përjetëshme të akujve dhe zbusnin me gëzimin e tyre rinor rreptësinë e ftohtë.

Hysua ngadalëson shpejtësinë. Ai hap xhamin e skodës, pyet:

— Deri ku kanë shkuar punimet?

U thërret me emra, ndërsa ata e përshëndesin si një shok të vjetër.

— E shikon, — tha ai; — këndeje nga ne nuk ka kufi midis natës dhe ditës. Tani që do të marrin të gjithë dritë, nata nuk ka më kuptim.

— Po — tha Adri.

— Je me fat ti, vëllaçko. Të fillosh jetën në kantjer në këtë kohë, duhet të kesh lindur me këmishë.

Vallja e fluturave të dëborës lufton pa rreshtur me pëndulet paralele. Fluturat enden nëpër terrin e butë të muzgut dhe vallzojnë të mahnitura rreth dritës.

— Para disa ditësh dola në pyll me fëmijët — thotë Hyseni. — Atje gjetëm një bredh të vërtetë të mbuluar me dëborë. Fëmijët thërrisnin të gëzuar: «Sa bukur, sa bukur!» Këtu çdo gjë është e vërtetë. Këtu nuk ka nevojë ta gënjeshtrosh bredhin me pambuk. Kështu, ne përgatitëm pemën e Vitit të Ri dhe e vendosëm jashtë te dera e shtëpisë. Fëmijët menduan që kjo do të ishte një gjë shumë e bukur, një e papritur që do ta çudiste tëmën kur të kthehej nga puna.

*Adrit i bien të gjitha si fshikullimë të akullta. Ai nuk ka guxim as të qeshë as të mendojë.*

— Edhe pak e do të duken dritat e kantjerit. Shokët po na presin. Ata u gëzuan kur morën vesh se do të vinje ti midis nesh.

— Vërtet? — pyeti Adri. Ai ngrihet në këmbë me rrëmbim.

— Ç'pate?

— Asgjë, u mpiva. — Nxjerr llullën. Duart i dridhen. E kupton se diç i kishte munguar gjatë udhës.

— Ma ndiz.

Adri flakë nga turpi kafshon bishtin e cigarit.

— Shokët do të kenë dalë të na presin — thotë përsëri Hysua.

Në kthesën e fundit skoda ndalet. Në luginë si mbi një tantellë të qëndisur me yje vallzojnë dritëzat e kantjerit më të ri të botës.

Hysua kthen kokën nga Adri.

Me vështrimin e ngulur mbi portretin e vietnamezes, me flokët e rëna mbi ballë, me nofulla të shtrënguara, sikur i dhëmb ndonjë dhëmballë, ai duket si një fëmijë i rritur që niset për shtetgëtim, si një udhëtar i vonuar i udhëve malore.

Skoda e thinjur nga dëborë ngjan me plakun e vitit të ri.

Hysua fillon të zbresë në luginë.

Kantjeri më i ri i botës ngrihet nëpër mjergull si një statujë vigane, e bardhë, e shndritëshme. Ai zgjon me vrullin e tij dremitjen e netëve dhe çdo ditë lartohet drejt qiellit të rimtë, drejt së ardhmes.



## RRUGA E NGUSHTË

Tela elektriku shtrihen kudo. Disa të trashë të dalë nga vetë hidroçentralet, varen në shtyllat e hekurta të tensionit të lartë, disa të hollë në shtylla druri... Shtrihen kudo... Të gjithë bartin dritën. Rrugët. Dhe rrugët të atilla janë. Shtrihen kudo. Disa të gjëra të dala nga vetë kryeqytetet dhe qytetet e mëdhenj të mbështetura në këmbë të hekurta urash gjigande, disa të ngushta të mbështetura në këmbë urash të drunjtë. Hyjnë dhe dalin nëpër qytete e fshatra. Janë të lidhura ato me qytetet dhe fshatrat. Janë të lidhura si arteret me zemrën. Pa ato zemra nuk do të punonte ashtu si nuk do të punonin ato pa zemrën...

Po kalonin në zonën ku para disa ditësh ra tërmeti. Ish natë. Një natë dimri pa hënë dhe pa yje me re të zeza që ngatërroheshin me majat e maleve.

Në atë vend rruga ndodhej në fund të faqes së malit. Poshtë në të majtë të saj derdhej një humnerë e zezë si një katarakt mendimesh të zymta. Në fund të humnerës rridhte një përrua, zhurmën e të cilit ata nuk e dëgjonin për shkak të rënkimeve të motorit të maqinës. Shoferi kthe-

hej nga Ostreni ku kish shpënë pllaka zdrukthi. Maqinaç ktheheshin nga ato fshatra të zbrazura, sikur merrnin me vete boshllëkun e krijuar në to nga shëmbja e qindra shtëpive. Me të ishte edhe një gazetar që kthehej për në shtabin qëndror. Gazetari që mbanë një beretë në kokë, ish shtrirë sa kish mundur në sedilje dhe herë herë i thosh ndonjë fjalë shoferit. Ndërsa ky e kthente pak kokën nga ai dhe pastaj ngulte përsëri sytë në rrugën e ngushtë që ndriçonin dritat e maqinës. Ndriçonin pesëmbëdhjetë, njëzet metra dhe pastaj më tutje errësirë e plotë. Dukej sikur pas atyre njëzet metrave vinte humnera, por maqina ecte dhe dritat ndriçonin githnjë rrugën e ngushtë.

Para disa ditësh kish rënë dëborë. Kish rënë e shoqëruar me një fortunë. Dukej sikur qielli kish dashur t'i tregojë tokës se edhe ai nuk ish më pak i fuqishëm dhe pas tri orësh shtëpitë e rrëzuara ishin mbuluar me çarçafin e bardhë. Pranë tyre qëndronin më këmbë, sikur bënin homazhe, shtëpitë e reja, gjysëm të ndërтуara. Dhe rrugët ishin bloukar. Por dy ditë përpara fryu era e jugut dhe dëborë kish filluar të shkrinte ngadalë. Në dy anët e rrugës ish akoma e trashë, ndërsa atje ku e shkelnin rrotat e maqinave ish përzier me baltë dhe vende-vende kishte shkrirë fare. Ishin krijuar dy vija të zeza, të gjata pafund që orientonin edhe shoferët. Ato vija, ku dëborë përzihej me baltë, ishin vazhdimi i baltës së themeleve të shtëpive të reja.

Shoferi nuk i kish hequr zinxhirët dhe ata duke u rrotulluar me rrotat ngrinin prapa çiklat e dëborës së përzier me baltë. Ecnin mjaft ngadalë. Rruqa kish kthesa shumë, herë, herë të sho-



qëruara me ndonjë ngritje apo zbritje të fortë. Kthesat dukeshin sikur ishin formuar nga shtrembërimi i rrugës prej peshës së malit, i cili vende-vende mbështeste ndonjë bryl mbi rrugë e vende-vende sikur e fuste trupin brënda. Shoferi qëndronte gjithënjë me dy duart të mbërthyera në timon...

— Kthesa të këqija këto, o Vangjo — i foli gazetari.

Ai tundi një herë kokën dhe pastaj mori me kujdes kthesën që kishin përpara.

— Na priftë fati e s'na vjen përballë ndonjë maqinë në këtë zonë, se na mori djalli. Do na duhet të ecim nja pesëqind metra mbrapsht sa të gjejmë një vend ku të kalojnë dy maqina — foli pas pak shoferi.

— Pse të kthehem ne, të kthehet ajo — i tha gazetari.

— Po ata që vijnë janë të ngarkuar, ne jemi bosh.

— Ou, vërtet — tundi kokën gazetari dhe ra në heshtje.

— Kur je duke ecur në këmbë e të del përpara ndonjë kanal apo ndonjë pengesë, merr pak vrull mbrapsht dhe pastaj e kërcen. Ashtu është edhe puna e këtij të ecuri mbrapsht këtu. Në rrugët e vështira ka gjithnjë pengesa të tilla — i tha Vangjua gazetarit pas një copë herë duke qeshur me krahasimin e tij.

Pas pak kaluan mbi një gropë dhe kamioni u trondit i gjithi. Ata u tundën mbi sedilje dhe sustat e saj kërcitën sikur krisnin nga dhëmbja...

— Ama punë e madhe po bëhet — i foli gazetari.

— A për punë, s'ke ç'thua. S'ka njeri që të mos punojë. Ne shoferët mund të kemi transportuar një qytet të tërë mbi shpinë. Të tjerët e ngrënë, — ja ktheu Vangjua.

Ecën për një farë kohe kur që larg dalluan dritën e pasme të kuqe të një maqine.

— Po kjo nga na doli?! — foli Vangjua.

Nuk kaluan shumë dhe ju afruan dritës së kuqe. Panë se ish e një kamioni të rimorkjuar nga një «Skodë». Dy maqinat ecnin shumë ngadalë. Dukej sikur «Skoda» e tërhiqte kamionin tjetër prej kapistalli dhe ky mezi dëgjonte të lëvizte.

— Tani hajde e kaloi këta. Do zvarritemi rrugës pas tyre. Në të gdhirë do të arrijmë në Shupenzë — tha gazetari.

— Do t'i parakalojmë se s'bën — tha Vangjua dhe ju afrua aq tepër kamionit të dytë sa s'u përplas. Filloi t'i bjerë burisë dhe të ndezë e të shuajë dritat. Më në fund «Skoda» e mori vesh dhe ndaloi. Shoferët hapën dyert dhe nxorën kokën. Vangjua nxori edhe ai kokën dhe u foli me zë të lartë.

— Gjeni një vend e ndaloni se nuk do të rrimë tërë kohën pas jush.

— E ore, po jam i rimorkjuar unë — thiri shoferi i dytë.

— Bëni si të bëni — i tha edhe një herë Vangjua.

Pastaj ata të dy mbyllën dyert dhe vazhduan rrugën.

— Ai tel çeliku që lidh maqinat, lidh dhe zemrat e shoferëve; — i foli Vangjua gazetarit pasi ndezi maqinën dhe u nisën. Ecnin me ngadalë. Gazetari pak nga pak filloi të dremitë. Dy



kamionat e tjerë ishin zhdukur pas një kthese.

— E di si them unë. Ne shoferët dhe maqinat tona jemi një pjesë e këtij trupi të fuqishëm që mund tërmetin. Ne, jemi si të them unë njera dorë e këtij trupi të cilën ai e zgjat për të marrë materialet që i duhen për të ndërtuar, — i foli Vangjua gazetarit. Ky e dëgjoi dhe po përsëriste ato fjalë me mendje.

Kur kaluan një kthesë, ata panë se kamioni i rimorkjuar kish qëndruar në një vend ku kalonin dy maqina, ndërsa i pari sapo u nis.

— Ç'bëri kështu, e la?! — pyeti gazetari.

— Jo — ju përgjegj Vangjua — do vejë të zerë edhe ky një vend pastaj do të kthehet ta marrë prapë.

Pas dyqind metrash ndaloi dhe kamioni i parë. Kur ata i kaluan përbri, dy shoferët i ngritën pak dorën njëri tjetrit pa u munduar të shihen ndër sy dhe kështu u ndanë njëri duke shikuar përpara, tjetri duke u kthyer mbrapsh për të marrë shokun.

Rruga ecte gjithënjë paralel me përroin, por pesëqind-gjashtëqind metra larg tij. Drita e maqinës, kur kjo merrte kthesa, shkiste herë mbi ndonjë pemë që kish mbirë buzë greminës, herë në faqen e malit mbi ndonjë mullar të mbuluar me dëborë si një qeleshe e madhe e rënë nga koka e ndonjë shkëmbi; herë mbi ndonjë kasolle barijsh. Vetëm rrugën e ngushtë me gropa të mbuluar anash me dëborë nuk harronte ta ndriçonte.

Gazetari dremiste i shtrirë në sedilje. Shoferi vazhdonte punën e tij. Çikla balte kishin kërcyer gjer mbi xhama dhe i qëndronin përpara si shenjë e atyre rrugëve të këqija... Që larg

u dukën dritat e një maqine si dy vrima të rru-  
mbullakta në perden e zezë të natës. Maqina af-  
rohej gjithënjë e më shpejt dhe Vangjua e njo-  
hu që ish gaz. Pas pak dritat e dy maqinave u  
gjendën përballë njëra tjetrës dhe gazi i shuajti.  
Midis tyre nuk kish vend ku të kalonin të dyja.  
Gazi filloi të ecë mbrapsht. Vangjua shkonte  
ngadalë pranë tij. Pas njëqind metrash gazi e gje-  
ti vendin dhe u fut sikur të futej në ndonjë xhep  
të rrugës. Ata i kaluan ngadalë përbri dhe kur  
të dyja kabinat u vunë në vijë të drejtë njëra  
me tjetrën, një burrë hapi xhamin e gazit dhe i  
foli gazetarit, që e kish për bri:

— Mbas një gjysmë ore do të takoni auto-  
kollonën që vjen. Kini kujdes të zini një vend  
që të mos pengoni lëvizjen!

Pastaj gazi u nis tutje.

— Kush ishte? — pyeti Vangjua gazetarin.

— Më duket se një anëtar i shtabit, — ju  
përgjegj ky. — Pas një gjysmë ore do të takojmë  
autokollonën.

Maqina vazhdoi udhën e saj. Kërcente herë  
pas here nëpër gropat e rrugës dhe tundëte mbi  
sedilje gazetarin e shoferin. Ato vende rruga si-  
kur i kish plagë dhe sapo maqina shkelte mbi to,  
asaj i lëndoheshin dhe hidhte përpjetë trupin e  
saj bashkë me maqinën.

— Ama ku e gjeti ky tërmeti të bjerë mu-  
tani në dimër. Është katër herë më rëndë se të  
bjerë në verë. Para tri ditësh nuk di si kemi  
udhëtuar. Frynte një erë me dëborë, një ciklon i  
tmerrshëm, nuk di ç'të të them... foli Vangjua.

— Dhe ti je nga Saranda, s'ke parë të tilla  
ciklone — i tha gazetari.



— Jo more sa për atë kam udhëtuar unë edhe nga veriu... Po ty nga të kemi?

— Nga Berati — ju përgjigj gazetari.

— Jemi mbledhur këtu nga të katër anët për të mbyllur këtë plagë që u hap në trupin e atdheut, — i tha Vangjua.

— Dhe gjurmët e qepjes së saj do të dallohen nga ngjyra e kuqe e tullave të reja mes gurëve të bardhë të shtëpive të vjetra — foli gazetari dhe buzëqeshi.

Udhëtua edhe dhjetë minuta në heshtje, kur në krahun e majtë të rrugës buzë humnerës, tamam në brylin e një kthese nëntëdhjetë gradësh dritat ndriçuan prapakolpin e një «Skode» që kish ndaluar.

— Po ky qafir këtu e paska gjetur vendin... — çfryu Vangjua, kur pa se sa pak vend përtë kaluar i kish lënë «Skoda» në krahun e djathtë. Pastaj ngadalësoi shpejtësinë për ta futur me kujdes maqinën në ngushticën e formuar nga faqja e malit në njërin anë dhe nga «Skoda» në tjetrën. Por nuk bëri as disa metra dhe, pa u futur mirë akoma, dritat ndriçuan pak më tutje karrocërinë e një «Zisi» me targën e Beratit që kish ndaluar në krahun e djathtë. Frenoi përnjëherësh.

— Oh, oh, tani e hëngrëm, — foli gazetari me inat.

Dy shoferët, ai i «Skodës» që ish i parkut të Tiranës dhe ai i «Zisit» kishin qëndruar në mes të rrugës dhe se çfarë bisedonin. Dalloheshin vetëm siluetat e tyre të zeza. Maqina që erdhi, i vuri në lëvizje. U drejtuan nga kamioni i Vangjos. Në atë kohë Vangjua hapi derën, nxori këmbën dhe thirri:

— Ej. Berati! Pse nuk lëviz?

— Kam ngecë — bërtiti një nga të dy shoferët që afroheshin.

— Hajde tërhiqe pak mbrapsht — foli tjetri që duket se ish shoferi i «Skodës».

— Zotrote pse s'e tërhoqe vetë?! — bërtiti edhe një herë Vangjua dhe zbriti nga maqina. Zbriti edhe gazetari. Atë kohë erdhën edhe dy të tjerët dhe shoferi i «Skodës» ju drejtua Vangjos:

— Shiko ku e kam futur maqinën, s'guxoj të bëj dy pëllëmbë mbrapsht. Mezi e lirova rrugën. Ti më thua tërhiqe...

— Po si do të bëjmë, të rrimë këtu? Pas njëzet minutash vjen autokollona — foli gazetari.

— Ja pra, ta tërhiqni pak ju këtë — foli prapë shoferi i «Skodës».

Fytyrat e të katërve të ndriçuara rëshqitazi nga dritat e maqinës dukeshin mjaft të errëta. Të gjithë kishin dy tri ditë pa u rruar. Kamioni i Vangjos u qëndronte aty pranë si një kafshë gjigande e urtë me sy të bardhë të ngulur përdhe.

— Hajt pra ta nxjerrim pak e të na lirojë rrugën ky — i tha Vangjua gazetarit dhe hipi në kabinë në vendin e tij në timon. Gazetari ndenji me dy shoferët e tjerë. Kamioni i Vangjos rënkoi një herë dhe pastaj ju drejtua ngadalë kamionit që kish ngecur. Beratasi shkoi me vrap drejt tij, hipi mbi karroceri dhe mori një kavë. Pas pak të dy maqinat u lidhën njëra me tjetrën. Vangjua filloi të ecë mbrapsht. Rrotat e «Zisit» të ngecur bënë disa rrotullime në vend gjersa u tendos kavoja dhe pastaj filluan të dalin nga



gropat. Kavoja ish dora e çelniktë e kamionit të Vangjos me të cilën ai tërhiqte nga balta shokun e tij. Vangjua eci edhe pak mbrapsht dhe sapo do të zbriste për të hequr kavon, kur dyqind metra përballë tij u dukën dritat e një kamioni që sapo doli nga kthesa.

«Autokollona!» — mendoj me vete dhe u tremb. Por ai ish një kamion i vetëm që pas pak ndaloi përballë «Zisit» të beratasit. Ata zbritën dhe hoqën kavon. Kamioni që sapo erdhi ish i ngarkuar plot e përplot me kapriata. Kur kamioni ecte kapriatat kërcisnin me zhurmë sikur bisedonin me njëra tjetrën me zë të lartë. Kamioni që erdhi nuk mund të bënte dot as dhjetë metra mbrapsht. Kështu që beratasi, i cili u lirua, prap nuk mund të shkonte përpara, por duhet t'i hapte rrugën kamionit të ngarkuar.

— Duhet të ecim të dy mbrapsht tani. Unë po futem pas «Skodës», ti shko gjej ndonjë vend më tutje — i tha beratasi Vangjos, pasi hodhi kavon e mbështjellë mbi karroceri.

— Ti e ngatërrove gjithë këtë punë, ku e gjete atë baltovinë që u fute — thirri me inat Vangjua.

Pastaj hipi në maqinë dhe pak nga pak u zhyt në errësirë... Beratasi filloi t'i japë edhe ai mbrapsht. Duhej të futej pas «Skodës» që tani e kish përmbri, në të majtë. Ajo kish zënë vendin më të gjerë tamam në pikën kulminante të kthesës. Beratasi i jepte një herë ngadalë mbrapsht duke shkuar drejt humnerës pastaj frenonte. Rrotullonte me gjithë fuqinë timonin majtas dhe ecte gjysmë metri përpara duke liruar një pëllëmbë më tepër rrugën në krahun e djathtë. E

përsëriste këtë shumë herë me radhë. Gazetari me shoferin e «Skodës» rrinin prapa maqinës dhe kur beratasi ecte mbrapsht, i bënin me dorë duke i folur:

— Edhe pak... edhe pak... edhe pak — duke ecur edhe ata mbrapsht.

Shoferi i maqinës së porsaardhur me targën e Krujës, kish hapur derën dhe ish anuar me trup jashtë duke pritur t'i hapej rruga e duke thirrur herë pas here «edhe pak se s'kalon!».

Beratasit filluan t'i dalin djersë. Duket se humnera kish fytyrë të tmerrshme që e shikonte vetëm ai, prandaj nuk donte t'i afrohej aq tepër...

Më në fund rrotat e «Zisit» të tij u gjendën më pak se një pëllëmbë larg humnerës. Spondi i majtë i karrocërisë i takonte asaj. Beratasi doli nga dera e djathtë dhe fshiu me mëngë vijat e djersës mbi ballë sikur fshiu rrugët që kish kaluar lodhja dhe ankthi. Por në atë kohë zbriti nga kabina shoferi i Krujës që ju hap rruga.

— Ej, nuk kalohet këtu! Nuk e fus maqinën aty — u thirri ai.

— Si ore nuk e fut?! — i foli gazetari me inat.

Dy shoferët e tjerë u drejtuan nga krutani duke matur me sy ngushticën që ish krijuar prej «Skodës» dhe «Zisit» nga njëra anë dhe nga faqja e malit në anën tjetër.

— Kalon — tha shoferi i «Skodës».

— Po i dhe shumë majtas kalon — foli beratasi me pak ngurim.

— S'kalon or pra se kam gjithë ato hekura mbi kokë — tha me inat krutani.

— Provoje njëherë — foli gazetari.



— Mirë... unë e provoj, po ju them se s'kalon. Kam frikë se do ngel aty brenda — tha krutani.

Pastaj hipi në maqinë, ndezi motorin dhe filloi të ecë ngadalë. Kapriatat e gjata që dilnin jashtë karrocërisë filluan të tunden e të përplasen me njëra tjetrën duke kërcitur. Tre burrat e tjerë qëndronin përpara kamionit dhe i bënë me dorë që të ecte edhe më përpara. Dritat e maqinës gremisnin tutje në humnerë hijet e tyre. Krutani mundohej të ecte sa më ngjitur me faqen e malit që qëndronte aty e zyrtë, e ftohtë. Eci dy metra dhe kapriatat që dilnin nga karrocëria u përplasën mbi kabinën e «Skodës».

— Ngadalë more se më prishe maqinën — thirri shoferi i «Skodës».

— Vetë e ke fajin, a ta thashë! — bërtiti me të njëjtin ton krutani.

— Po ti a nuk e sheh që s'shkon dot më? Tani rri edhe ti aty! — thirri prapë shoferi i «Skodës».

Gazetari në atë kohë pa sahatin. Kish kaluar gjysëm ore që kur ishin takuar me anëtarin e shtabit, po me qenë se ata kishin njëzet minuta që nuk ecnin, autokollona mund të vinte mbas njëzetepesë minutash...

Mbetën për një çast pa ditur ç'të bënë. Poshtë, përroi rridhte gjithënjë i shpejtë, me zhurmë. Dukej sikur humnera pëshpëriste mijra fjalë të çuditshme... Që larg në rrugë u duk silueta e Vangjos. Po vinte ngadalë. Si arriti aty, u hodhi një sy të tre kamionave dhe tha:

— Qenka keq puna. Duhet të lirojmë rrugën patjetër.

Në atë kohë erdhën edhe dy kamionë të tjerë që u rreshtuan pas krutanit. Shoferët zbritën përnjëherësh, erdhën te grupi dhe pa thënë asnjë fjalë filluan të mendojnë një mënyrë zgjidhjeje. Filloi të fryjë një erë e ftohtë.

— Për nder, keq e kemi punën — tha një nga shoferët që sapo erdhi — po ky i Krujës ç'e paska futur këtu!

— U thashë. Këta thanë e unë e futa — ngriti zërin krutani.

Pastaj ranë në heshtje. Ishin mbledhur shtatë burra dhe mendimi i të shtatëve vërtitej një copë herë rreth kthesës së blouar.

— Gjithë punën ky «Zisi» i Beratit na e prishi — foli krutani, tek i binte me nervozizëm me këmbë dëborës së ngrirë në anë të rrugës.

— Tani as nuk kam nga të shkoj prej këtij — tha shoferi i «Skodës».

— Unë s'kam nga të lëviz as këtej as andej. Çuditëm se si u futa aty — foli beratasi me përtesë.

— Ti më duket se paske ndërmënd të rrih aty, po unë do të çoj kapriatat në Klenjë — bërtiti shoferi tjetër.

— Mirë more mirë, edhe ti t'i çosh kapriatat në Klenjë edhe unë të shkoj atje ku kam për të shkuar. Vetëm se duhet të presim një traktor që të më tërheqë mua.

— Ç'traktor, ore? — bërtiti shoferi.

— Për nder unë jam shkatërruar nga nervat në këto rrugë, e ca nga pagjumësia... tha beratasi më tepër sikur fliste me veten me zë të lartë.

Në atë kohë kur beratasi fliste, Vangjua i tha me zë të ulët gazetarit:



— E di ti që atje ku ka hyrë ky, pa traktor pesë përçind ka shpresë të shpëtojë nga humnera...

Shoferi që po vazhdonte të zihej me beratasin bërtiti prapë:

— Ç'më prallis mua, pagjumësia, nervat! Ke frikë a? Ikë se e heq unë që andej maqinën tënde... Po autokollona more?

Në atë kohë aty u gjend edhe një vendas që s'u muar vesh se nga doli.

— Ç'thua or ti — i foli ai shoferit që bërtiste — atë shan ti? E njoh unë atë. Ka punuar ai në Ostren për tri ditë rrjesht kur ish dëbora deri në brez që...

— Mirë, mor vëlla, para tri ditësh, Ç'më duhet mua. Nuk e sheh ç'thotë, pagjumësia, dëngla! Pse a ka njeri që ka fjetur që kur ka rënë tërmeti këtu? — vazhdonte të çfrynte shoferi.

— Po, po, po sikur dëgjova se the që ka frikë...

— Frikë që ç'ke me të — ja preu prapë shoferi.

Beratasi kish ulur pak kokën. Drita e maqinës së krutanit i binte në fytyrë. Nën sytë i ishin formuar dy rrathë të zinj nga pagjumësia, sikur të ishin konventruar aty gjithë ato net të errëta. Asnjë nga ata burra nuk e dinte se ai kish një javë që nuk kish mbyllur sy. Ktheu kokën nga maqina. Ajo qëndronte aty, buzë greminës, e heshtur, e mbështetur në njërën anë në krahët e vdekjes. Beratasi bëri disa hapa i vetëm deri tek buza e greminës dhe nguli vështrimin në thellësinë e errët. Të tjerët e kuptuan që ai vendosi dhe u afruan edhe ata ngadalë të shihnin me

vëmendje rrotat e majta të maqinës, që kishin hapur një vijë të thellë të zezë në dëborën e pashkelur, më pak se një pëllëmbë larg humnerës. Ajo ish vija që ndante jetën nga vdekja dhe mbi atë vijë kish shkelur beratasi për të hapur rrugën.

— Ka rrezik të shëmbet dheu — tha krutani.

— Dhe të xhirojnë rrotat në dëborë — foli Vangjua.

— Hej drejt si u bë kjo punë — çfryu gazetari.

— E dini ç'do të bëjmë? — foli shoferi që ish zënë me beratasin — ne tre veta të hyjmë poshtë maqinës në krahun ku është rreziku dhe të mundohemi ta ngremë sa të jetë e mundur. Ju të tjerët ta shtyni ndërsa ky t'i japë ngadalë. Puna është që maqina të ecë me dy rrotat e djathta që qëndrojnë në vend të sigurtë.

— Jo, or vëlla, jo! S'kam qejf të marr me vete edhe të tjerët unë — ja preu beratasi — po të rrëshqasë maqina e t'ju marrë edhe ju me vete. Jo ore.

Të tjerët që e kishin dëgjuar pa thënë asnjë fjalë, filluan t'i flasin me zë të lartë:

— Punë që s'bëhet kjo, je në vete?!

— Pse karrocë është ajo që do ta ngresh ti?

Krutani që kish një trup të madh, tha:

— Nuk është ndonjë gjë e madhe jo.

— Kjo është, s'ka tjetër — foli shoferi që propozoi dhe u drejtua për t'u futur poshtë kamionit.

— A po del që andej ti apo si e ke hallin!?



— bërtiti beratasi. Pastaj ju drejtua të tjerëve:

— Këtu s'ka asnjë rrezik përveç asaj që rrotat janë shumë afër humnerës dhe është zor të ecësh mbrapsht edhe një çerek metri në këtë errësirë. Sa për atë që shëmbet dheu gjersa «Zi-zi» im hyri, edhe do të dalë. Unë e futa këtu se kujtova që do të kalonte ky krutani dhe ne do të ecnim përpara.

Pastaj hypi në maqinë nga dera e djathtë dhe u shty tek timoni. Ndezi dritat. Ajo e djathta binte mbi karrocërinë e «Skodës» që e kish një metër përpara ndërsa e majta zhytej në lumnerën e zezë duke ndriçuar rrëshqitasi faqen e saj të pjerrët. Ndezi motorin. Maqina filloi të dridhet. Beratasi hapi derën dhe nxori kokën jashtë. Sytë i nguli në rrotën e mbrapshme. Të tjerët mbështetën duart në maqinë gati për ta shtyrë. Ai shkeli gazin... Rrotat filluan të lëvizin. Të tjerët shtynin me gjithë forcën. Rrotat ecnin ngadalë përpara duke u rrotulluar më tepër në vend për shkak të dëborës. Maqina dridhej e tëra sikur dridhej prej inatit që nuk i kërcente dot ato dy gropa.

— Edhe pak. Ktheje tani djathtas! Hajde buçko! — thërriste krufani.

Beratasi rrotullonte ngadalë timonin djathtas duke parë gjithnjë rrotën e prapme që i largohej centimetër pas centimetri humnerës. Ndërsa rrotat e përparme i afroreshin gjithënjë e më tepër. Pranë saj ish gazetari që kish zënë vend në cep dhe shtynte me sa mundte. Këpucët i ishin zhytur në dëborë.

— Kujdes se po shëmbet dheu këtu! — thërrri ai papritur dhe instiktivisht shtyu akoma më

fort maqinën. Pastaj kërceu përnjëherësh në anën tjetër. Dhe të tjerëve në atë çast sikur ju dyfishuan fuqitë. Beratasi shkeli gazin gjer në fund. Maqina mori hov dhe rrotat e pasme të saj kërcyen në mes të rrugës.

— Hajde buçko se mbaroi, kjo punë — thirrri fort krutani.

Në atë kohë dheu në vendin ku kish qenë gazetari u shëmb, sikur humnera e kafshoi me dhëmbët e padukshme. Për një çast ata dëgjuan zhurmën e rrukullisjes së tij nëpër gurmazin e saj të errët. Ai dhë i shëmbur sikur ishte një rënkim i fundit i tërmetit...

— Hajt e shtyjmë pak mbrapa «Skodën» time, tha shoferi i parkut të Tiranës.



## BARDHA

Dita po thyhej dhe qielli i ngjante një pël-hure në ngjyrë të hirit që vende vende i ka dalë boja. Ca re të murme ndiqnin shoqja shoqen, dukeshin sikur lëpinin njëra tjetrën dhe nga ana e perëndimit po ngjyeshin me të kuq.

Një vajzë e re, e panjohur atyre anëve, po hynte në fshat. Mbante në dorë një valixhe dërrase që dëndur e më dëndur e kalonte nga njëra dorë në tjetrën dhe vështrimi i saj po përpinte me kureshtje gjithçka që shihte përreth. I bënin përshtypje shtëpitë prej guri ngjeshur njëra pas tjetrës, muret ku ishin varur vargje me duhan e piperka të kuqe, rrugët e ngushta me bar për anash dhe kumbullat e egra që të ngarkuara rëndë, vareshin gjer mbi rrugë. Gurët e udhëve ishin kruar e lëmuar nga zinxhirët e traktorëve, aty këtu ndiheshin zhurmat e xhullirave që rrihin bulmetin dhe për çudi, nëpër fshat, kish fare pak njerëz. Por Bardha e mori me mend se ishte kohë pune dhe medoemos njerëzia ishin derdhur arave dhe fushave. Vajza akoma po nanuriste ëndërrat e veta dhe përfytyronte se në këtë apo në atë shtëpi do të priste fëmijën e parë, në atë më tutje do ta thërrisnin mu në mes

të natës: «Mami, o shoqja mami, shpejt se po të pret nusja e Likos!». Në atë shtëpi përfundi rrugës do ta zgjidhnin edhe për nunë dhe Bardha do t'i vinte emrin e parë: «Gëzim! Të rrojë sa malet!».

Vajza qëndroi diku në mes të fshatit, afër një pusi. Mbi plloçat afër tij po trokiste këmbët një kalë dori që pinte ujë në postaf duke u gëlltitur me gllënka të mëdha. Sipër pusit shpërdante hijen e saj një arrë e madhe. Nën hijen e saj rrinin tri plaka. Ato çukitën kokat me njëra tjetrën kur panë vajzën e re të panjohur dhe diçka mërmëritën midis tyre.

Bardha u foli dhe u dha dorën të trijave, por ato s'deshën ta lenë të ikë pa marrë vesh më parë cila ishte, për ku ishte nisur, prej nga vinte dhe përse vinte. Vajza e re u tregoi dhe ato ja ngulën vështrimin në sytë e saj ngjyrë lajthie dhe në fytyrën e freskët që sapo ishte përcëlluar nga dielli.

— Po ti, çupërlinë, do ndihmosh nuset tona?

Bardhës ju duk sikur i hodhën në gushë një kovë me ujë nga të pusit aty pranë.

— Ç'ka për t'u çuditur këtu, moj gjysheni...

Unë jam mami, kam mësuar kaq vjet në shkollë, më kanë dërguar tek ju...

— Po ti, moj bijë, ke lindur vetë ndonjë herë?

— Unë?

Asaj i morri zjarr fytyra dhe i pëcërroi sytë:

— ... po unë jam vajzë...

— E... po kur je vajzë, ç'do atëhere? S'e di ti se ajo që s'ka gatuar kulaç ndonjë herë...

Vajza nuk dinte se çfarë t'i përgjigjej dhe ngriti supet.



Në shtëpinë e Ganiut e pritën mirë. Në oborr dolën dy nuse me fëmijët e vegjël në krahë, bile njëra që i jepte gji foshnjës me njëren dorë shtrëngonte vajzën, kurse krahun tjetër e hodhi mbi qafë të Bardhës:

— Mirësenaedhe dhe me këmbë të mbarë!

U ngjitën lart në odën e zjarrit. Nëpër qoshet e tavanit kishin varur kokra mollësh kurse mbi buhare kishin vendosur tri katër forma të bukura të gërshetuara me kallinj gruri. Bardha dëgjoi të zihej në gojë emri «Tixhe», kuptoi se ajo ishte vajzë e shtëpisë, mori me mënd që emri i Tixhes zihej në gojë duke u parashikuar se Tixheja do të bëhej shoqe me Bardhën. Por si dukej Tixhja ishte larg.

— Po cila është kjo Tixhe, — guxoi dhe pyeti Bardha.

— Kunata jonë, është goxha çupë, do ta kesh krah; sot shkuan larg me brigadën e tretë në arat e malit.

Kur ra nata u bë më fresk, pastaj ajri u ftoh dhe padashur Bardha fërgëlloi dhe i shkuan të ngjethura.

— Vend malësi këtu, — foli njëra nga nuset, gusht e gunë...

Dhe qeshi sa ju bënë dy gropëza ndër faqet. Por nusja tjetër, ajo më e holla dhe që mbante një çember të kuq në kokë, i lëshoi kunatës edhe fëmijën e saj dhe rendi tatëpjetë shkallëve. E ulur mbi një minder leshi, e mbështetur në një jastëk të gjatë e të trashë, Bardha mori fëmijën

e dytë dhe e mbajti në prehër. Ishte një djalë shtatë a tetë muajsh, me flokë gështenjë të çelur, me një fytyrë të trëndafiltë e të ndriçme dhe me një palë sy aqë të bukur sa nusja u shqetësua:

— ... I ka të bukur shumë, mos ma merr për keq por... thuaj mashalla... Ngjet nga fisi i sime kunate. Ata i kanë sytë mavi, por ky i ka më shumë se andej...

— Është njomzak, është akoma në sisë, kur të rritet nuk do t'i ketë kaqë mavi, po i ka shumë të bukur, shumë.

Bardha ndehu përpara djalin e vogël dhe ja vështroi sytë nga një largësi më e madhe. Por befas diçka u kujtua:

— Edhe ju e paskeni vajzën si një lule...

Bardha do të fliste akoma kur u dha në derë e kunata me tenegënë e madhe të furrës ndër duar. E kishte të mbushur plot me prush. U ul më gjunjë te vatra, derdhi në kllanik thëngjijtë e kuq dhe trazoi urët me mashë.

Poshtë ndiheshin çape burrash dhe pjesë të shkëputura të një bisede:

— Nga ishe ti sot?

— Vadita patatet te përroi i madh.

— Vaitin e kafshoi një grerë.

— Fërkojani vendin me uthull.

— Tixhja do të vonohet, shkuan për mbledhje në sektorin e Dëllinjës.

Dhe pasi hëngri darkë me nuset e shtëpisë, dhe pasi priti më kot të dukej në odë ndonjëri nga burrat e shtëpisë dhe kot e më kot priti Tixhen e panjohur, Bardhës ju afrua gjumi. Zu kotëj dëndur, kaqë herë fërkoj tëmthat dhe faqet



me duar, kaqë herë u mundua të mundë gjumin, por s'ja arrijti dot. Nuset e reja sollën aty një jatak, shtruan cerga, një jorgan që dukej fare i ri, i uruan natën e mirë dhe shkuan.

Por vajzës tashti ju duk sikur gjumi ju largua dhe përsëri filloi të ëndërrojë: I dukej sikur rreth saj silleshin nuse të reja që i kërkonin këshilla, ndonjëra s'ishte e sigurtë dhe me gishtat e duarve nëmëronte ditë e javë... Ëndërronte veten e saj të gëzuar kur jepte sihariqin: «Çupë e bukur, si lum ju, të na rrojë! Djalë! Djalë! Do bëhet trim dhe i fortë!».

Dhe ëndërimi i saj vazhdoi akoma dhe ajo nuk e kuptoi dot kur mbaroi ëndërimi me sy të zgjuar dhe kur filloi ëndërimi me sy të mbyllur në gjumë të thellë.

Kur u zgjua, dita ishte hapur fare. Nuk e kuptoi nëse u zgjua vetiu apo ishin disa çape të drojtur që silleshin në tremën e madhe të shtëpisë. Pastaj mendeshet e derës kërkëlitën lehtë dhe kanata u hap fare pak. Nëpër atë, si shirit të gjatë e të ngushtë Bardha dalloj një palë sy të butë e të zes, pastaj një gërshet të trashë varur përpara, u çelën një palë buzë në një fytyrë zeshkane dhe u dëgjua një zë i panjohur:

— Mirëmëngjez, shoqe!

Bardha këceu nga rrobat dhe ndehu para duart ashtu si po bënte Tixhja.

— Mirëmëngjez, Tixhe, ti duhet të jesh... më folën shumë për ty.

\* \* \*

Ndryshe e pat menduar Bardha punën e saj, krejt ndryshe pat ëndërruar fillimin dhe tashti po

i dilte përpara një çështje e papritur. Ajo s'i mbushi dot dy ditë në shtëpinë e Tixhes dhe, megjithëse njerëzit e atyshëm mundoheshin të fshiheshin prej saj, Bardha e kuptoi se përbrënda asaj familjeje po zjente dhe shtjellohej një sherr i vërtetë. Brenda dy ditëve Bardha mësoi çka ndodhte dhe kështu filloi t'i dukej sikur ishte njohur me Tixhen që prej shumë kohe. Vajza e re i tregoi se deshin ta martonin me një njeri që e kishin fejuar që të vogël. Ai nuk ishte një njeri i keq, po vajza s'e kishte parë kurrë. Asaj i pat hyrë në zemër një djalë i ri aty në fshatin e saj, i pat hyrë në zemër Qemali i lagjes matanë, ai Qemali korozi e mustaqe spicë që kur e lëshonte zërin për këngë nëpër ara e nëpër pllaja, dëgjohej gjer brenda në fshat e bile gjer në kthinën e Tixhes vetë.

Dhe ndodhi me Tixhen ajo që tashti nëpër malësitë tona ka marrë sërë e radhë. Tixhja pasi u mudua më kot t'u kundërshtojë burrave, gjyshit dhe babajt, pasi u mundua më kot të ketë krahun e nuseve, çuquriti vesh më vesh net të tëra me Bardhën dhe ja, një mbrëmje herë kur të gjithë ktheheshin nga puna, Tixhja me shatë në krahë nuk u kthye më në shtëpinë e saj, por shkoi bashkë me Qemalin...

Kjo ngjarje i tronditi fort të mykurit e fshatit. Edhe Hatixheja kishte thyer disa zakone të vjetra e të mbetura si vargonj mbi kokat e vajzave. Dhe bashkë me mallkimet e pleqve e të plakave për Tixhen, të tjera mallkime dhe sharje dëgjoheshin edhe kundër Bardhës.

Bardha u detyrua të ikë nga shtëpia ku bujtë që natën e parë dhe shkoi në shtëpinë e re të



Tixhes. Por fjalët e të mykurvë e ndoqën pas:

— Iku nusja e mori pas edhe vleskën!

— Mos e nxitëte ajo e qytetit, Tixhja as bënte çap prej shtëpie!

— Ajo do të na prishë terezinë e fshatit!

— Sakën se e thërrisni në lindje e në më the të thashë.

— Mos i lemë nuset në dorë të saj se ajo s'ka haber!

— Në vend të kërthizës, fëmijëve do t'u çajë barkun ose do t'u presë kokën!

— Do t'i yshtë vajzat që mos u lajnë këmbët burrave.

Kishte burra dhe djem në fshat që e afronin në bisedë, që flisnin pa të keq me të dhe Qemali vetë fliste më i shkujdesur.

— Kështu është fillimi, shoqe, mos u tremb ti, ka rrjedhur ujë, kanë ndodhur ndryshime të mëdha këtej. Të ishte një kohë tjetër në fshat, do të kishte krisur pushka, po mos u mërzit, edhe zogu s'e ka të lehtë të ngrejë folenë e vet...

— Po mirë, o shoku Qemal, e kuptoj, e di, ke të drejtë, po si t'ja bëj unë? Që kurse erdha, kanë ndodhur tri lindje në fshat, në asnjërën nuk më kanë thërritur...

— E di, e di fare mirë, ne e kemi bërë çështje në organizatë, shokët kanë marrë përsipër dhe në fund të fundit ta thotë Qemali ty, eee më fal shoqja Bardhë, unë do të të thërres ty, do të të thërres pa tjetër...

Bardha uli sytë dhe mërmëroi:

— Ju talleni, shoku Qemal!

— Jo, jo, nuk tallet Qemali, unë flas hapur dhe troç! dhe një gjë ta dish ti. Diç kam mësuar

atje në ushtri, ta thotë Qemali ty. Qysh na mëson Partia: Me luftë e përpjekje çrrënjoset e vjetra! Njerëzit ta kanë nevojën ty. Do t'ja arrish qëllimet.

\* \* \*

Por ndodhën edhe katër lindje të tjera në fshat dhe Bardhën nuk e ftoi njeri.

Tri lindje ajo s'i mësoi dot fare, por të katërtën e mësoi dhe deshi të hyjë vetë. Desh por e gjet portën mbyllur, portën mbyllur dhe që prapa portës disa vërshëllima e kanosje prej një zë plake... Bardhës i shkuan lotët për faqe dhe iku tatëpjetë e turpëruar.

Dhe ja sapo mësoi se do të ndodhte një lindje e re. Nuk e mësoi veç ajo, por gjithë fshati. Në qetësinë e një nate të zezë vjeshte Bardhës i erdhi gjer në kthinën e saj klithma e një rënkimi të fortë. Dhe pikërisht duke dëgjuar atë rënkim, ju duk sikur ai nuk ishte rënkim por një thirrje, një ftesë, një lutje, një britmë dhe kanosje. I dukej sikur **Selimeja e varfër që jetonte aty pranë, me buzët e kafshuara e të gjakosura e shante, e urrente, e quante të pazonjën që nuk dinte të çante terin e natës dhe të thyente llozin e rëndë që plaka i shkonte portës.**

Ajo u vesh shpejt e shpejt, ndezi edhe një gazanik që kishte mbi buhare dhe shkoi e i ra derës së dhomës ku flinte shoqja e saj.

— Tixhe!

— Urdhëro!

— Vishu dhe eja me mua, Tixhe, të keqen...



Tjetra kuptoi që buzët e Bardhës dridhe-  
shin.

U vunë në rrugë, iknin tatëpjetë dhe mamia e re shtrëngonte mbi gjoks çantën me veglat e veta. Kishin vendosur të hynin patjetër gjer te gruaja që përpëlitej e s'lindte dot. Por sa ju afruan shtëpisë, vunë re se s'ishte e lehtë të hynin brenda. M'u përpara portës, ulur mbi sofatët e gurtë rrinin burrat e shtëpisë hund e buzë bashkë, nuk flisnin e as pipëtinin, por mbanin kryet ulur.

— Ti, Bardhë, mos dil, fshihu këtu pas gardhit!

— Jo nuk fshihem, unë...

— Po ti dëgjomë mua, dale, ti qëndro këtu, dale ta marrim shtruar një herë.

Tixhja u dolli shesh burrave:

— Ju lutem shumë, në mos e ndihmoftë Bardha Selimenë, keq s'ka për t'i bërë, le ta thërrsim një herë, të marrim një mëndje, pushteti dhe partia që e kanë dërguar... ajo, po pret ja, aty...

Por gjyshi i shtëpisë nuk e la të mbarojë:

— Unë s'të le ty të kallësh këmbë ndër ne e jo atë zuskë, hajde shporru mos të t'i shoh sytë...

Tixhes i mori zjarr fytyra dhe ja ktheu plakut flakë më flakë. Ajo desh të hapë rrugë, ajo desh të pushojë klithmat e dhëmbjes së Selimesë, ajo desh të thyejë paragjykimet dhe mendimet e mykura, por plaku me llullën ndër dhëmbë as begeniste ta vështronte në fytyrë. E përhumbur para një porte që s'desh të hapej, Tixhja nuk vuri re se nën pezulet e gurta, andej nga e djath-

ta ku kalonte ullishta për në bashtë, një nuse e shtëpisë u vodh e rendi përpjetë. Nusja sapo dëgjoi se Bardha priste atje afër, nuk vonoi ta gjejë.

Kur Bardha u dha në derën e lehonës, katër plaka, si katër poçe të zeza po vërtiteshin rreth Selimesë. Nga buzët i rridhte gjak dhe sytë i qenë zmadhuar. Mbi ballë i qenë shpërndarë flokët ngjyrë gështenjë dhe dukej sikur djersa që i derdhej sumbulla mbi fytyrën e zbehtë, i rridhte nga flokët. Mbi fronin afër Bardha vuri re disa alipsane, një hajmali të madhe bile edhe një ikonë kishe. Bardha ju vu punës dhe nuk vonoi dhe fëmija ra. Gratë klithën të tmerruara. E vjehrra e Selimesë përpiqte duart mbi gjunjë. Fëmija ishte gjallë, por kjo s'ishte gjithçka. Edhe dy fëmijë të tjerë pat lindur kështu Selimeja dhe pas disa çastesh jetë, i kishin vdekur. Duhej vepruar shpejt, rrezik që fëmija të mbytej nga ujrat e tepërta. Tirolet nuk kishte por nxori një gazë dhe ja vu fëmijës mbi buzë dhe me buzët e saj filloi të thithë ujin. Djersët e Bardhës, binin mbi gjoksin e foshnjës, fytyra i kishte marrë zjarr dhe nga të thithurat, Bardhës ju ngritën dy damarë të trashë mbi gushë. Ajo thithte... thithte dhe nëna e mjerë e dërmuar nga lodhja e nga dhëmbjet bëlbëzoi ngadalë:

— Të keqen motër, shpëtoma...

— E ke vajzë, ua sa vajzë e bukur...

— Le të jetë çfarë të jetë, por shpëtoma...

Tashti Bardha thithte ujë nga foshnja dhe lëshonte mbi të lotë gëzimi. Trupi njomzak filloi të marë ngjyrë rozë, në krye u dëgjua një farë



zëri dhe pastaj një piskamë e gjatë dhe e mprehtë fëmije!

Bardhës i shkuan të ngjethura nëpër trup, gjer në thembrat e këmbëve. Ajo e ndjeu veten të lumtur, më të lumtur se kurrë. Ajo piskamë e mprehtë dhe e fortë do të shëmbte mendime të mykura, ajo piskamë e fortë do të thyente lloza të vjetër portash! Ajo po fitonte. Zgjati dorën te dritarja për të marrë flakonin e vogël, por nga shpejtimi e kapi bashkë me perden. Dhe perdja ra poshtë. Jashtë po zbardhonte. Një rreze drite po hynte nëpër xham duke lajmëruar ditën e re.

## SI NJË KËNGË QË U KËNDOHET TRIMAVE

Fillërojtësit trim që ra si komunist në krye të detyrës Pjetër Llesh Doda

Një herë në dy-tri ditë, në deriçkën e oborrit të postës hyn një njeri me rroba tërë baltë, me një të ecur të lodhur e të ngadaltë. Prapa tij perëndon dielli dhe ai hedh mbi çakullin e udhëzëz, në mes gëmushave të trëndafilave një hije të gjatë dhe të stërmadhe. Fytyrën eshtake e ka të argasur nga erërat e cikmat e maleve, në sup i varet një aparat prove e në brez i tringëllijnë kambalecat e hekurit që i bien tek kofshët. Është fillërojtësi i linjës telefonike që kthehet nga puna, që pyet në postë si vjen zëri e që pastaj shkon në shtëpi po nëpër atë udhëz të shtruar me çakëll.

— O, erdhe xha Liko, — i thërret centralistja nga dritarja. Zëri i saj kumbon gëzueshëm e fillërojtësi e kupton që atje tej se punët venë mirë. Kjo do të thotë se linja është më rregull dhe se zëri shkon e vjen për bukuri. Ndryshe, centralistja, një vajzë e re plot prenka të kuqe në fytyrë, nxjerr kokën në dritare dhe thotë:



— Aman, mor xha Liko! Vdiqëm me këtë të shkretë linjë, na plasi.

Po sot, në këtë mëngjez të ftohtë dhjetori, centralistja qëndron prapa shpinës së Likos dhe hesht. Ka dy ditë që linja punon keq e më keq, dy tri lokalitete s'dëgjohen fare, fillërojtësi përgatitet të nisët, po ajo mban frymën e s'di ç't'i thotë. Mbrëmë gjithë natën ka rënë dëborë, shtyllat janë zbardhur nga një anë e, në oborr, gëmushat e trëndafilave ngjajnë si dele që kullosin anës udhëzës së ngushtë. Vendi dhe rrugët janë shkretuar.

— Xha Liko! — thotë më në fund. — S'ke ku shkon sot ti. S'e sheh sa dëborë ka rënë?

Po fillërojtësi përgatit paisjet dhe thotë:

— Paçka, paçka. Ka kohën e vet ajo tashti.

Del në oborr dhe qëndron një hop. Tymi që del nga qyngjet e sobave nuk ngrihet lart si në ditët e qeta të dimrit, po ulet e ulet sa çik kangjellat e kopshtijeve plot me kapuçat të bardhë. Likua e di se kjo shenjë tregon që moti do të prishet, po atë diçka tjetër e mundon. «Dy-tri lokalitete nuk dëgjohen fare!»...

Likua kalon udhët e qytetit, urën me parmakë betoni dhe tashti ecën gjatë rrugës së makinave. Shtrati i bardhë e i heshtur i dëborës së re nis që nga brigjet e lumit e shtrihet gjer tej në horizontin e majave të maleve dhëmbë-dhëmbë; kjo bardhësi e ftohtë dimërore merr lart në faqe kodrash dhe rrëpirash, përmes pyjesh të ngrira dhe lugjesh të thella. Po Likua është mësuar me të gjitha këto. Ai nuk pyet kurrë për motin, aq më tepër në këto ditë kur malësia zien nga ngjarje të mëdha. Fshatrat malore po ngrenë kooperativat e reja bujqësore. Këto fshatra, nëpërmjet linjës që ru-

an ai, lajmërojnë qendrën se u bashkuan. Kjo linjë ka një fuqi të çuditshme, ajo i afron kaq shumë vendet, njerëzit. Po ja, dy-tri lokalitete s'dëgjohen fare. Ç'bëhet andej: pas maleve e rrugëve të shkretuara nga dëborë?

Ecën nën fijet e telave që hidhen sa në një shtyllë në tjetrën. Këta tela herë dalin në sheshe të shkreta, herë zbresin në përrenj e herë zhyten mes drurëve të pyjeve. Rreth e rreth hapen largësitë e shurdhëta dimërore, rrallë të zë syri ndonjë kalimtar. Fshatrat e qytezat e gjeologëve janë larg, matanë rrëpirave të kredhura në një mjegull të përhime. Kjo mjegull i ngjan një deti të çuditshëm që hyn e del nëpër gjire malesh; një deti të heshtur, pa zhurmë e pa dallgë. Po Likua s'e ndjen veten kurrë vetëm. Heq sandalet e dëborës, lidh në këmbë kambalecat, ngjitet në shtyllë dhe lidh në linjë aparatit e provës: «Alo, alo! Jam Likua, Xha Likua, si më thua zotrote».

Centralistja me zë të bukur që i kumbon në kufje, gëzohet dhe i thotë: «Ti xha Liko?! Hë, si ja çon? A ka dëborë shumë? Lidhu më shpesh me mua». Bëjnë ca shakara në telefon dhe pastaj ai zbret e vazhdon rrugën mbi shtratin e trashë.

— Nga shkon kështu, o Liko? — i thotë ndonjë kalimtar i rrallë që e takon rrugës.

— Ja, kontrolloj linjën, — i përgjigjet ai.

Udhëtari tregon me kokë malet e veshura me re dhe thotë:

— S'e sheh si është nxirë andej? Ktheu, ka për të të zënë tufani.

— Paçka, paçka — ja kthen Likua dhe vazhdon rrugën nën telat që varen në shtylla.



Ai kurrë nuk është kthyer ndonjëherë nga rruga, kurrë nuk janë ankuar nga puna e tij. Kurse këtë radhë nuk dëgjohen fare dy-tre lokalitete. Ç'bëjnë ata njerëz andej në këto ditë që ngrihen kooperativat? A mund të kthehet ai nga rruga?

Si kapërcen të përpjetën, linja del në majën e një bregoreje dhe bie në një luginë, në shpatet jugore të maleve të Rutës.

Likua e di, se sapo të kalojë një kodër të vogël, atje përpara duket ekspedita gjeologjike e Serinës. Kalon kodrën dhe zbret drejt barakave bojëhiri që tymosin nga çatitë e zbardhura. Në këto baraka sa herë që vjen këndeje Likua qëndron një hop: ha bukë, pi një cigare dhe nisët prapë.

Po ja, sapo doli në këto anë, zuri të fryjë një erë e furishme. Gëmushat nisën të lëkunden fort e më fort e pyjet oshëtinë mbytur. Fillërojtësi e di se këto shenja tregojnë afrimin e suferinës.

Fut cepat e peshqirit më thellë jakës së gëzofit që të mos i hyjë era dhe ecën. Telat e linjës kanë zënë të gumëzhijnë e kjo gumëzhitje i ngjan zhurmës së largët të një skuadrilje avionësh, po Likos i pëlqen shumë kjo këngë telash, kjo këngë që i jehon në vesh ditë për ditë.

Suferina po shtrëngon.

«Bah, si fryn e uruara» — thotë fillërojtësi me vete. Në torbë ka një kokore leshi dhe ka ndaluar rrëzë një shtylle e mundohet ta gjejë me duart e ngrira. Pastaj e ngjesh fort kokoren në kokë, e lidh nën gushë e çan përpara. «Tek shtylla tjetër do të lidhem me centralin. A vete zëri?»

— mendon ai. Po shtylla tjetër as që duket gjëkund  
dhe Likua udhërrëfyet ka fijet e holla të telave që  
gumëzhijnë nga era. Po edhe ata herë duken e herë  
zhduken në valët e pluhurit të dëborës. Në këto raste  
fillërojtësi e ka keq. Nuk e merr vesh në janë nga-  
tërruar diku, a janë këputur telat. Qëndron e mu-  
ndohet t'i shquajë me sy, t'i mbështjellë me duar.  
Pastaj ai merr drejtimin e niset prapë. Ja dhe  
shtylla. Fillërojtësi ve kambalecat, lidh rrypin e  
brezit, dhe ngjitet.

— Alo, alo! Jam Likua.

— Hë, mor xha Liko? Ç'u bëre kaq kohë  
ti? Nga flet?

— Ja këtej nga Qafa e Lisit. A vjen zëri mi-  
rë? Unë mirë të dëgjoj!

— Nga Qafa e Lisit?

Centralistja hesht për një hop.

— Xha Liko, a dëgjon? Nga Qafa e Lisit  
the? A ka dëborë shumë?

— Oo, sa të duash. Tashti ka zënë të fryjë  
dhe suferina.

Centralistja prapë hesht një hop e thotë:

— Kthehu në ekspeditë, xha Liko. Ç'bën ti  
përmes suferinës? Kthehu, kthehu.

— Pa çka, pa çka. E kam lidhur fillin në tri-  
katër vende. Akoma s'dëgjohen lokalitetet?

— Jo, s'dëgjohen.

— Mirë, unë po vazhdoj. Do lidhem prapë  
me ty.

Centralistja do të thotë edhe diçka tjetër, po  
fillërojtësi e heq aparatën dhe zbrat.

«Vajzë e mirë, shejtanka. Vajzë e dhëmb-  
shur...»

«Një herë...» — Likua shkund kokën fort



dhe thotë: «Ama, zure të tregosh histori me veten tënde? Ai e di se, kur njeriu zë e tregon histori me veten e vet në mes të të ftohtit, do të thotë se e kot gjumi. Po gjumi është vdekje në dëborë.»

Nxiton të arrijë tek shtylla tjetër. Qafa i dhemb duke kërkuar telat me sy të picërruar. Fillërojtësi ndjen se këmbët i janë bërë dru. Qepallat i rëndojnë e i vjen të ulet diku sa të çlodhet pak. Sa orë ka që udhëton nëpër dëborë? Po ai nuk ulet gjëkund. Nga larg dëgjon ulërima ujqësh. Këto ulërima era i bie shumë afër. Likua e di se në një mot të tillë ujku të çan.

«Bah, ç'rrugë e ligë», — thotë me vete. «Grenda të thepisura që mos të shkeltë këmba».

Rruga e fillërojtësit është e vështirë, rrugë e pa rrugë.

Del në një shesh dhe aty sheh se një shtyllë është mënjanuar: Tufani ka rrëzuar mbi linjë një pishë, ajo ka këputur telat dhe shtyllën e ka luajtur nga vendi.

I afrohet shtyllës. Ajo është mënjanuar shumë dhe Likua i vë shpatullat ta drejtojë. «Të mos jetë thyer — thotë — pa bëjmë si bëjmë».

«Dhe ai rojtari i pyjeve. Bah, të le të vesh sëpatë gjëkund! Po pse mor i uruar, pesë fije dru mund t'i heqim, ata që na prishin linjën. Po ku të dëgjon ai! E bëj çështje në komitet të thotë, tuafi!».

Shtylla u drejtua disi, fillërojtësi qëroi dëborën me duar gjeti nja dy gurë dhe ja ngjeshi në rrëzë. «Sikur të kisha një bigaçe e t'ja vija, mirë do të qe, po s'më shkoi mendja të merrja sëpatë». E ndjeu veten të gëzuar që shtylla nuk

ishite thyer e që mundi ta drejtojë një farë soji. Dhe izolatorët s'kishin pësuar gjë. «S'të bën punë dosido Likua — thotë me vete. — Këta izolatorë i vura vjet dhe ja, mbahen për bukuri».

Një vrundull ere i përplasi dëborën në fytyrë dhe i qorroi sytë.

«Plaç! — shfryu fillërojtësi. — Nga na befte kështu?» Fshiu sytë dhe u nis të gjejë telat. Një fije është mbështjellë pas një dege të pishës së rrëzuar dhe ai nxjerr pincat dhe e tërheq. E bije pranë shtyllës dhe niset prapë. Fijen tjetër e gjeti larg, rrëzuar në një hon. E tërheq me duar që i dhembin dhe e bie dhe atë pranë shtyllës. Gjen edhe fijen e tjera përmes tufanit që fryn e shfryn si i çmendur. Dita po shuhet dalngadalë, është ditë e shkurtër dhjetori dhe fillërojtësi nxiton. Merr fijen, ngjitet në shtyllë, i shton një copë tel dhe e lidh në izolator. Zbret, merr fijen dhe ngjitet prapë. Duart i ka të mpira dhe mezi punon. Pastaj, si i ka lidhur fijen të gjitha, vë aparatën e provës:

— Alo, alo!

— Hë, ti xha Liko je?

— Unë moj çupë, unë jam. A vjen zëri?

— Po po, vjen xha Liko, vjen. Po ku je, mor xha Liko, se na bëre merak? Po erret dhe ti akoma je andej. Po në atë kohë dëgjohet dhe një zë tjetër. Është centralisti i lokalitetit të Malasit.

— Alooo, aloo, — vjen zëri i tij i stërgjatur.

— Ti Rrapi je? Jam Likua.

— Likua nga flet kështu?

— Nga Qafa e Lisit. Ishin këputur fijen, po i lidha.

— Mjaft, xha Liko. Ku do të shkosh sonte



ti? Sa larg që ke ikur, — ky është zëri i ëmbël e i merakosur i centralistes, i asaj vajze të re me prenka të kuqe në fytyrë.

— Po ja, s'dëgjohen lokalitetet e tjera, moj çupë. Me Malasin u lidhe?

— Po, u lidha. Po ti ik nga linja tashti, ç'bën kështu? Do të të zërë nata. A fryn erë?

— Fryn, fryn — thotë fillërojtësi — pa çka, ka kohën e vet tashti.

Ai gëzohet që nga ky vend i shkretë flet dhe dëgjon zërin e dy njerëzve. Ja, Malasi u lidh me qendrën. Likos i gufon zemra. Po ai s'mund ta lerë punën në mes. Kurrë nuk është kthyer nga rruga pa e rregulluar linjën mirë. «Ja sa të zbres gjer në Trull, ta shohim si janë fijet këtej e mund të fle tek ndonjë fshatar sonte».

Lë Qafën e Lisit prapa e nisët drejt Trullit, një fshati të vogël, futur thellë një gryke të ngushtë malesh. Po Trulli është larg, në mot të mirë i bën nja dy orë e ca, kurse përmes tufanit...

U err fare. Përmes natës ulurima e tufanit të shtie dridhërimën. Pyjet lëkunden e shkunden diku nëpër errësirë. Fillërojtësi është rraskapitur. Ka gjithë ditën e ditës që udhëton. Herë-herë ndalet e i vjen të shtrihet, të marrë një sy gjumë. Po s'e jep veten. Ja një shtyllë. Likua i ngjitet, prek telat me dorë. Ata janë në rregull. Mbështet kokën pranë izolatorëve dhe dremit pak. Në ëndërr sheh një ditë plot diell, livadhet që lulëzojnë e lëkundin barin e hollë nën filladet e ëmbël...

Hap sytë dhe zbret nga shtylla. «Ç'm'u qep ky djall gjumë? — grindet me vete. Merr ca dëborë e fërkon sytë, qafën. Tashti s'i bëhet ta li-

dhë më aparatën në linjë. Ç'ti merakos kot njerëzit — thotë — kur të arrij në Trull, do të lidhem me centralin».

«Sa të zbres në përrua — mendon fillërojtësi — pa aty e gjej kollaj rrugën për në Trull».

Përpiqet mos gjen linjën, po ai ka një gjysëm ose e ca që s'ndeshet më në shtylla telefonit... Diku u ngatërrua dhe në këtë tufan e errësirë ish e pamundur që të gjente prapë linjën.

«Ku i pate mendtë?» — qorton veten.

«Po ç'u bëre, mor xha Liko? Hajde, kam ndezur një zjarr të mirë. Lokalitetet dëgjohen për bukuri dhe ti ulu e haje këtë bukën e thekur». Centralistja buzëqesh. Likua dredh një cigare dhe dëgjon drutë që kërcasin në zjarr...

— Ah, kjo e shkretë këmbë! — thotë ai, si përmendet nga dremitja. — Më shtrëngon sikur e ka zënë ngërçi...

Përkulet që ta fërkojë, po shembet mbi dëborë. Oh, sa mirë i vjen tashti që është shtrirë gjërë e gjatë. Sikur ka rënë në një dyshek me pupla e i vjen të bjerë në një gjumë të thellë, të thellë.

— Hë, të uruarën, — shan veten e ngrihet me mundim të madh.

— Më kapiti gjumi sikur të kem ngrënë bukë egjëri. Po s'duhet të fle.

Tashti ka zënë të bjerë një dëborë e dëndur, me slloga të mëdha. Era sikur u platit pak.

— Kjo dëborë do të shtrojë mirë — thotë fillërojtësi — era e ngriu shtratin e vjetër. Qe erë alpesh, stocen.

Ai dallon se si i ngarkohen supat, krahët, këmbët nga këto slloga të mëdha.



Ka dalë në një shesh të shkretë dhe vendi vjen i përpjetë. Ngjitet duke gulçuar. Sandalet mezi i ngre; aparati dhe këmbalecat i rëndojnë plumb. Papritur dëgjon një gumëzhitje të lehtë, gumëzhitje që vetëm veshi i tij e kap përmes oshëtimës së suferinës.

— Pa dale?!

Mban këmbët e zbulon veshët: Linja gumëzhin aty afër.

— Aa, këtu më qenke? Dhe unë pandeha se të humba. O mor Liko, ke filluar të rrjedhësh.

Vete pranë linjës dhe i ngjitet sheshit, shtyllë më shtyllë.

— A, paskam lajthitur rrugë, — thotë fillërojtësi e ndalet duke gulçuar. Para tij qëndron shtylla e mënjanuar. Ja dhe grumbulli i dëborës që ka qeruar ai me duar. Më tej duken degët e pishës të rrëzuar.

Kthehet prapë.

— Gjer në Trull mund të zbres, — thotë. — Ekspedita është më larg, rruga është e keqe.

Pasi ecën një orë, diku këmbët i zënë një fill të këputur. Fillërojtësi e shkël nga dëborë, e tërheq dhe e çon gjer tek shtylla. Heq sandalet, vë këmbalecat e bën të ngjitet në shtyllë. Po më kot: këmbën e ka të ngrirë.

Tashti s'i bëhet më të flasë me vete e të mendojë për diçka. Gjumi po e kapit fare dhe atij i vjen të shtrihet në dëborë. Ecën jashtëzakonisht ngadalë, vende-vende ndalet, mbështetet pas ndonjë trangu e pastaj prapë nis. Ndjen një mpirje të përgjithshme. Sillogat e dëborës sikur e ledhatojnë dhe atij i vjen mirë të kthejë kokën nga ana që fryn era...

Ka arritur në një shteg shkurresh. Duhet të ngrejë këmbën që të hidhet matanë, po s'e ngre dot, s'e komandon dot. Mbledh të gjitha forcat, i jep trupit para dhe rrëzohet.

— Hë — thotë me vete. — Je lodhur shumë, o Liko? Pa çka, pa çka. E ke keq me këtë djall këmbë.

Ngrihet dhe vazhdon të ecë. Po prapë rrëzohet. Oh, sa i flihet, sa mirë është të marrësh një sy gjumë... Vetëm pak... vetëm pak dhe pastaj... Ja, një minutë... vetëm një minutë... Mbyll sytë dhe fle. Gjumi i ëmbël i dëborës e çon sërishmi në livadhe me lule, në linjën që gumëzhin nga flladet e pranverës, ndërsa zogj ulen e ngrihen fluturim mbi telat e hollë.

Fillërojtësi fle, dhe mbi të, pyjet e borigave oshëtijnë. Në fillim mbi trupin e Likos bie një shtresë e hollë dëbore, pastaj ajo vjen e trashet, gjersa bëhet një me bardhësinë e ngrirë dimërore.

Borigat oshëtijnë. Kjo oshëtimë është si një këngë që u këndohet trimave...



## BURRËRI

Tërë ajo hapësirë pa njerëz, dukej tashmë si një shesh ku do të ndaheshin dy forca, të cilat kishin kohë që ruanin përbrënda një urrejtje të madhe. Kështu mund të mendoje ato çaste. Ndërsa ata dymbëdhjetë burra të jepnin përshtypjen e një kuvendi të vogël, apo një këshilli që bëhej gati të drejtonte betejën. Në lumë doli barka D-L-5 dhe katër ushtarë që ishin në të. Ajo hepohej nga rryma e ujit që i përplasej mbi faqe, por nuk ndiqte rrjedhën e lumit, sepse dymbëdhjetë burrat e mbanin të lidhur me një litar të trashë që sipër nga ana e Rrogozhinës.

Pas pak, tej nga bregu tjetër, buçiti zëri i komandantit që nisi të jepte urdhëra. Atëhere të dymbëdhjetë burrat e lëshuan fillin e trashë të litarit dhe barka shpejtoi poshtë, në drejtim të rrjedhës. Ajo ndali atje ku humbisnin ndën ujrat e turbullta të lumit themelet e një ure të vjetër. Barka u qetësua disi. Pastaj, komandanti diç urdhëroi përsëri që tej nga bregu. Të katër ushtarët, që ndodheshin brënda në barkë, filluan të punonin shpejt dhe me kujdes. Në barkë kishin pesëdhjetë kilogram tritol, të cilin e kishin ndarë në dy ngarkesa. Vullnetarët e rinj që ndo-

dheshin përreth, nja treqind metra larg, prisnin me ankth shpërthimin e tërë atij tritoli, por atyre katër ushtarëve s'u bënte shumë përshtypje, megjithëse duhej të ishin të kujdesshëm. Këtë e dinin mirë dhe këtë ua përsëriste shpesh komandanti. E vendosën tritolin në vendin e duhur, atje tek zgavrat e betonit të themeleve të asaj ure të vjetër, dhe shtrinë mirë fitilin.

Pastaj u çuan në këmbë dhe shikuan nga komandanti, shikuan nga vullnetarët dhe për një çast vështrimi ndeshi në gjelbërimin e fushave.

Të dymbëdhjetë burrat që ndodheshin sipër, tek ura e kalimit, u bënë gati të tërhiqnin litarin porsa të ndizej fitili, sepse litari lidhej tek barka D-L-5 dhe në atë barkë ndodheshin katër ushtarë që ato çaste kundronin gjelbërimin e fushave.

Komandanti i paralajmëroi edhe një herë për kujdes, për gjakftohtësi dhe, duke shikuar nga ata që do të tërhiqnin barkën, vërejti orën dhe urdhëroi të ndiznin fitilin.

Fitili u ndez. E ndezën ata katër ushtarë, vullnetarë të hekurudhës së madhe, ndërsa që tej nga bregu, fytyra të njoma vullnetarësh prisnin të shqetësuar shpërthimin e tërë asaj ngarkese. Ndërkohë, që lart nga ura, të dymbëdhjetë burrat tërhiqnin barkën. Barka çante me vështirësi në drejtim të kundërt të rrymës, ndërsa komandanti ndiqte akrepat e orës. Pas tetë minutash ata katër ushtarë duhej të ishin larguar treqind metra nga vendi ku do të shpërthente eksplozivi. Kështu kishin vepruar çdo herë dhe çdo herë puna kish shkuar mbarë. Andaj Dabo Tekiu dukej aq i qetë, po aq të qetë dukeshin edhe tre ush-



tarët e tjerë. Por të dymbëdhjetë burrat e tërhiqnin litarin e trashë me ngut. Në tërë atë ngutësi, që tej nga bregu, vullnetarët dallonin një farë tendosjeje të shqetësuar. E ndjenin a e merrnin me mënd, këtë askush s'mund ta përcaktonte. Por diçka të tillë ata e vinin re tek të dymbëdhjetë burrat, tek ata që «kishin dalë atje për të drejtuar betejën». Ndaj ata ishin vendosur dhe ashtu, të tendosur e të shqetësuar, e tërhiqnin litarin që lidhej tek barka. Por pikërisht në atë çast, ndodhi diçka e papritur. Litari i trashë u këput. Gjysma ngeli nga ana e atyre që e tërhiqnin, gjysma tjetër ngeli e lidhur në kyçin e barkës. Ai u këput, ashtu, befasisht, atje poshtë në thellësitë e ujrave të turbullta të lumit. Qysh u këput?... E kush mund të përgjigjej ato çaste për këtë? Të dymbëdhjetë burrat, që ndodheshin përmbi urë, e tërhoqën edhe një herë litarin, po përsëri ata e ndjenë dhe e panë mirë se ai ish këputur. Për një çast u stepën të turbulluar. Nga larg erdhën klithma të vullnetarëve dhe zëra të lartë e të trashë të punëtorëve që thërrisnin. Komandanti thirri fort. Burrat thirrën.

Dallgët e lumit rrokulliseshin të çfrenuara. Ato përplaseshin tek bashi i barkës dhe barka me të katër ushtarët bëri një kthesë të fortë e mori teposhtë, tek këmbët e urës së vjetër, atje ku nga çasti në çast, pritej të shpërthenin pesëdhjetë kilogram tritol, në dy ngarkesa.

- E?! — thirri fort njëri nga të katër.
- Burra, a e shihni, litari u këput!
- U këput.
- Shpejtoni! — thirri dikush.

Një çast shikuan shoshoqin. Ndërsa barka po rrëshqiste drejt rrjedhës, ata filluan të xhvishen me të shpejtë. Njeri kërkoi pincat. U end nëpër dyshtemenë e barkës, i gjeti, i rrëmbeu, i shtrëngoi fort në dorë dhe shikoi shokët.

— Duhet prerë fitili!

S'i kishin çveshur tërë rrobat, por ashtu, të katër kërcyen në lumë. Dhe nisën të përplasnin këmbë e duar. U ndodhën shumë afër fitilit që po digjej.

Ata ishin katër ushtarë, katër djem të rinj, që kishin zbritur nga fshatra të ndryshme të Shqipërisë dhe kishin ardhur aty për të ndihmuar në ngritjen e asaj ure të re të madhe ku, pas ca kohe, do të rrëshqasë treni. Ndodhi që të katër ata ushtarë, të katër ata djem nuk dinin mirë not. Ndaj, një herë tjetër askush prej tyre s'do të guxonte të hidhej përmbi krahët e çfrenuara të atij lumi që ish fryrë aq shumë. Por tashti ndodheshin përballë një vdekjeje të sigurtë, dhe vdekja i shtyu të kërcenin brënda dhe...

Edhe katër minuta dhe tritoli shpërthente.

Ai ushtari që kish shtrënguar fort në dorë pincat, mendohej t'i afrohej fitilit. Donte që ta priste. Në një kohë mundi t'i afrohej dy-tri metra, por nuk arriti. Vala ishte e fuqishme dhe ai s'dinte not mirë. Bëri që të shkonte edhe një herë tek fitili, por përsëri vala e pështolli ndën krahët e lagura dhe e nxori poshtë. Atëhere të katër ushtarët bënë në drejtim të valës. Vala kalonte me furi aty ku ishin tendosur ngarkesat e tritolit. Atje po rrëshqisnin ata të katër ushtarët, atje ndanë tritolit ose përmbi ngarkesën e tritolit. Po afroheshin çastet kur do të shpërthente tritoli.



Në luftë me çastet duhej kërkuar guxim dhe gjakftohtësi. Aty ish fusha e betejës, aty ndodhte beteja. Ishin katër njerëz dhe lumi i tërë që i shtynte drejt shpërthimit të pesëdhjetë kilogram tritoli. Ata dukeshin dhe zhdukeshin, ata ndesheshin luhateshin, ndërsa dallgët rrokulliseshin dhe vdekja priste e ftohtë, atje ndën dallgët e turbullta, atje në brumin e tërë asaj mase tritoli.

Dhe... kaloi i pari, rrëshqiti dhe i dyti, të tretin, Kadriun, e mbërthyen dy hekura, që ngrinin krye poshtë ujrave.

Ai që rrëshqiti i pari, u rrotullua në vend, humbi ndën ujë, nxori pak kryet dhe thirri:

— Kadri!

— Më kapën hekurat.

— Kad...

Atë e futi rrugala poshtë.

U kthye e foli tjetri, ai që vinte i dyti.

— Jepi fort, Kadri!

— Hekurat! — thirri Kadriu.

— Po, jepi, bre, burrë!

Ai që i tha «jepi bre, burrë!» u mundua të kthehej. Eci pak, por vala, sikur të loste me të, ju përplas në fytyrë dhe e fundosi poshtë.

— Kadri! — thirri një çast ai i pari. — Gjakftohtë, gjakftohtë, jepi...

Atë kohë u ndie një «blluf» dhe Kadriu humbi nëpër ujra. S'kaloi shumë dhe ngriti krye diku më poshtë vendit ku e kishin kapur hekurat.

— Shpëtova! — thirri. Dhe vazhdoi të përplasë këmbë e duar.

Pastaj tha:

— Dabo Tekiu ku është?

Të tre nuk rrëshqisnin. Mوندoheshin të ndalnin në vend a të bënin në drejtim të kundërt të rrymës. Se dikush nga shokët kujtoi një shok tjetër që ende ndodhej prapa, që ende s'kish kaluar atë vend ku ishin pesëdhjetë kilogram tritol, i cili së shpejti pritej të shpërthente nga çasti në çast. Dhe ndalën atje e përlesheshin me dallgët e akërryera të lumit. Por ato i vunë përpara dhe ata s'mundën ta dallonin më atë shokun e tyre, Dabon, i cili vinte i fundit dhe që mbase dinte më pak se të gjithë not.

Ja, edhe dy minuta dhe ndodhte shpërthimi. Komandanti vullnetarët, vullnetaret e reja, thërrisnin me të madhe. Dikush mوندohesh të mbante dikë. Dhe kë mund të lejoje të hidhej për ndihmë! Aty pranë ndodhej pesëdhjetë kilogram tritol, i cili pas dy minutash do të shpërthente dhe... Ushtar Dabo Tekiu ngeli në mes të ujrave, jo shumë metra larg vendit ku ish vendosur tritoli. Vullnetarët klithën me të madhe. Dikush nga ata u mundua të shkëputej nga turma, por dikush tjetër e ndaloi. Të dymbëdhjetë burrat, që dukeshin si një trug i madh, i trashë, i vrarë, thirrën. Thirri edhe komandanti.

— Ushtar Dabo Tekiu, shpejto.

Dhe erdhi një zë i përmytur që tej nga ujjrat e turbullta.

— Një hekur më ka mbërthyer fort, komandant. Ishte zëri i Dabo Tekiut.

— Mوندohu të shkëputesh, ushtar Dabo!

— Nuk mundem... Është vonë, komandant!

— O burra!... ja bëri dikush nga ata të dymbëdhjetët, me një zë të trashë, disi të mekur.

Të tre ushtarët e tjerë ende luftonin me uj-



rat që i kishin vënë përpara, por tashmë ishin larguar shumë nga vendi i shpërthimit.

— Është vonë, komandant! — erdhi përsëri gjer në breg zëri i Dabos.

Atij i dukej vetëm një pjesë e kokës. Ai rrinte atje dhe, që larg, dukej sikur ndodhej aty që të ruante vdekjen, a që t'i tregonte dikujtse aty duhej të çaheshin themelet për të hedhur atë urë të madhe ku do të kalonte treni.

Ushtar Dabo Tekiu kishte zbritur që nga malësia e Korçës dhe...

«Kur tritoli shpërthen ndën ujë, kryet duhet nxjerrë jashtë, pastaj... Ky lumë buron që andej nga malet e Llëngës. Kam qenë atje unë, kam qënë. Ky del i kulluar atje, por e turbullojnë rrëketë dhe balta.

Pastaj i përhihesh kopeja e dhive, zilet, lajthitë... Eli!...

Ajo rrokullisej nëpër malet e zgjatura të dallgëve dhe vinte e e puthte në fytyrë, ajo, Eli...»

— Ushtar Dabo, po të kujtoj dhe një herë rregullat e shpërthimit në ujë — thërriste komandanti.

— ... «Ja, për dy muaj do të vish edhe ti, Dabo, dhe mbase na bie të vemi bashkë në akcion. Aty në Myzeqe do të vimë më duket...».

— M'u përgjigj, ushtar Dabo!

Ai u shkund dhe u mundua të dëgjonte komandantin.

— Si urdhëron, komandant! Rregullat e shpërthimit.

— Kur tritoli...

— Si urdhëron, komandant, kur tritoli...

— Ja, tashti, tashti do të ndodhë shpërthimi i parë, ushtar Dabo... Tashti...

Ai shtrëngoi fort muskujt e fytyrës dhe duke u kapur edhe më pas hekurit që e kish mbërthyer, nxori më lart kryet dhe thirri:

— Komandanti nuk ka faj. Unë do të shpëtoj.

— Komandanti pa orën dhe thirri:

— Gati!

— Unë do të...

U ndie një shpërthim i tmerrshëm, pastaj një mjergullë e bardhë. Dhe pas pak, doli përmbi ujë koka e ushtar Dabo Tekiut.

Të gjithë zmadhuan sytë dhe morën frymë thellë. Ja, tashti do të ndodhte edhe shpërthimi i ngarkesës së dytë.

— Kujdes, kokën fute në ujë pas shpërthimit — thërriste komandanti.

— Unë do të...

Një shpërthim tjetër, i fuqishëm. Nja tre metra ndan ushtarit, që ish fshehur ndën ujë, ra një masë e madhe betoni, të cilin e hodhi tritolli. Dhe Dabo Tekiu përsëri ngriti kryet dhe mundi të thotë:

— Asgjë, asgjë...

Lumi rrokulliste valë të turbullta, ndërsa jehona e shpërthimit të minave ish larguar tej. Ata që ndodheshin përreth shikonin dhe dukej sikur s'besonin për sa panë ato çaste, s'besonin se sytë e tyre kishin parë një ushtar, një të ri, që i qëndroi vdekjes aq pranë, aq gjakftohtë, që e kundërshtoi hijen e saj me aq guxim.

Masa e vullnetarëve, e punëtorëve, e njerëzve të tjerë thërriste fort, bërtiste. Dhe nëpër mollëza filluan të rënonin edhe lot.

U shkëputën tre vullnetarë nga ajo masë njerëzish dhe ranë në lumë. Jepnin e merrnin që



t'i shkonin ushtar Dabos në ndihmë. Se ai i shpëtoi shpërthimit të tritolit, po ende s'i kish shpëtuar lumit. Se s'dinte not Dabo Tekiu, se një hekur i ngritur tej ndën ujra, e kish mbërthyer fort, se lumi po e ftohte dhe dallgët që i përplaseshin fort, po ja merrnin edhe fuqitë e fundit.

Vullnetarët mundoheshin t'i shkonin afër, ta kapnin nga krahu, t'i jepnin zemër, ta ndihnin të delte mbanë, por rryma ishte e fuqishme dhe ajo disa herë i nxori ata poshtë, diku gjetkë. Atëhere vullnetarët shkuan te barka D-L-5, e cila ish pleksur diku më tej vendit që ndodhej ushtari dhe mundoheshin që të çonin atje barkën.

Kaluan kështu minuta. Dhe tashti çdo çast nuk ishte më pak i tmerrshëm se sa ato minuta të pakta kur pritej shpërthimi i tritolit. Se kish shkuar shumë dhe Dabo Tekiu ishte ende atje midis ujrave të ftohta, atje ku i dukej vetëm pāk koka, atje ku e rrihnin pa mëshirë dallgët që rrokulliseshin me të shpejtë, atje ku po i errësohej gjithëçka dhe po e linin fuqitë. Se ato çaste po i këputej dora, e cila ish kapur pas asaj shufre të ftohtë hekuri, se ato çaste ai... Dhe ata të tre vullnetarët e njomë jepnin e merrnin me dallgët e rrëmbyera, jepnin e merrnin me atë barkën e pleksur atje tej, por ende s'po i vinin në ndihmë njeriut që treste fuqitë e fundit. Kish kërcyer në lumë edhe komandanti, edhe një tjetër edhe një burrë, edhe... Por forcat e verbëra të natyrës nuk i linin ata të qaseshin pranë ushtar Dabo Tekiut.

Dhe zbriti atëkohë prej një makine me targë «El», një njeri. Shpejtoi në breg, çveshi

kostumin dhe ra në ujë. Mbase dinte not, më mirë se tërë ata që po përplaseshin me rrymën, andaj shkoi aq shpejt tek ushtar Dabo Tekiu.

— Të lumtë, ushtar, — i tha ai.

Ushtari bëri të ngrinte pak kryet, lëshoi një buzëqeshje jete dhe tha:

— E pse... po shokët dolën?

— Të lumtë, dolën... Mbahu.

— Po mbahem.

— Ma jep krahun.

Dhe i hodhi dorën ndën sqetull e e ngriti lart. Ndërkohë ata tre vullnetarët dhe komandanti po afronin barkën. Njëri prej tyre mbante ekuilibrin e saj, ndërsa tre të tjerët e shtynin. Ai njeriu, që kish zbritur nga ajo maqina me targën «El», me një dorë ngrinte lart Dabo Tekiun, ndërsa me tjetrën tërhiqte litarin e barkës.

Kish kaluar një orë e njëzetepesë minuta. Pas aq kohe Dabo Tekiu doli nga ujrat e turbullta dhe të ftohta të Shkumbinit dhe përsëri kërkoi t'i shihte edhe një herë të gjithë, të shihte ata të tre shokët, komandantin.

Njeriu që zbriti nga maqina me targën «El» dhe ra në ujë e shkoi pranë Dabo Tekiut, u largua.

— O burrë, kush je ti? — e pyeti njeri.

— Unë?

— Po ti që i erdhe në ndihmë atij të riu, ti që na erdhe në ndihmë neve.

— Një njeri.

— Po a e di ti, mor burrë...

— Hajt mirupafshim.

Dhe ai njeri u largua pa e thënë emrin.



## «NJË FJALIM I SHËNUAR PËR JETËN TIME»

Sytë e saj, fytyrën e saj, në atë orë hartimi, asaj ore kur ajo shkruante: «Shoku Enver udhëheqës i dashur për ne» nuk mundem t'i harroj kurrë. Lëvizjet e duarve, njomja e bebëzave të syve dhe tërë përqëndrimi i qenies së saj në atë fletë të bardhë të fletores, që dalëngadalë po mbushej me fjalë e fjali të tilla, që ja bënin fytyrën, tërë qënien e saj të jashtëme, që të binin menjëherë në sy, më kanë mbetur përgjithmonë në kujtesë. Më binte vetëm mua në sy, pasi ajo rrinte në bangën e fundit. Rrinte e vetme. Edhe nxënësit e tjerë ishin kredhur në fletoret e tyre.

Pasi ra zilja, mblodha hartimet dhe si përco-lla nxënësit, fillova të çfletoj fletoren e saj. Më doli përpara syve përsëri fytyra e saj, sytë e skuqur, mënyra e të shkruarit, ngjyrat e fytyrës që i venin dhe i vinin, dhe ja tashti në atë faqe të fletores shoh një shkrim jo të kujdesshëm, një faqe me ca njolla, thua se po e ndiqnin nga pas, a thua se do t'i iknin mendimet pa i shprehur...

Të them të drejtën nuk më erdhi mirë kur e pashë shkrimin e keq dhe njollat në fletore. Këtë grua e kisha një nga nxënëset më të mira... Megjithatë lexoj.

Për një çast u pendova që tregova një interes të veçantë për atë fletore... Por se si kurreshtja më detyroi që ta lexoja përsëri, të shihja frazën e saj të shkurtër dhe konçize dhe të analizoja domethënien e çdo fraze, fjalie e fjale që ajo kish shkruar:

«...Shoku Enver ka thënë: T'i flakim tutje zakonet prapanike...». Tri fjalët e para të kësaj fraze i kish shkruar bukur, pastër, pastaj e kish prishur shkrimin e në fund kish një njollë. Më tërhoqi njolla. M'u kujtuan sytë e saj të skuqur e tërë lot... dhe... lexoj përsëri: «...Shoku Enver ka thënë...», shoh njollën e bërë nga boja ende e patharë me një pikë loti të saj. Shoh njollën; dhe prapa asaj njolle të lotëve të saj lexoj një pjesë të historisë, historinë që ma ka treguar dhe ajo vetë me gojën e saj.

Shqipja tashmë është njëzet vjeçe, por dashurinë e babës, përkëdhelitë e tij nuk i ka provuar kurrë. Jo se nuk ka pasur baba, ai jeton edhe sot. Jo se ai ishte mërguar diku jashtë shtetit, jo, ai është në shtëpi. Mos ndoshta ka qënë i ashpër, i keq? Për këtë nuk mundem të flas «Oh, jo! Sa zakone të ndyta ka pasë jeta. Im atë është gjallë. Im atë jeton në shtëpi. Im atë tashti është nëntëdhjetë vjeç» më tha kur e pyeta. Ajo veç rënkimeve të tij, kollës, nuk kishte ndjerë gjë, pasi ai, i ati i Shqiponjës, ishte martuar me nënën e saj kur ai i kishte mbushur 70 vjeç. «— U martua me nënën time njëzetvjeçare, se ish në gjëndje. U martua me nënën time se ashtu e desh zakoni» — thotë ajo.

Kështu Shqipes ju desh, që në moshë të vogël, të ndjejë vuajtjet që hiqte e ëma, barrën e



rëndë të jetës, drurin që ajo hante jo më nga i shoqi, se ish i vjetër, por nga i biri, që ish më i madh edhe se vetë njerka e tij, e ëma e Shqipes, domethënë nga druri që hante nga vëllai i Shqipes me nënë tjetër. Ndërsa i ati duke zgjatur qafën tërë rrudha si të breshkës, pinte duhan dhe bënte sehir. Herë herë jepte edhe urdhëra që i biri të qëllonte akoma më tepër mbi nënën e Shqipes.

Shpesh e ëma ish matur të ikte. Të merrte edhe Shqipen me vete dhe të shkonte. Po ku? Kjo ku... e mundonte. Pastaj... fjalët e botës! E kush do ta besonte?! Do të quhej femër e përdalur... Ndërsa Shqipja, fëmija e saj, një fëmijë... Dhe vendosi të qëndrojë dhe të heshtë. Të heshtë para të tjerëve, dhe të qajë tinës të tjerëve.

Ja vunë tërkuzën e gjatë në qafë edhe Shqipes. Nënë e bijë, që të dyja me tërkuzën e gjatë në qafë, punonin e ropateshin tërë ditën. Ndonse Shqipja s'i kish mbushur të nëntë vjetët, ajo punonte së bashku me nënën, lodheshin, dërsinin të dyja, ndërsa plaku gulçonte, shante, mallkonte!

Mos vallë edhe jeta e Shqipes kështu do të vazhdonte?

Strukur në qoshe të vatrës filluan të venë e të vinë njerëz. Të bëhen pazarllëqe. Atëhere Shqipja ishte dhjetë vjeçe e zunë të bëheshin pazarllëqe për kokën e saj. Ajo s'dinte gjë, vetëm ndjente se diçka po luhej prapa krahëve për fatin e saj, sepse e ëma qante, sepse e ëma e shtrëngonte më fort në gji, sepse e ëma desh të thoshte edhe ajo fjalën e saj, se s'ish më puna për vetvehte, por për fëmijën, për gjakun, për fatin e Shqipes së saj.

Dhe njëherë, si qau shumë, po si e kuptoi se me të qarë s'i dilej, e puthi dhe e shtërngoi fort në gji Shqipen, dhe, ndonëse e kish të ndaluar zakoni, hapi derën dhe doli në kthinën tjetër, atje ku e kishin vendin burrat.

Babai i Shqipes, posa e pa të shoqen brenda në dhomë, u vrejti, u xhindos. Vëllai i Shqipes çakëriti sytë. Ai burri me mustaqe spicë e me kokën e vogël si të miut, u habit kur e pa brenda atë grua dhe pasi e kuptoi, buzëqeshi duke zbardhur dhëmbët e mprehta si të ujkut. Futti dorën në xhep dhe nxori diçka, nxori para, që t'ja jepte nënës, që t'ja blinte të bijën...

Nëna për një copë herë u step nga ato vështrime të pamëshirshme. Ajo u hutua fare nga buzëqeshja e atij kokëmiu, që i kish vdekur e shoqja para ca kohe e desh të merrte bijën e saj për...

— Jo, jo! Në asnjë mënyrë nuk e jap vajzën time, nuk e shes vajzën time, — bërtiti me zor. Ishte klithma e fundit e nënës, se plaku sipas zakonit, rrëmbeu mashën dhe me tërë fuqinë që kishte qëlloi gruan prapa koke. Pas pak kohe, ca nga dhëmbja, po më shumë nga dëshpërimi, ajo vdiq. Kështu Shqipja mbeti jetime.

Pas kësaj si do të ishte fati i Shqipes?

«Si i nënës tënde?» I dukej asaj sikur i përgjigjej një zë i brendshëm, një zë sa i njohur aq edhe i panjohur. Një zë i dalë nga përzierja e zërave të atit plak, vëllait me nënë tjetër dhe burrit të panjohur. Një përzierje zërash të dalë nga ai vend i zi, nga ai vend i errët, i nxirë nga blaza shekullore.



«Jo! jo. Në asnjë mënyrë jo!» i shpërthente një zë tjetër, por tashmë jo nga bloza shekullore e vatrës, por nga thellësitë e shpirtit të saj.

Për një copë herë e mblodha mëndjen dhe vazhdova të lexoj hartimin: «... Shoku Enver m'i di plagët e mia, sepse ai është ngritur me të fortë kundër këtyre plagëve të fjalimi i 6 shkurtit, i cili është një fjalim i shënuar për jetën time, sepse më mbushi me një besim e më hapi sytë për të ardhmen time, sepse shoku Enver ka thënë në atë fjalim: «T'i djegim me zjarr e t'i këputim kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave...». Dhe vështrova një njollë, një njollë të lotëve të saj...

Shqipja filloi të rritej. Filloi të ndjejë aromën e jetës së re.

Çdo ditë shihte një djalë dhe për çudi të saj, sa herë që e shihte atë, «tëk» do t'ja bënte zemra. Sa herë që ai fliste në fshat, në mbledhjet e rinisë, «tëk» ja bënte zemra. Filloi të mendojë: «Çfarë» Oh, jo. Nuk mund të them, kam turp!.. Por, jo! Pse të kem turp? Unë Petritin e dua. Kjo s'është për t'u fshehur! Ne së bashku do të shkojmë në aksion, e pas aksionit do ta shpallim fejesën».

Dhe me këto mendime ajo doli një ditë nga zyrrat e kooperativës plot gaz e u drejtua për në shtëpinë e saj. Herë-herë duke ecur, e herë herë duke kërcyer, arriti deri te qafa e Dhoksit. Atje qëndroi për një çast duke përkëdhelur me veshtrimin e saj shtëpitë rreth fshatit, grykat, mezhdat, duke ndjerë përkëdhelitë e erës që lëshonte qafa e Bullit, ndërsa gjoksi i hidhej përpjetë nga

gëzimi, kur kujtonte të nesërmen, aksionin, Petritin... Do të shkonte me të në aksion!... Kur befaz dëgjoi disa trokëllima patkojsh kali. U tremb pak. Pastaj u qetësua. Ktheu kokën dhe pa atë. Cilin atë? As ajo nuk e dinte, as ajo nuk ë njihte. Ai ishte një burrë me kokën e vogël si të miut e mustaqe spicë. Ndërsa tutje tre kalorës kishin qëndruar në vend.

Ai kokëmiu e mustaqespica i buzëqeshi vajzës, duke zbardhur majat e mprehta të dhëmbëve.

Edhe kjo e përshëndeti.

— Tpruuuu! — i tha ai kalit, dhe bëri të kërcëjë, si një maçok, po u pengua në yzengji; e desh sa s'theu qafën. Shqipja për një hop u tremb, pastaj ju dhimbs, po kur vuri re, që ai u ngrit menjëherë, si një cjan i penguar në ndonjë shkëmb, e pyeti:

— A u vratë, xhaxho?

Burri bëri sikur nuk e dëgjoi fjalën e fundit «xhaxho»

— Për ku shkoni kështu, — e pyeti përsëri ajo?

Fytyra e atij u mvrejt.

— Tek ti! Kam dëgjue do fjalë të pahijshme për ty...

Shqipja e shikoi me çudi; pastaj u kujtua që ish e fejuar me dikë, të cilin nuk e njihte. Ndjeu diçka të tmerrshme në zemër, ndërsa një lëmsh erdhi e ju formua në grykë.

— Po pastaj? — dhe shuka e lëmshit që i qe mbledhur, filloi t'i shkrihej.

Flokët e burrit kryeneç kërcyen përpjetë. Vetullat ju ngrysën. Rrudhat e qafës ju zgjatën.



— Pastaj?! Pastaj kam ardhë me t'marrë.  
Ti je grueja eme!...

— E pamundur!

— Të kam blemun me pare!

— Jo! kurr! Ti, ti je...

— Ejani, bre burra! — dha shenjën ai dhe u hodh mbi trupin e saj. Desh ta kapte, ta lidhte e të ikte. Por ajo e shtyu me sa fuqi kishte duke bërtitur: — Ndihmë!

Vajza po luftonte me atë. Vajza po luftonte edhe me tre «hajdutët», të cilët ishin trembur aqë shumë në çastin vendimtar nga klithma e vajzës, sa që harruan paratë që kishin marrë nga mustaqspica e në vend që të bënin punë ngatërronin më tepër.

Nga larg filluan të dëgjohen zëra, Vajza po humbiste fuqitë. Ata të tre ja dhanë vrapit. Por ai kokëmiu e mustaqspica, si një hamshor i tërbuar nuk e lëshonte vajzën.

— Të kam blemun me pare! Për ty kam harxhue njëqind e pesëdhjetëmijë lekë! Gjallë a vdekun nuk të le në dorë të huej.

Filloi të gulçojë, sytë filluan t'i erren, veshët t'i buçasin. Pranë, fare pranë dëgjoi të bërtiturat, ndihmat që po i vinin vajzës dhe atëhere u kujtua...

— Jo, jo nuk të le me më shpëtue dhe ja nguli dhëmbët.

Ajo bërtiti fort. Asaj i dhëmbi fort. Ai nuk e lëshonte. Gjaku i vajzës filloi t'ja mbulojë fytyrën.

— Tashti le të të marrin të tjerët — u duk sikur desh të thoshte, por s'arriti, se një dorë

gjigande e përfshiu për leckash dhe e përplasi tutje-tëhu.

Kur ç'të shihje! Në gojën e atij njeriu kafshë kish mbetur veshi i vajzës. Ndërsa fytyra e çiltër dhe e guximshme e saj ishte e mbytur në gjak.

Vazhdoj të lexoj hartimin:

«...Bijtë e Partisë, bijtë e shokut Enver janë ata, që pa marrë parasysh asnjë vështirësi, bile as... (ishte një fjalë e prishur me penë, por unë e deshifrova). Ajo fjalë desh të thosh: «As shëm-tirën time» — dhe vura re një pikë loti. M'u kujtuan çastet kur ai djalosh, Petriti i saj, me t'ja dëgjuar zërin kishte dalë vrik nga kulla e tij, kishte kaptuar shkurre, ferra, e gropa dhe kish arritur atje ku ishin grumbulluar shumë veta...»

— Shqipe! — kishte bërtitur ai.

— Petrit!

— Shqipe, kush të paska ba kështu?

E që të dy qenë përqafuar njëri me tjetrin.

— «... shoku Enver jo vetëm na shpëtoi, por na dha mundësi, që fjala jonë të ngrejë peshë kudo që ta lypë nevoja. Shoku Enver na krijoi mundësi të tilla, që unë femra malësore të ripërtihem përsëri, të filloj jetën time nga e para, të regjistrohem në klasën e pestë të mbrëmjes... Prandaj shoku Enver është një njeri shumë i dashur për mua...».

Përfytyroj tashti Shqipen, kryetaren e kooperativës së bashku me Petritin e saj, sekretarin e rinisë, të palodhur, të guximshëm e të lumtur që të dy.



## NE KISHIM NJË RRUGË...

Jam zooteknik me profesion. Punoj në fshat, në një kooperativë bujqësore, i kredhur gjithë ditën pas kopeve me dele, gjithë ditën duke zgjedhur ushqim për derrat apo gëzhura për shpendët. Rrallë herë dukem në qytet dhe kur vij në qytet ndjej një gëzim që ndofta është shumë i ndryshëm nga gëzimi që kanë disa të tjerë që vetë janë në fshat, kurse mëndjen s'e kanë fare aty... Unë shkoj dyqaneve të qytetit dhe shoh njerëzit tek blejnë mish, flasin për cilësinë e tij, kërkojnë këtë apo atë copë, pastaj marrin atë që u pëlqen, ua mbështjellin në letër dhe nisen të kënaqur për në shtëpi. Unë i vërej me vëmendje këta qytetarë, por ata nuk e shohin nënqeshjen time të gëzuar. Më tutje nënat blejnë qumësht në shishe të bardha, i ngrejne drejt diellit sikur duan të shohin sa i bardhë është qumështi. Po kështu më ndodh kur shkoj te dyqani i vezëve, te magazina e sallameve, te frigoriferët e bulmetit! Njerëzit blejnë ato prodhime për të cilat unë punoj. Kënaqem kur kënaqen qytetarët, gëzohem kur gëzohen ata dhe këto ndjenja të mia që mund të duken cikërima, mua ma mbushin zemrën plot.

Kam lexuar (dhe jo vetëm një herë) ndonjë shkrim letrar ku ndokush na ka hedhur, neve zooteknikëve ndonjë romuz. Por kjo s'ka shumë rëndësi. Le të na shkojë tymi drejt.

Një ditë, tashti vonë, kur qeshë i kredhur në punët e mia, më thirri kryetari i kooperativës:

— Shoku zooteknik, a je gati?

— Si urdhëron, shoku kryetar!

Kishim në plan të merrnim disa deshë race në fermën e Goranxisë. Kuptohet që kjo bëhet për të ngritur më lart racën e deleve, për më shumë qumësht, për më shumë lësh, për më shumë mish. Pra për më shumë ushqim dhe gëzim për të gjithë. Dhe u nisa me kamionin tonë drejt jugut, nëpër gryka malesh t'ashpra, nëpër Kolonjë e nëpër kangjelat e Barmashit, nëpër Borovë e nëpër grykën e Shalësit apo të Gërmenjit, vende që tashmë të gjitha kanë hyrë në historinë e revolucionit tonë. Pra ikë e ikë tatëpjetë dhe sa shkon më poshtë, vendi më i butë, bimësia më e thellë e medoemos mendja ime punon: «Ja ndër këto pllaja me bar të dëndur të lëshoj kopetë e deleve, në ato çaire me ujra shumë të lëshoj lopët, ndër këto livadhe të lëshoj mëzat dhe pelat». Ujrat e Vjosës më mahnitën me kthjelltësinë e tyre, kujtoj Naimin që ka bredhur këtyre anëve, sjell ndërmend vargjet e tij, po përsëri mendja ime ngulmon te puna e përditëshme: «Ja buzë kësaj Vjose, të kem e të lëshoj kopenë për bar të njomë e për ujë të kulluar».

Arritëm në Goranxi. Takime me shokë të shkollës, përqafile e biseda të përmallëshme, pastaj fletë-dalje e fletë-hyrje, urdhër xhirimi dhe firma njëra pas tjetrës. Mora në dorëzim de-



shët e racës, i ngarkuam me shoferin në kamion, mbërthyem disa direktë e dërrasa dhe hajde... Udhë e mbarë dhe mirupafshim.

— Shoku shofer, shkelja sa më fort se gjë e gjallë, po ngeli poshtë e lartë rrugëve, humbet vetitë e saj...

Shoferi s'para merr vesh gjuhën time teknike, por rëndësinë e kupton, dhe ja shkel si e do puna. Ikë e ikë, gjithënjë lart e më lart dhe unë bëj ç'bëj ngrihem më këmbë, nxjerr gjysmën e trupit nga kabina e u hedh një sy deshëve:

«Rrini urtë qenushë, kur të mbërrimë aty afër Maliqit do t'jua ngjesh grazhdin me jonxhë, me bërsi panxhari të ngrohta si bukëvale, bërsi të nxehta, sapo dalë nga kombinati... O burra, shofer!»

Dhe vrapimi ynë do shkonte për bukuri, kur mu në mes të rrugës, papritur dhe pakujtuar... grang... diç u thye nën karrocëri, një gërvinjë e çjerrë. Vështrova nga shoferi, ky u vrejti, frenoi dhe lëshoi një të sharë. Dolëm në rrugë. Ai u fut nënë makinë, u zhgrye disa herë nën të, pastaj doli këtej, pikë e vrer.

— Ç'është?

— U thye ingranazhi i...

— Po tashti?

— S'kemi pjesë këmbimi.

Mbetëm duarkryq në pikë të hallit. Kalon një kamion. E ndalojmë. I qajmë hallin shoferit, na dëgjon, por në fund mbledh buzët dhe betohet:

— Për ideal s'kam. e kisha një ingranazh para dy ditëve, por...

Dhe fillon e tregon se si e kush e ku e përse. Dhe kjo histori vijon edhe me tre shoferë të tjerë. Pastaj rruga pritet. Askush nuk po dëgjohet e as po duket më. Afrohet nata dhe shqetësimi im. «Do shpie në kooperativë dhjetë deshë të uritur, të ngordhur, dhjetë deshë që duhet të hynin me një herë në veprim...» po përse ta zgjat me fjalë për të cilat ju do të vini buzën në gaz në kohën që unë isha pikë e vrer.

Renda në një lëndinë më tutje; pas një mezhde mblodha tufa me bar dhe i shpura te deshët. Pastaj rrëmbeva katrovën e makinës, renda gjer te përroi, e mbusha me ujë, e shpura. Deshët ju sulën por u kthyen prapësht si të fyer. U vinte erë benzinë. Renda e mblodha bar tjetër, e krodha në ujë, dhe ashtu bar e ujë e çova përsëri. S'më nxinte më vendi. Po afrohej nata dhe, si dukeshin punët, do ta kalonim atje prandaj... o burra, për bar e për fletë të njoma. Isha tutje rrugës kur vura re shoferin tim që po më bënte shenja. Ngrita kryet mirë dhe vura vesh: një uturimë motorri po dëgjohej përsëri. Pas paku duk një kamion frigorifer dhe një shpresë e re. Isha duke mbledhur bar kur të dy shoferët po bisedonin. Makina e porsa ardhur ishte e madhe, ne na duhej ingranazhi i një makine më të vogël. Për një çast vura re se ata të dy flisnin për mua; vështronin këtej dhe lëviznin duart drejt meje. Kur u ktheva në rrugë. të dy shoferët ishin futur nën kamionin tonë dhe dëgjoja zërat. «Pa dale! Pa dale! Ku e kam dëgjuar këtë zë? Ku?» Rraha mëndjen një grimë. «Po. Tashti e njohta këtë zë.» Ju mund të thoni: «Ku mbahet mënd një zë që e



ke dëgjuar këtu e pesëmbëdhjetë vjet më parë dhe vetëm një herë?» E drejtë. Ashtu është. Por mos harrojmë: Më ishte ngulur në mëndje sepse ai zë dikur më pat thënë gjithë urrejtje dhe inat: «Ikë tutje, more palaço!»

Pra një njeri që dikur më pat fyer aq rëndë, tashti po më ndihmonte. Si t'i thuash kësaj! Ndofta ai s'më njohu nga larg, ndofta ai po na mbaron punë tashi e pastaj... kur të më njohë mua, do rrëmbejë çekanin e madh dhe do ta bëjë çika çika ingranazhin e kambios...

Pra, pesëmbëdhjetë vjet më parë:

«Isha nxënës, djalë plot shëndet, plot muskuj të fortë dhe të ngjeshur. Këto nuk i them kot: isha mundës dhe mundës jo i zakonshëm. Një mundës që ma lakmonin shoqërinë gjithë shokët dhe shoqet e klasës, sa që ditët e ndeshjeve vinin tufa tufa në palestër dhe më jepnin zemër e më brohoritnin. Atë vit kishim kampionat kombëtar në kryeqytet. Bëra ushtrimet e nevojshme, treneri më jepte udhëzime, më tregonte histori nga të tija. Dhe kur u nisëm, m'u qepën pas të gjithë shokët dhe shoqet e klasës. Për këto të fundit u gëzova më shumë sepse midis tyre... e nejse, ju e kuptoni. Bisedime të zjarra, përgatitje të ethëshme, këshilla, masazhe, stërvitje. Dolëm në tapetin e madh. Më treguan kundërshtarin tim. Më shkuan djersë të ftohta. E pashë mirë e mirë, fërkova zverkun, gurmazin, kruajta kokën. Kundërshtari im ishte gjithë poza e krenari. Dhe kishte të drejtë mbase, ai ishte kampion i vendit dhe as që desh t'ja dijë nga një mundës fare i panjohur dhe pa eksperiencë. Dhe t'jua

them që tashti mos ju shkojë mëndja se e munda me...

Për kundërshtarin tim, si mësova, ishte një ditë vendimtare. Me fitoren e asaj dite ai bëhej mjeshtër sporti e ku ta di unë se çfarë. Por s'kish kohë për të menduar më, se ra gongu dhe më thërritën në tapet.

Dola. Arbitri diç më kontrolloi nënë sqetull, gongu ra edhe një herë, filloi ndeshja. Pa e bërë të gjatë, kundërshtari më kapi dhe më rrëzoi poshtë, njëren shpatull ma nguli në tapet, unë shtërngova muskujt por kalova në urë, sikurse thuhet në gjuhën e mundjes. Kundërshtarit tim në këtë rast ju shënuva gjysëm pike në fitim, kurse unë munda t'i shqitem nga duart. Djersët po më vinin çurkë dhe po matesha ta përfshij kundërshtarin. Kisha një dëshirë të pamatur, ta kap një herë ashtu si duhej, pa e merrte vesh ai... dhe në kohën që desha ta kap unë, ai me një lëvizje mashtrimi dhe... më kapi përsëri. Dhe përsëri unë kalova në urë, dhe përsëri edhe gjysëm pike tjetër në fitim të kundërshtarit. Shokët dhe shoqet e mia thërrisnin e bënë potere, më jepnin zemër dhe më nxitnin, por të them të drejtën vetëm për një çast i dëgjova ato britma. Edhe një lëvizje tjetër mashtrimi desh të më bënë kundërshtari, por unë s'e hëngra më, nuk di sesi ngjau ashtu dhe vij e e përfshij krahë-qafë. Po e përfshiva aqë mirë... Ai u drodh një çast dhe reagoi fort. Unë ja shtërngova kokën dhe zverkun si në mengene, ai desh të kalonte në urë, por unë s'kisha ndërmend të kënaqesha me gjysëm pike. Jo, jo. Unë tashti isha për fitore. Por fare papritur ai më foli ngadalë:



- Mos më merr më qafë!
- Luftë sportive, — ja ktheva unë.
- Ty s'të njeh njeri, mos...

E shtërngova edhe një herë dhe bëra ta ngjesh përtokë, por ai përsëri u mbajt, përsëri m'u lut:

— Mos, e dëgjon? Ajo që thërret është e fejuara ime...

— Këtu është ndeshje sportive — përsërita unë.

Atëhere e vura re që u egërsua dhe u dha krahëve dhe trupit aqë fort, sa edhe mua m'u drodhën gjunjët dhe shtërngova dhëmbët që mos më shpëtonte nga duart. Menjëherë u hodha në kundërsulm dhe e përplasa poshtë dhe ja ngjasha shpatullat përtokë!

Në sallë dhe në galeri plasi një gurgule e fortë, e pasur nga disa thirrje gëzimi dhe hareje. Shpatullat e kampionit ishin përtokë dhe çfryrjet e gjoksit tim sikur më ndihnin që ta ngjishja edhe më fort. Kisha fituar ndeshjen. U gëzova me zemër, por s'mund të buzëqeshja dot. U ndamë dhe u ngritëm më këmbë. Isha aqë i lodhur sa fytyra s'mund të më merrte dot një pamje gëzimi. Sipas rregullit ju afrova kundërshtarit tim dhe i zgjata dorën. Por ai ma shtyti:

— Ikë tutje, palaço!

U ndamë dhe nuk u takuam më. Unë shko-va jashtë shtetit, mbarova studimet, u ktheva hyra në punë me kafshët, me delet, me ushqimin e tyre, me kopetë, gjersa u nisa për Goranxi nga e cila po kthehem me ingranazhin e thyer...»

Por... tashti dëgjoj zëra të gëzuara nën kamion dhe midis dy zërave edhe ai i... Po, pol Ai është me siguri. Dhe të dy shoferët dalin kë-

tej, ngrihen më këmbë, janë të lodhur, të nxirë nga vajrat, por të gëzuar. Por... shih kur të ndodhë e keqja, shih kur të më njohë, shih kur të rrëmbejë çekanin e madh dhe...

— Gati, shoku Sedat! Çdo gjë në rregull!

Dhe më afrohet kundërshtari i dikurshëm, kundërshtari im në mundje. Kanë kaluar kaqë vjet dhe ai punon si shofer. Më vështroi me sytë e tij të kthjellët, të qeshur dhe të përzemërt. Unë bëhem gati ta përqafoj, por ai më ndalon duke më treguar me shenjë se është gjithë zhul e graso. Por unë s'u përmbajta.

— Dale, — më tha, ndërsa unë e shtrëngova në krahë, — dale, unë duhet më parë të të kërkoj të falur, ti ke pasur të drejtë, unë të kam fyer.

— Të shkuara të harruara, po si kështu?

Ai ktheu sytë nga lumi i Vjosës dhe me tregonjësin shënonte rrjedhën e madhe:

— Ujët rrjedh e nuk rri në vend, kështu edhe unë... Të kam parë edhe herë të tjera, po s'kam guxuar të afrohem, ti punon dhe mbush me mish makinën time frigorifer.

— Po tashti pse guxove?

— Tashti është ndryshe, diçka bëra për të larë fajin, për ty...

— Jo, jo, ti bëre shumë për punën tonë të përbashkët, kjo ka rëndësi më shumë.

— Po, ashtu është. Ti pregatit qumësht, mish, vezë; unë ua shpërndaj njerëzve. A nisemi tashti?

— Si të duash.

— Nisemi se po bëhet vonë, dhe çmallemi rrugës, se një rrugë kemi.

Dhe u nisëm.



## DASHURIA PER SHOKUN

### 1.

Ditët e para të aksionit ne punonim së bashku me brigadën, në sektorin e parë. Vendi ku do të kalonte traseja ish shumë i thellë dhe e mbushnim duke marrë dhé në kodrën anësore. Po për këtë qëllim kishim hapur edhe gropa në fushë.

Kishin kaluar katër ditë dhe tashmë ja kishim marrë dorën punës. Ditën e pestë tekniku kërkoi katër vetë për të hapur kanalën. Aty do të vendoseshin tuba për kalimin e ujrave nga njëra anë, në anën tjetër të trasesë. Viktori, Andoni, Bardhi dhe unë shkuam pas teknikut. Secili mori me vete nga një lopatë e kazëm.

«Do të hapim kanalën», mendoja. Më vinte pak keq se po ndaheshim nga brigada. Vetëm për këtë mërzitesha. Sa për punën jo. Ne për këtë kishim ardhur. Si të punonim atje, në faqe të kodrës, si aty në vendin më të thellë të fushës, ku do të rridhnin ujrën, ne të njëjtën gjë bënim: ndërtonim hekurudhën. Por ja që, ndërsa çapitesha pas Bardhit, mendja më rrinte atje, ku

valvitej në erë flamuri i brigadës. «Tamam sot e gjeti dhe ky, thoja me vete për teknikun, kur isha vendosur të çoja aq karroca sa Bujari... Bardhi më mirë të mos qe caktuar në këtë punë. Para se të vinte në aksion, ai ka qenë i sëmurë. Po ai nuk i trëmbet kanalit... Po sikur t'i them komandantit për Bardhin? Jo. Ai do ta kuptojë që dikush ja ka bërë këtë, fshehtas. Do të fyhet.»

Mendueshëm hidhja hapat.

## 2.

Kështu ne nisëm detyrën e re. Kur punoja me brigadën, s'më shkonte mendja kurrë, që do t'u hapja kanal in atyre tubave të mëdhej të cilët zbardhnin tutje fushës, disa të shtrirë e disa me gojë përpjetë. Kurse tani kjo më dukej diçka fare e zakonshme. Çështë e vërteta akoma në fillim na merrte ndonjëherë malli për të shtyrë një karrocë, për të ngjeshur dheun me tokmak, por të ndrronim punë as që donim. Si të thuash, u dashuruam pas kanalit. E quanim: kanali ynë.

Ndodhte shpesh që ne të katër me lopata e çizme kalonim përmes vendit ku punonte brigada. Shokët na thërrisnin: «Ej, kanali! Ç'kemi?» Ne buzëqeshnim. Dhe si padashje më ish mbushur mendja që vetëm ne të katërve na shkonte të na thërrisje me emër aqë të çuditshëm për njerëzit. «Kanali». Unë nuk mund t'i mendoja tani ditët e aksionit pa futur në mes tyre kanal in, kanal in tonë, në barkun e të cilit do të lëviznin ujrat e fushës.



## 3.

Vetëm një gjë nuk shkonte mirë. Si të them. Ngjante ngandonjëherë diçka që s'duhej të ndodhte midis shokësh.

Andoni ish më i forti nga ne. Punonte mirë. Ai gjithnjë mbaronte i pari. Por me të mbaruar punë, ikte.

Pranë tij punonte Bardhi, pastaj unë, kurse në skajin tjetër të kanalit Viktori. Andoni pasi kryente pjesën e vet, fare mirë mund ta ndihmonte paksa Bardhin. Ai e dinte mirë, që para se të vinte në aksion Bardhi kish qenë i sëmurë. Pastaj, fundi-fundit, shok e kishte. Ja kjo s'më pëlqente. Andoni e kish mendjen të mbaronte sa më parë dhe të ikte në kamp. Kur ne të tre ktheheshim, e shihnim gjithnjë në këndin sportiv. Më vinte çudi si s'e kuptonte ai një gjë të tillë. S'ishte qëllimi, që t'i bënte normën Bardhit. Jo, jo. Bardhi punonte. As ish fjala për të më lehtësuar mua me Viktorin, që e ndihmonim. Këtu qëndronte diçka më e madhe se kryerja e normës: dashuria për shokun.

Nja dy-tri herë isha matur t'i flisja Andonit, por se si më vinte. Po sikur të më përgjigjej: «Ke hall të shpëtosh vetë ti». Të them të drejtën e kisha marrë inat. Përpiqesha me të gjitha forcat të mbaroja përpara tij, por s'ja dilja. Dhe kjo vazhdoi gjer atë mbasdite.

## 4.

Përsëri Andoni kish mbaruar përpara meje. Ai tani qëndronte ulur buzë vijës së ujit dhe

lante çizmet. Pastaj u ngrit, hodhi lopatën në sup dhe trupi i tij u zhduk në shtegun që dredhonte për në kamp. Tani shikoja vetëm lopatën. Ajo lëkundej sipas ritmit të ecjes. Nuk e di por ajo lopatë që lëvizte sa andej-këndej në atë qiell të përhimtë, më dukej si të ishte një dorë që më përqeshte... Pastaj edhe ajo zhdukej. Në sfond mbeti kodra e mbuluar me kaçube, në njërën faqe të së cilës punonte brigada jonë.

Unë kërceva jashtë kanalit.

Dielli tani hidhte pjerrtas në fushë rrezet e tij të fundit, të kuqe e të vakta. Buzë lumit plepat shushurin.

Fshiva fytyrën me këmishë dhe i fola Bar-dhit:

— Shtyu pak më tutje.

Ai lëvizi ngadalë çizmet nëpër baltë dhe unë me kujdes zbrita në kanal.

— Po të rrish pa lëvizur, ftohesh, — ju përgjegja pas pak dhe futa lopatën në baltë.

«Ujët, që depërton mes poreve të tokës, na prish punë,» mendoja i kërrusur. Tani dëgjohej vetëm përplasja e llucës, që ne hidhnim jashtë kanalit.

— Viktor! Më jep pak pagurin. — Viktori nguli lopatën dhe mori pagurin e gjelbërt.

— Prite!

«Vetëm ujët na pengon» vazhdoja të mendoja, ndërsa mbyllja kapakun e pagurit. «Filtroni pa pushim. Të ish toka argjilore, s'do të ndodhte kështu. Por atëhere balta do të ngjitej si rrodhe pas lopatës. Sidoqoftë, të bëhet njëherë ky kanal. Është kryesori. Kanalet e tje-



rë të këtij sektori do të hapen më lehtë. I mbledh ky ujrat pastaj, ky.»

Bllaf! Pas kurrizit tim ra diçka në ujë. Ndjeva të më stërpiken shpina, krahët, qafa. Ktheva kryet. Edhe kjo na duhej. Prita që i kishim vënë ujit në hyrje të kanalit, ish çarë, ujët derdhej tani në vendin e punës.

— Hyp shpejt sipër! — më thirri Bardhi.

Unë kërceva nga kanali dhe vrapova atje ku hynte ujët. Viktori rrëmbeu kovat dhe u turr nga Bardhi.

Ta marrë djalli! Ë gjeti dhe ky. Por prapë, mirë që ndodhi tani e jo natën.

Shtyja dheun për të zënë çarjen. Më kot. Rryma ish e fortë. Eh! Të dukej se për ditë me radhë brenda atyre ujrave të palëvizëshme ishte grumbulluar një inat, që tani çfrynte.

— Do të na prishë betonin, — thosha duke vështruar shkarazi skajin tjetër të kanalit.

Vazhdoja të hidhja dhë me lopatë, por e çara trekëndëshe gëlltiste e pangopur. «Ky dhë i qullur nga shiu i mbrëmshëm as që mund ta zërë,» bluaja me vete. Në kanal Bardhi dhe Viktori jepnin e merrnin. Ah, të ishte dhe Andoni. Viktori vetëm s'ja dilte me kovat.

— Të kishim një dërrasë për ta zënë, — tha Bardhi, — Shiko, m'u drejtua, se mos ka ndonjë aty rrotull.

Hodha një vështrim përçark. Ja ku qenka një, mendova, por larg. Sa të shkoj deri atje ujët patjetër do të kapërcejë pritën e vogël që ka bërë Bardhi. Betoni i porsahedhur do të shkojë dëm.

— Hë? — më pyeti Bardhi.

— Ka një por është larg.

— Vrapo!

— Është larg. Ujët do të prishë betonin.

— Vrapo po të them!

Bardhi hodhi një hap përpara, u rrotullua dhe... i vuri shpinën pritës së çarë.

Unë për një çast mbeta i hutuar. Pastaj u lëshova me vrap. Ndër ato hapa që hidhja me çizmet e rënuara nga balta s'mendoja asgjë. Më dukej sikur nga të gjitha anët zëra të papërcaktuara më thërrisnin: «Shpejt, shpejt, shpejt.»

Kur po kthehesha me dërrasën në sup, më doli përpara Viktori. Kështu të dy, duke rrëshqitur, vrapuam drejt kanalit. Dërrasa u vendos.

— Të largohem? — pyeti Bardhi.

— Po, — ju përgjegj Viktori.

— Më jep dorën, — i thashë dhe Bardhi kërcëu jashtë kanalit.

Ndërkohë mbriti tekniku. As që e vumë re se nga erdhi.

— Ç'ka ndodhur? Shpërtheu uji? Po betoni?

— S'ka gjë, s'ka gjë — ju përgjegj qetë Bardhi.

— Mos... Po ti si je bërë kështu? Qull fare.

— Ndrrohem në kamp. Viktor, hidhi dhe ca dhé. Ja tek ajo qoshja e dërrasës.

— Bardhi, hiqi rrobot. Ja tek e ke këmishën time — i fola.

— Ndrrohu, djalë, shpejt, se do të ftohesh, — i tha tekniku! — Pra qenka çarë. Kush punon në këtë vend?

Asnjëri nga ne s'i foli.

— Ai, — vazhdoi tekniku duke u përkulur nga kanali, — që të gërmonte sa më shumë dhe sa më shpejt ka holluar pritën. Kush punon këtu?



Përsëri asnjë s'ju përgjegj.

«Ah Andon, Andon,» mendoja i zemëruar duke shikuar Bardhin.

— Nejse, — foli prapë tekniku. — Herë tjetër duhet më me kujdes. Shiko! Akoma s'ike hequr këto ti?

Bardhi hoqi këmishën dhe kanatjeren të qullura e tërë baltë.

— Na Bardhi, — i thashë duke i zgjatur këmishën time. — Vishe shpejt!

— Mbaje, mbaje. S'kam të ftohtë.

— Merr dhe trikon time. Ja, është tek ai guri, — i foli Viktori, ndërsa me çizme ngjishte dheun.

— Duhet hequr ujët, — tha Bardhi pasi u vesh.

— S'ka gjë, ja preu tekniku. — Për sonte mjaft. Tani djema, nisuni për në kamp.

— Si u qull kështu, — më pyeti kur Bardhi me Viktorin ishin përpara.

— I vuri shpinën pritës.

— Me të vërtetë! Xhanan djalë!

— Ty të qënkan mbushur me ujë çizmet, — dëgjova Viktorin t'i thoshte Bardhit kur ju afrova.

## 5.

Në çadër gjetëm vetëm Andonin; ishte shtrirë dhe pushonte. Asnjëri nga ne s'i foli. Secili mori peshqirin dhe sapunin.

— Ç'u vonuat kaqë sonte? Po ti ç'qenke bërë kështu — ju kthye Andoni Bardhit. — Mos kapë ndonjë lepur?

Buzëqeshi. Por ajo i ngriu në fytyrë. Për një çast ai m'u duk si i ngërdheshur.

Askush s'ju përgjegj. Përsëri për një moment çdo gjë sikur mbeti pezull aty brenda çadrës sonë.

Pas darkës pashë Viktorin që po i fliste Andonit. Kur erdhi pranë meje më foli:

— Ja thashë. Po, po, ja thashë të gjitha. Të paktën ta ketë të qartë.

## 6.

Atë natë ramë më shpejt se herët e tjera. Ishim të lodhur.

Vonë, nëpër gjumë, dëgjova një të kollitur. Pastaj një të dytë. Më doli gjumi. Ç'do të jetë? Përsëri një e kollitur. Hapa sytë. Drita e hënës hynte nëpër të çarën e hollë të derës së çadrës dhe si një rryp i ndritshëm pasqyre shtrihej mbi trupat tanë.

Ai që flinte pranë meje u kollit.

«Oh, Bardhi,» mendova menjëherë. Është ftohur. Duhet t'i hedh batanien time.» Dhe bëra të ngrihem. Por u ndala. Një hije lëvizti nga skaji i kundërt i çadrës. Ajo ju afrua Bardhit dhe... i hodhi një batanie përsipër. Për një çast drita qumështore e hënës ra mbi fytyrën e hijes. Ishte Andoni.



## SHKOLLA E NATËS

1. Unë e dija, im atë ishte i mirë, por ai kishte tmerr nga thashethemet. Ato e mundonin, s'e linin të qetë, e shtynin të kontrollonte oreçast ato që bënte ai vetë dhe ato që bënin njerëzit e shtëpisë së tij... Kështu ishte rritur ai. Edhe nëna. Ajo bile ishte më keq. Po të dëgjoje atë, njeriu ishte skllav i këtyre thashethemeve e kudo që të shkonte, ato s'i ndaheshin, si hije nga pas. Në qytetin tonë të vogël, në jetën tonë krahinore dikur të mbyllur, këto thashetheme zinin vendin e moralit... Tani kanë ndryshuar shumë gjëra e shumë të tjera po ndryshojnë. Koha e bëri të sajën. Mbase sot thashethemet sorollaten ende si shaka të zgjebosura rrugicave të shtrembëra e të errëta, nëpër skuta plakash të mykura, por më kot, se askush nuk çan më kokën për to. Ne, të rinjtë e të rejat, jo se jo, por edhe prindërit tanë. Jeta jonë është spastruar. Së paku kështu duhet të jetë.

Kjo që ju rrëfej, ka të bëjë me jetën time. Nuk është ndonjë heroizëm, përkundrazi kështu si unë do të kishte vepruar cilado vajzë. Bile mjaft të tjera janë treguar shumë më të shkathta, shumë më trimëresha. Sepse paragjykimet, kudo

që të çfaqen, duhen shkukur nga jeta jonë, ashtu si shkullen e flaken tutje dhëmballët e krimburë...

II. Në punishte, makinat e qepjes bëjnë zhurmë të madhe. Kur, në mes të kësaj potereje, shikon të shpërndahen kudo, mbi dysheme, mbi tryeza të punës, mbi stola e karrige, në dollape e mbi dollape copat e stofave ngjyra-ngjyra, mund të mendosh se atje brenda nuk ka kurrfarë rregulli e se çdo gjë është lesheli. Vetëm se nuk është aspak ashtu. Po të rrish një copë herë, bindesh se në tërë këtë «rrëmujë» ka një rregull të rreptë dhe se secila punëtore kryen punën që i përket.

Kështu dhe Maja.

Ajo ka dy vjet që punon këtu. Që kur mbaroi shtatëvjeçaren. Hyri si nxënëse, kurse tani i kanë dhënë gërshtëren. Pret dhe ka një dorë që nuk i lajthitet lehtë. Ajo mat çdo gjë me metrin që e mban varur në qafë e pastaj i fut gërshtëren. Punon dhe nuk ndihet. Bisedon shumë pak me shoqet, ndërmjet të cilave ka nga ato që s'rreshitin gjithë ditën. Po të mos e njohësh mirë, kur e sheh ashtu të heshtur, të mbyllur, mund të duket e ftohtë, disi krenare, gjë që s'është e vërtetë.

Makinat qepëse të shurdhojnë. Ajo e Rukijes ka një zë të trashë që i mbulon të gjitha; kurse ajo e Lavdies kërcet me një zë të hollë e të duket sikur është ndonjë dhelpër e ndjekur që kërkon të shpëtojë; makina e Fatimes është thujse e heshtur; zëri i saj, kur gjithë të tjerat mbeten, spikat me një kërkëllimë të lodhur... Maja i njuh këto zhurma. I dëgjon tek pret këmishtë dhe i duket sikur shoqet e saj në makinë po i thonë diçka... Në të vërtetë diçka i thonë ato



makina, diçka i përsëritin pa pushim, diçka të madhe, të jashtëzakonshme për jetën e saj...

Tefta po bëhet gati të largohet. Është vër-snike me Majën. Dikur kanë qenë në një klasë. Tani, ajo vazhdon shkollën e natës, ndaj del më parë nga puna.

— Si lum ti, Tefta, — i thotë Maja.

Tefta ka një palë sy të zinj që i shkëlqejnë përherë. Është e mbushur në trup dhe e qeshur në fytyrë.

— Përse nuk vjen dhe ti, Maja?

— E si të bëj?

— Ashtu si bëjnë të gjithë njerëzit.

Maja tund kokën. Gërshetat i rrahin supet. — E ke kollaj ti, — ja kthen shoqes, — se ke vëllanë në shtëpi. Kurse unë...

— Ç'hyn në punë vëllai këtu? Femra duhet të ketë besim në forcat e saj dhe respekt për veten, — thotë Tefta. Sytë i shkëlqejnë edhe më shumë nga kënaqësia që i kishte ardhur rasti t'i përdorte këto fjalë të dëgjuaara në një mbledhje. — Të isha unë në vendin tënd, nuk do të matestha kaq shumë...

— Si do ta bëje?

— E thjeshtë fare: do të regjistrohesh në shkollë.

Maja dëgjon fjalët e Teftës. Ajo flet me zjarr, përherë si e frymëzuar e kur nxehet, bëhet më e bukur.

Maja dëgjon dhe hesht.

III. Më duken ndryshe. Krejt ndryshe. I shikoj dhe them me vete «Është e mundur vallë, që prindët e mi të kenë mbetur të tillë, kur çdo gjë

rreth e qark po këmbehet për ditë e më shumë?...  
- Janë vërejtur në fytyrë që të dy. Nëna është bërë  
nevrike. Nuk duron as zhurmën më të vogël.

Motra e madhe ka lindur vajzë. Është vajza  
e tretë e kjo u ngjan atyre si një fatkeqësi e pashem-  
bullt: «Tri vajza!» thotë nëna e mallkon. «Tri plagë».

Babai hesht. Vetëm hesht. Ai i do të vegjëlit,  
djem e vajza qofshin. Ai vetë nuk ka patur veç-  
se vajza. Ne jemi tri motra. Unë jam më e vogla.  
Por ai na ka dashur të gjithave. Kur ishim të  
vogla kishte qejf të na vishte të trijave njëlloj.  
Ne i hidheshim qark. Këndonim e brohoritnim  
dhe e ndjenim vehten të lumtur nga dora e tij që  
na përkëdhelte... Nganjëherë më duket se fat-  
keqësia nisi kur u rrita dhe atëhere, më mbushen  
sytë me lot... Por nuk dua të mendoj kështu.  
Bëj gabim që mendoj kështu. Tefta do të më qu-  
ante fatkeqe, po të dinte se ç'mendime të sëmura  
më vinin në kokë.

Jo, nuk ke të drejtë, nënë! Ti, më ndje, nuk  
di as vetë se ç'thua. Si është e mundur që ti,  
grua vetë, të flasësh kaq rëndë për mbesat e tua,  
për vajzat e tua, për veten tënde?»

IV. Në shtëpi nuk e di asnjë. Këtë fshehtësi  
Maja e Tefta e ruajnë me fanatizëm edhe nga  
shoqet e punës. Kjo i ka lidhur më shumë.

— Sonte do të më pyesë mua, — thotë Maja.

— Mos u tremb.

— Nuk trembem, por, prapë, s'e kemi të  
lehtë. Kisha dy vjet pa vajtur në shkollë.

— Tani u bërë e vjetër. Ke tre muaj që vete  
rregullisht.

— Tre muaj!... Sa shpejt kaluan! Nganjë-



herë kam frikë se mos e marrin vesh në shtëpi. Kur kthehem, e vërej me kujdes fytyrën e nënës dhe të babait. Kur e kuptoj që ende s'dinë gjë, rri e qetë. Megjithatë, kështu nuk kalohet.

— Thuaja atëhere. Ti nuk po bën ndonjë turp.

— Ke të drejtë ti, por nuk u ndruhem edhe aq bërtimave dhe qortimeve se sa rrezikut mos më pengojnë, sepse atëhere merr fund çdo gjë...

Tefta nxehet.

— Si flet kështu? — i thotë. — Ti, sido që të ndodhë, duhet të ngulësh këmbë...

Maja e dëgjon një çast në heshtje. Fjalët e Teftës ja forcojnë zemrën dhe atëhere e merr veten.

— Më jep librat, — i thotë shoqes.

Tefta i jep librat, Maja nuk i çon librat në shtëpi. Ato ja mban shoqja. Kjo, domosdo, ja bën të vështirë përgatitjen, por rrugë tjetër nuk ka.

V. U bënë pesë muaj që vazhdoj në shkollën e natës. Tefta është dy klasë më lart nga unë, por në klasën time kam zënë plot shokë e shoqe të tjera. Muajin e parë m'u duk sikur nuk kisha qenë kurrë në shkollë dhe se çdo gjë që dëgjoja e shikoja e njihja krejt për herë të parë në jetën time. Kur kthehem në shtëpi, vërtet librat i le te Tefta, por me vete marr të rejat që kam mësuar, mësimet e dëgjuara, që po më zbulojnë një horizont të ndritshëm... Nëna nuk e di dhe as që e merr dot me mendje se ç'gjëra të guximshme e të bukura ndryj unë në zemrën time! Bile ajo do të tronditej po ta mirrte vesh...

Megjithatë, shpesh më kapllon trishtimi. Vërtet nuk është një turp ajo që po bëj, përkundrazi

është krejt ndryshe, por vetëm fshehtësia me të cilën detyrohem ta mbroj këtë që bëj, më rëndon në zemër dhe më këput fillin e gëzimit. Të bësh diçka, qoftë dhe të mirë e të ndershme, fshehura-zi nga prindët, më duket shumë e rëndë... Nganjëherë, sidomos pasi kam biseduar me Teftën vendos që t'u flas haptazi e të mbroj me mish e me shpirt të drejtën time. Por pastaj tërhiqem: frika se mos ata gjejnë mënyrën për të më penguar shkollën, më tmerron. Megjithatë, pa ja pohuar njeriu, me veten time unë kam vendosur që, kur të mbaroj provimet e të marr dëftesën, t'i vete me atë në dorë babait e t'ja them të gjitha.

VI. Në klub ajri është i rëndë. Tymi i duhanit qëndron pezull mbi kokën e klientëve. Sot ka shumë lëvizje. Është ditë pazari. Por, sido që të jëtë, tryeza ndanë dritares, është kurdoherë e zënë nga po ata pleq. Vijnë në mëngjez herët, ikin në drekë; kthehen pasdite dhe, kur erret, largohen. Dhe janë të përpiktë, si fëmijët në shkollë.

I ati i Majës është ulur me ta. Shpesh, pasditeve, kur s'ka punë, ai vjen e bën muhabet me pleqtë. Dhe fjalët e tyre janë të çuditëshme. Nganjëherë të duket se mbi atë tryezë, ata sjellin e përcjellin tërë kujtimet e tyre të largëta, renditin njerëz të gjallë e të vdekur dhe nisin t'i përshkruajnë; herë tjetër ringjallin luftëra e beteja, në të cilat kanë marrë vetë pjesë; herë tjetër shtrojnë pjata dhe enë me gjellë e ëmbëlsira të ndryshme e nisin t'i përshkruajnë se si gatuan; pas gjellëve domosdo flasin për dhembjet që kanë në stomak. Jo rrallë, fjala bie edhe për të rinjtë: ankohen që s'u ngjajnë pikë për pikë aty-



re, pleqve dhe që shumë zakone të vjetra i kanë lënë... Megjithatë, xha Ceni nuk lë njeri të flasë keq për të rinjtë; ai ka qenë me ta malit dhe thotë — i kam parë me sytë e mi dragonjtë.

Të atit të Majës i pëlqen të dëgjojë xha Cenin. Kur flet, plakut i skuqen faqet dhe atëhere duket më i ri. Mbahet i veshur pastër. I ka hequr benevrekët dhe ka vënë pantallona e xhakëtë kadijeje, por qeleshen e bardhë s'e ka hequr nga koka.

Biseda rrokulliset mbi syprinën e tryezës midis pleqve, sa më një anë sa në një anë tjetër. Flasin për ulla, pastaj për djemtë që mësojnë në shkollë.

— Djemtë po, — thotë xha Mustafaj, një plak mbi të tetëdhjetat me një palë mustaqe të bardha që i varen si copa rrecka ndën hundën e madhe. — Djemtë, po, pa gocave s'ka ç'u duhet shkolla e tepërt!

Xha Ceni hidhet e kundërshton. Faqet i skuqen. I thotë tjetrit se si goca, si djali, një janë sot. Xha Mustafaj përvesh buzët. Po t'i japë të drejtë xha Ceni, duhet të mohojë tërë jetën e tij, e këtë s'e bën dot. Xha Ceni vazhdon t'u shpjegojë shokëve se si sot, të rinjtë s'bëjnë dot pa shkollën.

— Ja, thotë ai, — edhe Maja e Xhepit shkon në shkollë, megjithëse gjithë ditën lodhet në punë. Apo jo, Xhep?

I ati i Majës zverdhet, i thahet pështyma dhe ka përshtypjen se po i merren mendtë. I duket sikur tymi i duhanit që rri pezull nën tavan, befas, ka hyrë në trutë e tij e nuk e lë të mendohet. Pleqtë kthejnë kokën për ta vërejtur.

— Ashtu është, — përgjigjet duke e përmbajtur veten me mund në sytë e të tjerëve. — Vetë e kam dërguar...

VII. E ndjej veten të dërmuar. Tefta thotë se jam dobësuar, fytyra më është zverdhur. Kam të drejtë. U lodha. Nuk duroj dot më. Nuk di nga t'ja mbaj. Im atë ka dy muaj që s'më flet me gojë. U kthye një mbrëmje dhe ra e fjeti pa vënë kafshatë në gojë. M'u drodh zemra dhe në çast m'u duk sikur një zë më tha se ai dinte gjithshka... Prita me ditë të tëra që ai të më thoshte diçka, të më qortonte, makar të më godiste. Së paku kështu do të kishte një shpjegim ankthi që më shtypte në kraharor... Por ai hesht, më hedh kalimthi një vështrim të ftohtë dhe hesht... Ç'fsheh vallë ajo heshtje e tij e akullt?

Nëna nuk di gjë. Për këtë jam e sigurtë. Edhe asaj i ka rënë në sy fytyra e brengosur dhe heshtja e babait, por ajo i shpjegon të gjitha ndryshe, thotë se ai është sëmurë. Po mua ma ndjen zemra që nuk është ashtu. Sido që të jetë, unë jam e vendosur... Kush mbron një të drejtë, nuk duhet të ketë frikë nga përbuzja e hidhur dhe urrejtja e ftohtë, edhe e njerëzve të tij më të shtrenjtë.

VIII. — Ç'kërkon vallë Tixhja këtu?

— Si ç'kërkon?

— Po e gjej shpesh e më shpesh në shtëpi time! Të kam thënë: atë plakë nuk e shoh dot me sy!...

— Mos u bën tuaf edhe ti...

— Vëru vesh fjalëve që them. Me hallë Ti-



xhen mos më përzej! — dhe i ati i Majës përplas në tryezë grushtin. S'e ka bërë kurrë një gjë të tillë. Në shtëpi i janë bindur të gjithë, pa qenë nevoja që ai të ngrejë zërin, ndaj e shoqja e humbet për një çast. Ai çirret; — E dëgjon ç'të them?

— Që nesër, — ngutet të përgjigjet gruaja, që nesër do t'i them të mos vijë më!

— As këmbët në prak të mos m'i vërë!

Për një copë herë, në dhomë bëhet një heshtje e rëndë. Mbi oxhak, ora e vjetër lëshon tik-takun monoton të saj, të pangjyrë. I ati i Majës ulet në minder. E shoqja vjen rrotull, kot, nëpër dhomë.

— Majën e martoj vetë, — thotë më në fund burri. — S'kam nevojë për... për... — deshi të thosh një fjalë të ndyrë për hallë Tixhen, po me sa duket, nuk e gjeti dot atë që kërkonte ndaj e këputi fjalën në mes.

Gruaja gjuajti rastin.

— Mirë, — tha, — si të duash bëj. Po mos harro se u rrit... dhe me ato që po na shohin sytë...

— Pse, ç'po të shohin sytë ty?

E shoqja vuri duart në ije dhe duke tundur kokën:

— Ato që po na shohin sytë, — ja ktheu, — larg nga ne qofshin! Se të ka në dorë sot fëmija e ta bën turpin mu në prak.

— Hallë Tixhja t'i thotë këto?

— Ç'ke me të ti? — Asaj...

— Asaj — u hodh e ja mori nga goja fjalën i shoqi, — asaj iu pre risku: s'rron dot më duke shitur e duke blerë çupat e botës!

— Po pse, ti ç'ke ndër mend ta bësh Majën? Me moshën që ka çupa s'kënaqet më me përralla... Unë, — jo, dëgjomë gjer në fund, — unë kam kohë që po e vras mendjen...

— E pastaj?

— E pastaj, thua? Ja si qëndron puna...

Dera e jashtëme kërciti.

— Erdhi Maja! — tha burri.

E shoqja e mbylli gojën, por ishte e vendosur që tërë natën të mos bënte gjë tjetër veçse të bindte të shoqin.

IX. Diçka ka ndodhur. Në shtëpi ndjej në ajër valën e një rreziku të afërt që më kanoset. Askush nuk më ka thënë gjë, por kjo heshtje më mundon më shumë. Dje mbasdite, kur u ktheva në dhomën e zjarrit, gjeta hallë Tixhen. Kur hyra unë, e preu fjalën: nëna më hodhi sytë e më pa vëngër; ndërsa hallë Tixhja, me njëmijë lajka e fjalë të mira, siç e ka zakon, më puthi në të dy faqet. Jam e sigurtë që për mua po flisnin. Por sido që të vendosin, tani është shumë vonë të më kthejnë nga rruga që kam nisur. Tani kam mësuar diçka të madhe, që nuk e dija më parë; femra duhet të ketë respekt për veten e saj.

Babaj vazhdon të heshtë. Megjithëse sytë e tij i shoh më të zbutur, unë jam e sigurtë që ai diçka do të bëjë e një ditë do të dalë nga kjo heshtje që më ndrydh zemrën.

Së shpejti fillojmë provimet. Dua të dal me nota sa më të mira. Po t'ja arrij kësaj, do ta ndjej veten të lumtur e do të gëzohem si një fëmijë...



X. Vetëm orën e dytë të mësimit, ajo ndjeu uri. Nuk kishte patur kohë të hidhej një vrap në shtëpi e të hante një kafshatë bukë. Kishin patur mbledhje në punë dhe që nga mbledhja kishte vajtur drejt e në shkollë.

Tek dëgjonte mësuesin e historisë që shpjegonte mendja i largohej vetë nga klasa dhe i endej rrugëve të qytetit deri sa qëndronte në shtëpi. As ajo nuk e kuptonte, por ishte e shqetësuar. Një ditë më parë e ëma i kishte folur e bërtitur saqë vetëm dorë nuk i vuri. E kjo për hiçgjë, për një çikërrimë. Po dukej qartë që nëna ishte e nevikosur. Edhe me babanë ashtu nevirike kishte nisur të sillej. Maja i kish ndjerë pasdite që po haheshin me fjalë, por se për çfarë, nuk e kish hetuar dot. Kur hyri ajo në dhomë, ata e kishin qepur gojën. Pastaj nëna i kish thënë që të dilte jashtë. Duke i lidhur nervozizmin e nënës një natë më parë, me zënkën midis nënës e babait, ajo po bindej se shkaku i tërë kësaj grindjeje duhej të ishte ajo. Po përse vallë? Për punë të shkollës? Apo në këtë mes duhet të hynte edhe hallë Tixhja?

Mësuesi vazhdonte të shpjegonte.

Maja e hoqi mendjen nga shtëpia. Vendosi ta shpjegojë shqetësimin e saj me urinë që e kishte marrë. Por, të largohej orën tjetër, nuk donte se kishte algjebër.

Kur ra zilja për të hyrë ora e tretë e mësimit, djali i shërbyeses erdhi e trokiti në derën e klasës dhe tha se dikush kërkonte të takohej me Majën.

Në çast, faqet e saj u bënë të kuqe si flaka e zjarrit. Mendimi i parë që i erdhi në mendje ish se pa-

randjenja e saj e keqe po vërtetohej.

Kur mbylli derën e klasës dhe hodhi sytë në fund të koridorit, gjunjët ju prenë dhe ngriu në vend: i ati, në këmbë, i kishte kthyer shpinën e po bisedonte me shërbyesen.

Një hop Maja qëndroi mbështetur pas shtalkës së derës. Mendoj një herë të kthehej përsëri në klasë, por në çast e flaku tutje këtë mendim dhe i erdhi turp nga vetja. Ngriti kokën dhe u nis. Mendohej t'i jepte hapit një ritëm të sigurtë e të mos tradhëtonte në sy të të jatit asnjë ndjenjë të zemrës së saj.

Kur ndjeu hapat e vajzës, i ati ktheu kokën. Maja vuri re se ai diç mbante në dorë të mbështjellur me gazetë. Ja nguli sytë në fytyrë por gjysëmerrësira e koridorit nuk të linte të kuptoje asgjë.

— Eja, Maja, — foli i ati.

Maja shkriu e tëra. Zëri i babait që i butë, i ëmbël dhe vajzës ju duk sikur kishte vite pa e dëgjuar atë zë.

— Ke ikur pa ngrënë, — tha babai. — Merre, — dhe i dha ushqimin e mbledhur në gazetë.

— Baba... — tha Maja dhe e ndjeu se sytë iu mbushën.

Por i ati e zuri për krahu dhe nuk e la të vazhdonte.

— E di, — i tha... — E di prej kohësh...

Ndenjën në një stol. Maja nisi të hajë. Duart i dridheshin ende.

— Po nëna? — pyeti.

i Ati e vështroi dhe nuk u përgjegj.

— Po nëna, baba?

— Bisedojmë në shtëpi.



Maja hante dhe heshte. Heshte dhe mendohej. pranë saj, i ati e vërente. Heshte dhe ai Heshte dhe mendohej. Në fillim deshi ta pyeste përse nuk ja kishte treguar edhe atij, të atit, që në fillim, por pastaj rudhi ballin e nisi të dënojë veten. E dënonte veten që e kishte tmeruar aq shumë të bijën, i tërbuar nga llahtara e thashethemeve, sa që ajo megjithëse e madhe, e, si thoshte e shoqja, gati për nuse, të mos, të mos guxonte t'i hapej të atit e së ëmës dhe të kryente me frikë edhe një punë për të cilën duhej lavdëruar.

Maja hante. Gërshetat e zeza në shpinë i shndritnin. I ati e shikonte në heshtje, e dukej sikur i kërkonte ndjesë.

## ZËRA NË MJEGULL

Vullnetarëve, në Gjergjevicë.

Katër vetë, të heshtur e të shqetësuar, dolën nga mbledhja e kryesisë; në mugun e turbullt të një mbrëmjeje vjeshte. Heshtjen e natës e brejtën kërkëllimat e ngjirura të kycit. Mbrëmja ishte e ftohtë, drithëronjëse.

— Ama, punë e bitisur kjo, për ideal! Tri orë mbështjellje për një... pëshpëriti sikur mbllaciste bukë njëri nga të katër.

— Pusho! — tha një zë i ashpër. — Hallet e kryesisë s'janë muhabete rrugësh. — Hija e tij, me strehët e gjata të kasketës që dukeshin si një eshtër e dalë e ballit, ishte më e madhja.

Ata heshtën. Dhe heshtja pille mendime dhe kuvendime me vetëveten.

«U mbyllën në kryesi tymi, era e djersës dhe tri orë biseda pa bukë», mendoi Markua.

«Ama punë e bitisur, për ideal! Tri orë mbështjellje për një copë çoban!» e mbaroi me vete kuvendimin e ndërprerë aq vrazhdë Rushiti.

«Pse më vështronte Markua me ngulm, kur kryetari thoshte se nuk del njëri nga fshati ynë për t'u bërë bari?» — mendoi Rasimi.



«Që çobani është vulëhumbur e dimë, po nuk më thoni me nder jush, kush ka vithe të dalë nga fshati ynë e të marrë tufën? Qëkur s'mbahet mend, zanati ynë ka qenë ai i muratorit shëtitës», mendoj kryetari.

Shtëpitë e murrme i mbështolli me gunën e zezë nata e vjeshtës. Kjo ishte një natë e ftohtë, si gjithë netët e tjera të vjeshtës së vonë. Markos i dukej më tepër e trishme dhe e plogët se sa e ftohtë. Era turfullonte si kalë i lodhur nëpër dru-rët e arrave. Rrëmbente e përdridhte në vorbujt e saj gjethet e fundit. Në bunacë, gjethet e verdha me përdredhjet e tyre të çpenguara nëpër erë i ngjanin si lakuriqë nate të ngathët. Fshati kish shumë drurë të tillë të vjetër, dhe era përdridhte me vrundull shumë gjethe të tilla të mërzitshme... Hapi i rëndë i Markos ishte i vetmi tingull zëmadh i natës. Hapat e tjera; hapa opin-gash, kishin një kumbim të dobët përpara zhurmës së proqeve të këpucëve prej alpinisti të Mar-kos.

Era e fshikullonte në fytyrë me gjethe të kalbura të ftohta, dhe ai i krahasonte përsëri gjethet me lakuriqët e natës. Bunaca i sillte angushti, heshtja i dukej e vrërët dhe e rëndë si hija nën drurët e arrave. Njëlloj të rënda, monotone, si një brerimë e njëzëshme shiu mbi llamarinë ishin dhe mendimet që e shqetësonin.

«Duhet pranuar se sonthe, forca bindëse e fjalës tënde qe zero. Në fakt, po të ishte kjo ve-tëm fjala jote, përse të breheshe kështu? Njëshi është hiç... siç thoshte Majakovski. Po ti brehesh, se kjo qe fjala e dymbëdhjetë vullnetarëve, e

klasës punëtore. Kurse shokëve të kryesisë ju duk diçka e vogël, si një nga ato vogëlsirat e përditshme me të cilat është mbushur plot jeta e një fshati thellë në make, që posa është kolektivizuar».

Por ai që punëtor dhe pat ardhur këtu me shoqe e me shokë të tjerë që të punonte dy vjet. E zgjodhën në kryesi të kooperativës. Eh! sa mendime të tilla i lindnin këtu çdo ditë. Dhe, në fillim, gjithshka dukej në përmasa të vogla, e zakonshme, e falshme. Ja, le të mos shkojmë larg, Dje djali i Rushitit nuk doli në punë. Penda mbe-ti pa pendar. Rushiti tha se e kish zënë përdhesi në këmbë, po në mbrëmje e panë që kthehej tinëz nga mali me mushkën ngarkuar me dru. Kurse Rushiti, anëtar kryesie, bënte be e rrufe: «Për ideal, ju them, unë e dija të sëmurë! Më nxiu faqen, faqeziu! Për ideal, ju them!»...

Hynë nën hijet e drurëve, dhe bunaca u bë më e dëndur. Dritaret e vogla si sy të verdhë ndruheshin të shihnin në rrugicat e ngushta.

«Pas një viti, këto dritare si kumashë pulash do t'i bëjmë më të mëdha. Do t'i hapin edhe më sytë e tyre, do të ndriçojnë më fort natën» fliste me vete Markua.

«Ç'na polli me këto mbështjellje përnatë! — mendoj Rushiti. — Tani, të shkoj në shtëpi, të thekem një herë, të pjek nja dhjetë patate në hi, pa copë le të bëhet.»

«Në mbledhjen e parë do të them: Ore... e dini që ja nximë faqen vetes, apo jo? Ç'domethënë kjo, të mbeten qetë tona në dorë të një çobani mangut nga mendja? Kush ka vithe të dalë



nga ju e të marrë tufën?, pa mund t'i shkruajmë edhe pesëdhjetë ditë në muaj» mendoi kryetari.

«Ç'mund të përshpërisin për mua, sikur të merrja tufën e qeve? Ama Rasimi! S'kemi parë e dëgjuar gjer më sot që një anëtar kryesie të jetë edhe çoban!»

— Natën e mirë! Unë po kthehem në shtëpi.  
— tha anëtari i kryesisë, Rushiti.

— Ne vendosëm që të zbresim në stallat. Në kryesi je i ngarkuar për blektorinë. Do t'i mbash vithet drejt, apo jo? — tha kryetari.

— Ç'të bëjmë në stallat? Se mos na mori malli për Kukën!

— Gjersa s'kemi njeri nga fshati të marrë tufën, shyqyr që u ndodh edhe Kukja, — u përgjegj kryetari.

— Kuke ziu do të na i ngordhë qetë! I kullot nëpër bokërina, dhe natë për natë i mbetet nga një ka në mal, — shtoi Rasimi.

— S'ka faj i gjori! Kukja nuk sheh natën, se ka sëmundjen e pulave, — pëshpëriti Rushiti.

— E?

— Është bardho! Ka sëmundjen e pulave, — përsëriti Rushiti, dhe kush e di se pse ja dha një të qeshure sikur rrëkëlleheshin arra.

— Pse qesh si budalla? — tha Rasimi. — Kemi gjetur një gjysmë mendje që llufit dy çanakë fasule në vaktit, dhe presim të na venë mbarë qetë.

— Uleni zërin! Punët e kryesisë nuk janë muhabetë rrugësh, — nguli këmbë kryetari dhe mori një shteg me gurë të bardhë që ta shpinte në stallat.

Hynë në oborrin tërë plehë të stallës. Në de-

rë, nën dritën e paktë të një feneri dukej Kukja dhe xha Xibua, stalljeri plak. Dëgjohej zëri i ngjirur i plakut.

— Nuk i pikase se ku të mbetën, bre Kuke?

— Nuk i pikasa, or arrakatët, jo!

— S'je për bari ti, jo! Po për grazhd! Të të lidhim e të të japim bar!

— Barin haje vetë!

— Ptu, buf' i pulave! — u sha plaku.

Kryetari u afrua i pari dhe bërtiti me zërin e tij të vrazhdë:

— Pse grindeni, o vulëhumburit e derrit?

— Grindje është kjo a? — tha Kukja.

— Kanë mbetur në mal dy mëzetët që morëm nga shteti — tha plaku.

— Sikur është hera e parë! — desh të bëjë shaka Rushiti. — Nesër, si të dendet me një çanak fasule që me natë, i gjen Kukja përsëri!

— Kohë për shaka është kjo? — shfreu kryetari.

— Nesër... — tha plaku. — Mirëpo në mal tani ka rënë mjegulla. Dhe egërsira mjegullën pret.

Kryetari u kthye dhe u nis me hapa të gjata drejt fshatit.



Ndërkohë, u shuan dritat e fundit. Rruginat u kredhën në errësirë. Një mjegull e trashë, e palëvizshme, si një agushtë që të merr frymën, zbriti nga mali. Drurët u fundosën në të si në një hon. Vetëm një zhurmë nate e çuditshme, e pa-



kapshme, dridhej si një piskamë e mbytur nëpër natë. Herë-herë mbi të vërvitej lehja e qenve të lëshuar nëpër oborre, që skërmitnin dhëmbët pas gjerdheve.

— Or shoku Marko! Nuk të ngrihet njeri nga gjumi tani për të kërkuar mëzetët në mal! Për ideal, s'i ka lënë mendja njerëzit! Sikur është e para herë që mbeten bagëti në mal, — përsëriti anëtar i kryesisë, Rushiti.

— Sikur është e para herë që gjejmë bagëti të çara nga egërsira? — përqeshi Rasimi.

— E... e... sikur thashë!.. Edhe egërsirat kanë kismetin e tyre, se, po të mos kenë këtë kismet, mund t'i vërsulen fshatit pastaj!..

— Pusho more! — ja preu vrazhdë kryetari.  
— Nuk i le këto filozofira ti? Bëji një zë Shyqos, të vijë me ne.

— Unë, a? Jo, or shoku kryetar! S'më kanë rrjedhur akoma mua që të zgjoj njerëzit për dy mëzetë! Njëherë e një kohë...

— Hë?

— Asgjë, asgjë, — u përtyp Rushiti e kafshoi gjuhën. Dësh të tregojë se si, ca vjet të shkuara, i pat mbetur atij një viç në mal, mirëpo sikush shihte punën e vet, njeri nuk e ndihmoi ta kërkonin. Viçin e patën kismet ujqit. «Mirëpo kjo nuk bën të tregohet», i dha karar ai.

— O Shyqo! — thirri kryetari.

Heshtje. Masivi i murrme i shtëpisë dilte në mjegull si një grumbull pa formë errësire. S'pëtititi asgjë, veç asaj piskame të gjatë, të njëzëshme e të çuditshme që s'dihej se nga vinte. Pastaj, sikur u zgjua nga gjumi, u sul nga stela një kone dhe filloi të ngrindet e të angullijë.

«— Ama ç'qen! — tha Rushiti. — Me një kone të tillë mund të flesh rehat. Nuk të gjen gjë...»

«S'të gjen gjë!.. — vazhdoi mendimin e tij Markua. — Prona e vogël ka mbjellë në shpirtin e këtyre njerëzve pasigurinë e natës, frikën e vjedhjeve. Sa thellë në lashtësi i ka rrënjët vallë një pasiguri e tillë?»

Më në fund, pas shumë thirrjesh, ai që quhej Shyqo doli në dritare me një fener në dorë.

— Ç'ka ngjarë, more? — pyeti me frikë.

— Kanë mbetur dy mëzetë në mal dhe do të shkojmë t'i kërkojmë! Vishu — tha kryetari.

— A jeni në vete ju, apo jo? Natën do të marrim udhën e malit, që të biem në ndonjë greminë, a?

— Po të kishin mbetur të tutë, do t'i kërkoje?

— Hëm... Sikur është aty llafi. Pastaj ju e dini që mua më nget përdhesi.

— Rri aty e ngroh vezë, — ju shkreh kryetari.

— Na e jep të paktën fenerin — tha Rasimi.

— Nuk ja duam as fenerin!

«Është njeri i vrazhdë ky kryetari, — mendoj Markua. Por i lidhur me kooperativën si mishi me thuan».

— U binde tani!? — qeshi Rushiti.

— Jo! Nuk janë të gjithë Shyqo e Rushitër! — tha kryetari.

— Po mua ç'më përziën? A s'po vij me ju unë?

— S'ka gjë, se dikush nuk do të vijë — tha Markua: — Do të vijnë të tjerët. Do të vijnë edhe ne të gjithë, vullnetarët.

Markua u kthye në shtëpinë ku flinin shokët. Ngjiti në terr shkallët e vjetra që kërcisnin. Që



poshtë vinte ende era e plehut dhe e urinës, megjithëse ata e kishin pastruar haurin. Ndezi një shkrepse, po drita s'depërtoi dot deri në shtretër. Lëvizi më tym dhe goditi në bërryl kitarën e Pandit, që ish varur në mur. Një tingull i ëmbël, i thellë mbushi heshtjen e natës. Dikush lëvizi..

— Shokë!... Miço! Tomorr! — pëshpëriti.

Një zë i përgjumur diç murr uriti.

— Ngrihuni — tha Markua.

Trupat e përgjumur lëvizën nëpër shtretët. Markua ndezi prapë një shkrepse dhe kërkoi llampën.

— Ç'ka ndodhur?

— Kanë mbetur bagëti në mal. Do të shkojmë t'i kërkojmë.

— Mirë.

— A duhet të marrim gjë me vete?

— Shishet me vajguri. Shkrepse. Duhet të ndezim zjarre.

— Mirë.

— Tomi! Merr edhe kamën! — qeshi dikush. Sonte kemi punë me ujtit!

— Unë po shkoj të thërres vajzat!

— Por... Është një natë e tillë që...

— Kujton se janë më të dobëta se ne?

— Shko i zgjo nga gjumi!

— Përndryshe, të gjesh vrimë ku të futesh!

\* \* \*

Një dritë e dobët rrëshqiste mbi xhupat bojë mjalti të vullnetarëve dhe mbi xhaketat prej shajaku të zi të fshatarëve, që i kishte ngritur nga

gjumi zëri i vrazhdë i kryetarit. Dhe kjo radhë, si një gjymtyrë e malit në dritën e zbetë, ngjitej shpatit. Mbi të dyndeshin vandakë mjegulle, dhe hidhësia e lagështia e tyre depërtonte deri në palcë. Pesë vajzat, mbështjellë me xhupat me jaka të ngritura pas veshëve, vinin pas kryetarit që hiqte udhën. Aradha ishte e heshtur. Vetëm rralle herë, një zë i vrazhdë pyeste bariun:

— Këtu?

— S'di!. Kot më muarët mua! Unë nuk shoh natën!

— Hm... hungronte zëri!

Ahere, Kukja zbythej nga kreu i aradhës kërkonte aty në mes të saj Rasimin.

— Rasim-o! Mos ke ndonjë kore bukë?

— Hy i babëzitur!

Kurse kryetari mendonte ende për vullnetarët. Çdo ditë, hetonte tipare të reja në fytyrën e tyre të përbashkët.

«Ç'njerëz! ç'vajza trimëresha! Me një zë, u ngritën në mesnatë si në një alarm dhe u nisën nëpër mjegull!

«Ç'më gjeti belaja! mendonte anëtari i kryesisë, Rushiti. Tani do të bëja gjumin e parë. Po këta, ç'shpiert kanë vallë, që i shtyn të braktisin shtretët e ngrohtë dhe gjumin?

«Ata do të ikin pas një viti! — mendonte Rasimi. — Të ishte tjetër kush nuk do ta çante kryet fort për qetë tona. Se mos do ta lidhin jetën e tyre me to? Por ata janë punëtorë, dhe zërin e punës e dëgjojnë edhe në mes të natës. Po sikur unë, vetë të marr...»

«Mjegull, mjegulla e çdo nate! — mendonte Markua. — ndofta, një mjegull e tillë bie herë-



herë edhe në mendjen e këtyre! Mjegulla e pronës!... Po kjo aradha jonë, fshatare e vullnetare që ngjitet me fenera drejt malit, si një pishtar dritash, duhet të depërtojë me forcën e saj deri në thellësitë e mykura ku strehohet mjegulla.»

«Sikur të guxonin të mos na thërisnin! — mendonte një vajzë e imtë që ecte pas shpinës së madhe të kryetarit! — Uh, si do t'ua bëja samarin copë në mbledhje!»

Kryetari ktheu kryet dhe vështroi me ngulm fytyrën e vogël të mbështjellë me një kurorë flokësh të zeza, që nuk i ndahej hapit të tij të madh. Nën dritën e fenerit, ajo ju duk e verdhë, e lodhur. Vetëm sytë s'kishin asnjë shenjë gjumi, dhe bebëzat e zeza ndritnin si thëngjij.

— U lodhe? — përshpëriti njeriu i vrazhdë me një zë të ulët, të rëndë si plumb, po të malluar, të dhëmbshur.

— Jo! — u përgjegj vajza. — Pse mendon kështu? Ne e bëjmë çdo ditë këtë rrugë.

— Por, tani është një natë me mjegull...

— Rruga është po ajo! Ditë ose natë!

Qëndruan. Fenerët u mblodhën si një tufë e verdhë.

— Tani, do të shpërndahe mi nga dy tre vetë në çdo majë. Merrni me vete vajguri, që të ndizen zjarret. Egërsira kështu, do të hutohet. Kërkoni dhe thërrisni njëri-tjetrin.

Kështu, ndër lëndinat e njomura nga mjegulla, u ndezën zjarret. Në mes të avujve të bardhë që endeshin posht' e lart si një kope pa bari, flakët e zjarreve, të turbullta e të rrethuara me kurora të zbeta, lëpinin me gjuhët e tyre mjegullën e natës. Dhe nisën të çajnë terrin e të mbysin atë

piskamë të njëzëshme e të çuditshme të natës, zëra të tjerë!

— E. e...e...e...j!

— He... he... he...! ej!

Toka e ngrirë. Avujt njomin këmishët dhe flokët e shpupurisura. Zëra të hollë, të mprehtë, të vrazhdë, përgjigjeshin breg më breg. Ky kor zërash vazhdoi vonë. Zjarret shuheshin dhe mbinin përsëri, në një kodër tjetër, pastaj platitëshin e mbinin prapë. Dhe zërat mbushnin me jehonën e tyre zbrazësinë e natës, të honeve e të pyllit të rrallë të aheve të vjetër.

Kështu, derisa një zë i hollë thirri me një tingëllim tjetër!

— E...e...e... ej! I gjetëm... i gjetëm?

Kryetari e njohu menjëherë zërin e vullnetares së imtë me bebëza të shqetësuara, që quhej Aishe.

\* \* \*

Agullimi i një dite tjetër të turbull vjeshte i gjeti afër fshatit. Mjegulla kish mbetur si ishull i bardhë në shtratin e greminave, mbi ujrat e përrrenjve. Mëzetët me trupin njomur nga avujt pëllitën dhe shtryqën trupin e mardhur. Pika uji spërkatën dheun.

«Ç'njerëz!» mendonte kryetari.

— Ndofta, pikërisht kjo do të thotë «klasa punëtore, që i jep tonin jetës së vendit». Kjo vajzë e brishtë sonte i dha tonin një fshati të tërë.

«Hm... — pëshpëriste, anëtari i kryesisë, Rushiti. — Tjetrit s'duhet t'ja hash hakën! Nga sebepe i vullnetarëve shpëtuan mëzetët sonte...».



«A i thua vetes i ri? — mendoj Rasimi. — Ahere, dil vullnetar dhe merr tufën e qeve». Dhe ju afrua Markos.

— Marko! Po e marr unë përsipër punën si bari.

Markua buzëqeshi.

«Kjo është përmbysje! — tha me vete, duke menduar Rasimin. — Përmbysjet këtu i ngjajnë shkëputjes së gurëve prej masiveve shkëmbore. Këputet e thërmohet një koncept i vjetër, i mykur, e në vend të tij, si një bilashnjok që lëshon lisi i prerë në pranverë, mbin mendimi i ri revolucionar. Dhe, ndofta, ndodhitë si kjo e natës së shkuar i ngjajnë një gurgdhendësi të madh e të padukshëm. Ato gdhendin tiparet e reja në fytyrën e ashpër e të lashtë të malësisë!...»

## TEFTA

— Tregim —

Mësuesja e re ishte një vajzë shtatmesatare, e shëndetshme, me fytyrë të mbushur e faqe të kuqe si molla dhe me sy të zes si ullinj të ndritshëm, sikur i kishte lyer me vaj, që lëviznin me gjallëri e shkathtësi të madhe. Kishte veshur një fund të kuq dhe një bluzë basme, e cila ja tregonte qartë format e trupit dhe i shkonte për bukuri fytyrës së saj plot shëndet. Flokët e zeza me forma natyrale, i kishte prerë shkurt, me sa duket, që të mos e besdisnin, sepse nuk kishte treguar ndonjë kujdes kushedi që për ta.

Duke e shikuar që nga flokët e deri tek majat e këmbëve, Leni, një mësuese, që mbahej si femër me shije të hollë për veshje e për të çmuar të bukurën, mbledhi buzët kur sytë e saj u ndalën tek këpucët e përdorura e tërë pluhur të mësueses së porsaardhur.

Tefta, mësuesja e re, doli të shihte klasat.

— E po, si ju duket kjo çupkë? E bukur është, s'ke ç'i thua tha një mësues duke ju drejtuar me qëllim Lenit, e cila s'kishte qejf t'i flisje për bukurinë e një femre tjetër.

— Ju djemtë nuk dini t'i çmoni fare femrat



— tha ajo. Me vështrimin e parë, e jepni mendimin, pa u thelluar. S'themi se s'është e bukur, por a nuk të duket bukuria e saj si bukuri prej kukulle? S'ka hiç finesë, nuk është tërheqëse si femër. Apo për të veshur? Ka mbathur një palë këpucë si opinga. Në këtë vapë! Po ç'them? Ajo është tamam fshatare. Fshataret, kur vishen, do të lënë patjetër ndonjë gjë mangut.

Pas pak, kur drejtori hyri në dhomën e mësuesve dhe e pyetën ç'përshtypje kishte për mësuesen e re, ai rrudhi vetullat dhe tha rëndë-rëndë.

«Ata të seksionit nga njëherë nuk dinë ç'bëjnë. Ne kërkua një mësuese matematike, ata dërgojnë një çupkë çamaroke. E ç'të bëj unë me të. Ç'matematikë pret të të japë ajo?»

Edhe sikur t'i kishte dëgjuar Tefta këto vërejtje jo të mira, nuk do t'i kishte bërë shumë përshtypje. Ajo nuk bëhej aq merak se ç'mendonin të tjerët për të. Por, ama, nuk do t'ua kursente përgjigjen, se edhe për këtë s'i bëhej vonë. Dhe një fillim i tillë nuk do të qe aspak i mirë.

Gjersa filluan mësimet, ajo i mërziti të gjithë duke i pyetur si bëhej plani tremujor apo ai ditor e për çdo vogëlsirë që i delte aty për aty. Kur e kishte pyetur në fillim drejtorin, ky e kishte vështruar shtrembër, sikur t'i thoshte: «Ama, as këtë s'e ditke? Ç'pranove të vijë këtu, atëherë?» Ndërsa Leni, edhe ajo duke e shikuar me mospërfillje, i kishte thënë: «Pse, s'kini mësuar në shkollë ju? Aq kollaj u mësua si bëhet plani me një të pyetur. Se mos është ndonjë «5 + 5 bëjnë 10.»

Tefta me atë instiktin e natyrshëm që kanë njerëzit për ta parandjerë të mirën e të keqen, edhe kur ato s'kanë marrë forma të konkretizuar, u druhej të dyve qysh në rastin e parë që pati të bëjë me ta. Nga të tjerët s'desh t'ia dinte fare e sillej, shpenguar. Jo veç që pyeste si ta bënte këtë apo atë gjë, por, edhe pasi e bënte, ua jepte t'ia shihnin në e kishte bërë mirë a jo dhe i detyronte t'ia thoshnin mendimin e tyre.

Të shihje si bisedonte me ta, do të thoshje me siguri se i kishte njohur prej kohësh. Nga kjo sjellje Leni, kur s'ishte Tefta, thosh me mburrje.

— S'ju thashë unë që është tamam fshatare? «Nga je ti? Po ti? E ke mbaruar Institutin? Je martuar?» Të pyet tjetra si pa gjë të keq. U, pika edukatës që ka marrë!

Filluan mësimet. Teftës nuk i mbetej kohë, kur thonë, as të pinte ujë. Bënte mësim, korigjonte detyrat, shkruante e lexonte, pyeste për çdo gjë e kurdoherë pa vënë re nëse ai që pyeste ja kishte ngenë apo jo. Nuk i vinte radha të bisedonte për gjëra të tjera e të rrinte e qetë, po kurrë s'mërzitej. Ora e mësimit s'i arrinte dhe shpesh mbetej duke shpjeguar edhe në minutat e pushimit. Kur ishte e lirë, vinte e dëgjonte në orën e mësimit të ndonjë mësuesi tjetër.

Leni i shihte me qesëndi këto veprime të «fshatares», ndërsa drejtori mezi e përmbante veten. Në fillim i kishte thënë me seriozitet se si duhej të sillej në mësim e kudo për të mos prishur autoritetin e kolektivit të mësuesve që, siç tha ai, në atë shkollë qe i madh. Por tani vinte re me nerva të tendosura se ajo s'ua varte fare



mësimeve të tij. «More nga na doli kjo farë e tillë? Me qiri ta kishin kërkuar e s'do ta gjenin dot, drejtin!» — thoshte me vete.

Më në fund, s'iu durua dot më. E thirri në drejtori.

Kur hyri ajo, drejtori ngriti kokën nga ca evidenca që kishte përpara, mblodhi vetullat si për të shikuar më mirë, i bëri shenjë mësueses të ulej, drejtoi shtatin e tha me seriozitet sikur të ishte ushtarak e t'i diktonte një urdhër lufte sekretares së tij:

— Ju porosita në fillim si të punoni e të silleni, por ju s'i kini vënë në vesh fjalët e mia. Ju nuk veproni korrekt me rregullat e shkollës. Unë s'mund të shoh indeferent se si ju po na i prishni këto rregulla që i kemi vendosur me përpjekje të mëdha.

Mësuesja mblodhi supet. Drejtorit ju duk tamam naive me këtë gjest, i kërceu damari që kishte në anë të tëmthave dhe me zor e përmbajti veten.

— Po tregoheni sikur s'merrni vesh? — vijoi — Aq më keq, atëherë! Po ju them për të parën e për të fundit herë, në mësim te të tjerë të mos hyni pa urdhërin tim! Kur bie zilja, të delni nga mësimi, se nxënësit kanë nevojë për pushim. Dhe së fundi, kini parasysh t'i vini rëndësi autoritetit tuaj. Jeni mësuese në tetëvjeçare dhe silleni me nxënësit sikur të ishit edhe ju vetë nxënëse. Kur hyn njeriu në klasë, pasi kini dalë ju, i duhen disa minuta vetëm për të vendosur disiplinën e nevojshme për mësim. Shkoni tani dhe i vini gishtin kokës. E përsëris: jeni mësuese e shkollës tetëvjeçare.

Mësuesja u mat diç të thoshte, por drejtori ja preu fjalën:

— Këtu nuk ju thirra për të diskutuar!

Mësuesja doli pa marrë vesh asgjë të qartë. Përse e kishte thirrur drejtori? Ç'i kishte thënë? Ç'kishte mësuar ajo nga fjalët e tij plot autoritet? Ç'ishin këto rregulla kaq të rrepta për të cilat ajo s'kishte dëgjuar kurrë?

Atë ditë mësuesja e re ishte si e shushatur nga ato që kishte dëgjuar prej drejtorit dhe nga pyetjet që i bënte vetes.

Për çudi të nesërmen e harroi takimin që kishte patur me të. Kur e kujtonte ndonjëherë, nuk tronditej aspak, siç i ndodhte një ditë më parë, po i dukej si një diçka e largët, pa rëndësi, që s'ia vlen ta sjellësh ndër mend.

Dhe vepronte në çdo rast natyrshëm, pa i lënë vetes ndonjë kufizim për sjelljen e saj si mësuese. Ajo nuk mund të sillej sipas ca rregullave të caktuara që më parë. Bile ca ditë edhe u mundua, por hoqi dorë, se i dukej sikur loste ndonjë rol në teatër.

Një ditë drejtori vajti për kontroll tek ajo në një orë mësimi aritmetikë.

Siç e kishte zakon, ai u ul në karrige mu aty, tek tavolina pasi hodhi një vështrim hetues në klasë. Pastaj vuri gjyslykët dhe shfletoi me radhë regjistrin, planin ditor e tremujor të mësueses, fletoret e detyrave të shtëpisë së nxënësve. Duke i parë me kujdes e pa u ngutur këto dokumenta, ai mbante edhe shënime në një radhua të trashë.

Mësuesja e re në fillim e ndjeu veten keq e u hutua. Pse vallë? Sepse ishte kontrolli i parë



apo sepse drejtori kishte zënë vendin e saj dhe nuk i vinte mbarë për të bërë veprimet e nevojshme? Kur kishte bërë praktikën pedagogjike, të gjithë sa kishin ardhur ta dëgjonin, — aty ish edhe drejtori i shkollës e mësuesit e saj, — kishin ndenjur në fund, prapa nxënësve. Kurse ky... Ja, ajo shënoi datën dhe mungesat duke ju dredhur duart ca nga tronditja e kontrollit të parë e ca ngaqë nuk i volitte vendi. Nga kjo e la për më pas temën e mësimit. Edhe gjatë mësimit ajo nuk e kishte në dorë klasën, nuk e tërhiqte dot në procesin e punës, sepse nxënësit kur e kur shihnin me kureshtje nga drejtori.

Tefta bisedonte për çdo çështje me mësuesit e tjerë, sidomos me ata të matematikës. Ata e kishin këshilluar që në ngjashmëri me problemet e tekstit, të krijonte vetë disa, me të dhëna konkrete nga kooperativa. Ajo që bindur shpejt se në këtë mënyrë problemet bëheshin më të qarta për nxënësit dhe, veç kësaj, lidhej edhe mësimi me jetën, prandaj e ndiqte vazhdimisht këtë praktikë pune. Atë kohë në fshat kishte nisur një fushatë e vërtetë për grumbullimin e plehrave organike të anëtarëve në dobi të kooperativës pa asnjë interes. Tefta s'e kishte lënë të kalonte në heshtje këtë fushatë për mësimet e saj. Kishte marrë ca të dhëna nga brigadierët dhe me këto të dhëna kishte krijuar disa probleme, njëren prej të cilave e shfrytëzoi atë orë që i vajti për kontroll drejtori.

— Siç e dini tha ajo — këto ditë anëtarët e kooperativës sonë po ja falin kooperativës plehrat organike të oborreve të tyre. Kjo tregon se ata e kanë kuptuar vlerën e pronës së përbashkët

dhe se i janë vënë me mish e me shpirt shtimit të drithrave, shtimit të prodhimeve bujqësore...

Drejtori i kishte lënë shënimet e tij, kishte hequr gjyslykët dhe po e vështronte mësuesen me habi. Kjo kujtoi se drejtorit po i pëlqente një hyrje e tillë dhe vijoi me zell:

— Deri tani janë grumbulluar 3.400 kv. pleh. Plehu është shpërndarë në parcela të ndryshme. Brigada e parë ka marrë 9 përqind më shumë pleh se brigada e dytë, kurse e treta 12 përqind më pak se e dyta. Sa kv. pleh organik ka marrë secila brigadë?

Kur mësuesja mbaroi pyetjen dhe po e shënonte atë në dërrasën e zezë, karrikja krisi e drejtori brofi në këmbë. Mësuesja qëndroi në pritje. Drejtori e shikoi rreptë, po s'foli fare. Ai e rrëmbeu fletoren e trashë dhe një libër aritmetike që kishte marrë me vete dhe doli nga klasa.

Natyrisht mësueses i bëri përshtypje të madhe një sjellje e tillë e papritur, po e zotëroi veten dhe vazhdoi mësimin.

Drejtori ndërkaq hyri në dhomën e mësuesve. E hodhi me inat fletoren mbi një tavolinë dhe tha me përbuzje:

— Mësim është ky? O kasolle, ku na mblo dhe! Ka dëgjuar bija e botës se mësimi duhet lidhur me aktualitetin dhe hop, na i mbush problemet me pleh! Dhe e vinte në gojë pa pikën e ndrojtjes. Ç'vulgarizim i tmerrshëm.

Mësuesja e re e pati vështirë gjatë analizës. Drejtori e paralajmëroi në mënyrë të prerë se do ta nxirrte nga klasa një herë tjetër, po të bënte një mësim të tillë, banal! Nuk harroi të



shënonte në «detyrat» për mësuesen që ajo të shkruante temën e mësimit në regjistër, t'i aktivizonte më mirë nxënësit, t'ua vinte notën e detyrës në anë të fletores e jo në mes e sa e sa çështje të tilla me rëndësi.«Fshatarja» po çuditej gjithnjë e më tepër dhe mezi e mbajti veten që t'i thoshte se këto vërejtje ishin vögëlsira dhe që për mësimin s'po bëhej fjalë fare. Për këtë analizë ajo bisedoi me mësuesit e tjerë.

— E pse të ka bërë kaq përshtypje? — pyeti njëri. — Drejtori kur vjen për kontroll do të bëjë edhe vërejtje.

— Të tilla vërejtje?

—Përse çuditesh?

— Por këto vërejtje s'lidhen fare me mësimin!

— Drejtori ynë ka borxh të të bëjë vërejtje. Lidhen apo jo me mësimin këtë shihe vetë!

Disa qeshën. Leni e shikonte me inat Teftën sikur desh t'i thoshte:«Pa ardhur mirë fillove të sesësh mend!»

— Nga ai që më vjen për kontroll e ndihmë, unë, pres diçka që të më vlejë për ta bërë mësimin më mirë, për t'u bërë mësuese më e mirë — tha Tefta, sikur të mos kishte dëgjuar ç'tha me shaka shoku i saj, pa i vënë rëndësi vështrimit përbuzës të Lenit.

— Gjykim shumë me vend! — tha njëri.

— Ç'farë «po» ...?

Drejtori ynë, moj çupë, është mësuar me një formë pune, që, si të them? Është vjetëruar! Ai kërkon rregull e përpikmëri në çdo rast. Ç'do gjë ai e sheh jo nga vlera e domethënies, po nga forma. A është i bukur ky send? Nëqoftëse po, është plotësisht i kënaqur, ndryshe.

— Po ju? — pyeti me habi mësuesja e re.

— Ne? Ne shikojmë punën tonë, përpigemi ta bëjmë atë sa më mirë dhe mundohemi të ruajmë edhe anën formale që kënaqet ai.

— Domethënë jeni pajtuar me këtë formë pune të vjetëruar, siç thatë vetë!

— Po të duash, mos u mëso! Ç'të bësh tjetër?

— Ç'të bësh, tjetër? Po sikur ta shkundësh ca atë drejtorin e vjetëruar?

Njëri shikoi me frikë nga dera, bile një tjetër vuri re me kujdes, ç'përshtypje i bënë Lenit këto fjalë. Po kjo bënte sikur s'e kishte mendjen aty, duke treguar mospërfilljen e saj, për mendimet e «fshatares». Dikush qeshi.

— Drejtorit tonë nuk i kthen dot fjalë. Ai s'pranon asgjë. «Ehu, — thotë, — ju keni qënë nxënësit e mi!». Ai nuk arrin dot kurrë ta kuptojë që një ish nxënës i tij të dijë baras me të. Ato që thotë ai, janë të peshuara e të drejta. Kështu mendon drejtori ynë.

— Tamam për këtë duhet shkundur një herë mirë e mirë. Por puna është se edhe ju...

Ishte një bisedë interesante, nga më të interesantet e më të guximshmet që ishin bërë deri atëhere në atë shkollë. Bisedohej për të mirën e punës. Njëri tha me shaka se duhej vetëm shkëndija që të ndizej zjarri. Dhe shkëndija ishte Tefta, mësuesja e re. Vetëm Leni nuk merrte pjesë në këto biseda. Kur ishte ajo edhe disa të tjerë nuk shpreheshin haptazi, sepse veç ajo bisedonte lirisht e kurdoherë me drejtorin dhe bile kishin shoqëri të ngushtë, sado që ndonjëherë bënin sikur ziheshin po që asnjëherë s'mbanin mëri më tepër se një ditë.



Ajo u mundua t'i jepte fund një bisede të tillë që u dukej fyese si për autoritetin e drejtorit ashtu edhe për atë vetë, duke kurdisur një tjetër. Se nga kishte marrë vesh që Tefta dashuronte një djalë nga fshati i saj dhe këtë e tha faqe të gjithëve: «Fshatarja» u skuq pakëz në fytyrë.

Tefta nuk dinte ç'është sekreti. Në fshatin e saj e njihnin si vajzë të çiltër e për të thoshin se «i kishte sahanet pa kapak». I kishin thënë se, sa më e fshehtë të qe dashuria, aq më e ëmbël ishte. Kur e provoi, ajo qeshi me tallje. Si mund ta mbante të fshehur dashurinë? Dëshira për fshehtësi tek ajo kishte zgjatur pak, shumë pak, sepse nga çasti në çast zemra po i mbushej me gëzim e kënaqësi dhe ajo ndjente nevojën t'i hapej dikujt.

Prandaj edhe këtu nuk i kundërshtoi fjalët e Lenti.

— Po, — tha — është e vërtetë.

— Po ai është fshatar?! — gati sa s'klithi Leni.

— E pastaj?

— Ti do të marrësh një fshatar që punon në kooperativë?!

— Pse, të duket një gjë e jashtëzakonshme ty?

— E jashtëzakonshme është vërtet. Ti je vajzë me shkollë, mësuese, kurse ai...

— Ai është punëtor, i zgjuar. Oh, t'i s'e njeh atë!

— Atë, po fshatare! S'thashë kot unë që sa të njoha!

Tefta u prek nga këto fjalë. Sytë e zes i lëvizën me shpejtësi e sikur i lëshuan shkëndia

kur ndeshen në ata të Lenit. Por e zotëroi veten e tha me seriozitet:

— Po, unë jam fshatare, por kjo s'më bën përshtypje. Unë kam njohur mjaft qytetare, mirëpo ato s'janë si ti. Ti ëndërron të martohesh me ndonjë doktor a inxhinjer që të banojë në Tiranë, fundja edhe në Korçë, po me kusht që të ketë një shtëpi të mirë me qylyma të shtrenjtë e perde të rënda, me pasqyra sidomos...

— Pse, keq është të ëndërrosh për një jetë më të mirë?

— Ka ëndrra e ëndrra. Edhe jeta e mirë është si ta marrësh. Ti do të vdisje nga turpi po të lidhje jetën me një fshatar, kurse unë jam e kënaqur sa s'bëhet. Për mua ka rëndësi që ta dua e të më dojë shoku i jetës. Mua do të më merrej fryma në atë dhomën komode, borgjeze, që ëndërron ti...

Kur dëgjoi fjalën «borgjeze» Leni kërceu nga vendi e zuri të fliste me nxitim duke e sharë «fshataren» që po i «bënte moral»! e që guxonte të thoshte gjëra të paqëna, se ajo, Leni, e urrente borgjezinë. Po Tefta tundi kokën e iku pasi i tha që, megjithëse urrente borgjezinë, mendonte e sillej tamam si borgjeze.

Të nesërmen Tefta po u ndihmonte nxënësve të saj për të larë klasën. I kishte përveshur mëngët, kishte vënë një përparëse dhe flokët i kishte lidhur me një shami të bardhë. Drejtori po shkante klasë më klasë. E pa Teftën midis nxënësve të klasës, u prish në fytyrë dhe u largua pa i thënë fjalë. Pas pak e thirri në drejtori.

Tefta vajti menjëherë.

— Ku hyn kështu? Ti e tërbon njeriun me



sjelljet e tua të pahijshme. Ku hyn pa trokitur? Ç'më ke ardhur kështu sikur do të korrësh.

— Përse më ke thirrur? — pyeti ajo pa ja vënë veshin inatit të tij.

— Përse të kam thirrur? Flet me ti, fare pa edukatë... ah! Ja, për këto që bën të kam thirrur! Sa herë ta kam thënë që të sillesh korrekt si mësuese që je? Ti vete e përvishesh sikur je pastruese.

Vajza s'foli. Ajo shikoi nga dera duke lënë të kuptohej se s'ja kishte ngenë të dëgjonte kësi bisedash. Drejtori kaloi në një temë tjetër.

— Kam marrë vesh se bën dashuriçka atje në fshatin tënd. Edhe ajo duhet! Unë nuk lejoj që në shkollën time të ketë mësuese imorale!

— Mbaj gojën, drejtor! Unë do të fejojhem me atë që dashuroj dhe s'kam ndërmend të të marr leje ty? — tha Tefta duke u dridhur nga inati.

Drejtori kërceu përpjetë.

— Të mbaj gojën, the?! — klithi.

— Po, të shikosh punët që të takojnë, jo të fyesh.

— Do të shohësh që kam për t'i parë. Dhe kam për t'i parë që ç'ke me të! Ja unë, ja ti këtu, ta dish! Pa ke filluar edhe të llomotitësh poshtë e përpjetë për mua! Ç'të bëmë ty këtu?

Sa doli ajo, drejtori i tha kujdestarit të ditës që t'i lajmëronte të gjithë për një takim me rëndësi. Mësuesët morën nga një fletore dhe zunë vend kush e kush më prapa në rreshtat e fundit të bangove të klasës. Ata ishin mësuar me takime të tilla dhe s'u bënë aspak përshtypje. Po Teftës ju drodh trupi. Kishte frikë? Jo, nuk kishte!

Por i vinte edhe turp edhe rëndë që do të bëhej një takim enkas për të, se ajo besonte që ky takim bëhej për të. Ajo ishte e re si në moshë, ashtu edhe në detyrë. Ndoshta e kishte gabim.

Por asaj ju kujtua se fjalët e saj i kishin përkrahur, kur kish thënë që drejtori duhej shkundur ca.

Ato ditë kishte lexuar dhe në shtyp një artikull me titull «A ka burokratizëm në arësim»? Ky artikull i «Zërit të Popullit» i kishte dhënë zemër e guxim. Ai i kishte sqaruar shumë gjëra që më parë s'i kuptonte dot. Tani e njihte më mirë drejtorin e saj, i cili, megjithëse rrinte gjithë ditën në shkollë, megjithëse përpiqej e bënte çmos për të mirën e shkollës, mësuesve u dukej i bezdisshëm dhe e ndjenin që i pengonte.

Pastaj këtë radhë Teftën do ta ndihmonin shokët e saj. A nuk e kishin lexuar edhe ata me interesim të madh këtë artikull. A nuk kishin biseduar me zjarr rreth problemeve që ngriheshin në të? Fundja, ajo s'kishte bërë asgjë të keqe. Ç'i duhej drejtorit të ndërhynte me të padrejtë në punët e saj personale? Pse ta fyente ai? Vajza e re hyri ngadalë në klasën ku do të bëhej takimi.

«Akulli u thye — tha me vete. — Por, po të lihet me kaq, ujërat do të pengohen aty e do të përmbytin vendin rreth e qark. Akulli duhet thyer edhe më tej që ujët të shkojnë lirisht në jaz».

Drejtori s'duhej aspak i nxehur si në drejtori. Duhej ta shihje me kujdes për të dalluar se ai damari i tij i tëmthave s'ishte qetësuar akoma dhe ngjante si një krimb që tkuret e zgjatet, po s'lot dot nga vendi.



— Ju thirra — filloi ai — se s'jeni gjëkund fare. Pezhishka kudo, baltë, pluhur, nxënësit mungojnë, gazetat e muret s'janë ndërruar. Po s'kini faj ju! Fajin e kam unë që ju kam lejuar të shini si të doni! Po!

— Këto ditë na vjen një ekip! Mua nuk më intereson se si do të bëni. Unë dua...

Si mbaroi rrebeshi i kërkesave në formë ul-timatumi, drejtori shtoi:

— Dhe shikoni, dikujt po i rritet mendja si shumë. Po!... E kam fjalën për Teftën! Ka filluar ta pastrojë klasën, po...

Tefta u ngrit. Ju kujtua artikulli i «Zërit të popullit». Tani ajo dinte si t'ja vinte emrin këtij drejtori. Dhe tha qetë-qetë.

— Mirë e the, shoku drejtor. Duhet të bëjmë një pastrim të plotë. Këtu mban erë myk. Myku duhet fshirë. Dhe bashkë me mykun, edhe vendi i molepsur prej tij.

— Jashtë! Dil jashtë! — thirri drejtori.

— Ajo ka të drejtë — tha një mësues.

— Po, — shtoi edhe një tjetër. Të tjerët, veç Lenit pohuan me kokë dhe drejtori e kuptoi se ata i jepnin të drejtën Teftës.

Tefta kish marrë zemër nga përkrahja e kolegëve të saj.

«Akulli u thye» — tha përsëri me vete.

E ndjente veten të fortë, të kënaqur e të gëzuar.

## SI MË DËSHTOI LEKSIONI...

Vjet në verë shkova edhe unë nëpër fshatra. Më kishin futur në një brigadë kulturele, dhe, me që e kisha gjuhën brisk, më caktuan të mbaj leksione ateiste. Të them të drejtën, m'u bë qejfi shumë do të mbaja leksione dhe e parafytyroja veten në mes të fshatarëve, duke folur si shkencëtar me një barrë mjekër, megjithëse akoma nuk më kish dërsur mustaqja.

Me këto ëndrra, në mbrëmje vonë arrita në fshatin Selishtë. Më caktuan në shtëpinë e Risto Pites, një plak mbi të gjashtëdhjetat, po i mbajtur si s'ka më mirë. U ulëm dhe, ndërsa Ristua mundahej të më kënaqte me ato që ju ndodhën, mua më rrihte tjetërkund mendja: doja ta mbaja leksionin e parë qysh atë natë, doja ta bëja ateist xha Riston para se ta ngopja barkun mirë...

Nisa të flas.

— E di që do ta mohosh xha Risto, po si fshatar i rritur në një ambjent fetar, edhe ti ke mbeturina, apo jo?

Për çudinë time xha Ristua m'u përgjegj:

— Kam sa të duash, o bir...

Nga kjo përgjigje mora kurajo dhe vazhdova:

— Këto mbeturina duhen zhdukur...



Xha Ristua qeshi:

— Duhën çkukur nga rrënjët thuj!

E pashë që e kisha nisur mirë. Do të korrja sukses që me leksionin e parë. Mezi më mbante vendi. Vazhdova:

— Ti, xha Risto, beson tek perëndia... Po a e di sa dëme i sjell njeriut besimi tek Zoti? E para e punës feja të shkëput nga prodhimi i të mirave materiale. Nuk të le të punosh, të prodhosh, të jetosh më mirë. Feja thotë mos puno se është Shën-Pjetri, rri nesër se është Shën-Gjoni... Njëmijë shenjtër e festa fetare, apo jo? Gjithë vitin duhet të rrish duarkryq e të vështrosh nga qielli.

Pasi flisja pak, ngrija sytë për të parë sa efekt bënin fjalët e mija tek xha Ristua. Ai më dëgjonte i qetë dhe tundte kokën. Unë merrja krahë dhe ja shkelja gazin ligjëratës.

— Priftërinjtë...

Kur thashë këtë fjalë dhe isha plotësisht i bindur se e kisha shkëputur një njeri nga kopeja e verbër e Zotit, xha Ristua lëvizi nga vendi dhe ma preu fjalën në mes:

— Djalë, pse ke ardhur këtu?

— Ja o xha Risto, do të mbaj ca leksione ateiste...

— Shumë mirë do të bësh, shumë mirë. Veç shko e falu në ndonjë kishë tjetër se ke ngatërruar derën.

Hapa sytë dhe e shikova i habitur. Mos vallë ish prekur që kisha zënë në gojë priftërinjtë? Desha ta pyes po ai nuk më la kohë.

— Po qe puna për priftërinjtë, unë di më shumë se ti. Jam ca më i vjetër e kam parë

më tepër. Tjetrit nuk i mbushet mendja me fjalët që ke mësuar përmendësh. E di qysh u mbushet mendja njerëzve?

— Si? — e pyeta plot interes.

— Ta dëftoj unë se qysh.

Xha Ristua nisi të flasë, unë e dëgjova në neshtje.

— Kam qenë ndo njëzet vjeç djalë kur na vdiq prifti i fshatit. Domethënë kjo që do të të tregoj ka ndodhur afro dyzet vjet më parë. Në vend të priftit që na vdiq, na erdhi një tjetër, nga një fshat fqinj. I thoshin Papa Tole. Ky Papa Tolja ish i zgjuar jo sa për njëqind engjëj, po sa për njëqind dreqër. E kish mendjen në të ngrënë e në të pirë dhe në të mbledhur rrangulla. Kur shkoje ta gjeje, ta pyesje për ndonjë hall apo për të të lexuar ndonjë letër që ta dërgonin nga larg, nuk të shihte në sy si gjithë njerëzit, po në duar: i kishe bosh apo plot. Makut hesapi.

Fshati ynë ka qenë punëtor i madh. Kur erdhi Papa Tolja, vuri re se të kremteve, në vend që njerëzit të shkonin në kishë, ashtu siç urdhëron i madh Zot, shkonin në punë. Ç'të keqe ka kjo, do të më thuash. Ka si nuk ka. Papa Toles nuk i vinte keq as për kishën që mbetej pa njerëz, as për njerëzit që nuk vinin në shtëpinë e perëndisë. E kish hallin gjetiu: duke shkuar në punë të kremteve, njerëzit nuk i çonin as para, as vaj e as meshë dhe prifti s'kish me se t'i ushqente dy dhi malteze që mbante pas vetiu. Se që ta dish ti shkoqur, Papa Tolja i ushqente dhite me bukë të bërë nga majë site, domethënë, me meshë. Dhe më plaçin sytë në të gënjej, dhite e



priftit pillnin dy herë në vit, kurse dhitë tona asnjëherë në dy vjet.

Si e mati nga të gjitha anët, Papa Tolja na foli një ditë e na tha:

— O mëkatarë! Jeni larguar nga udha e Zotit. Ejani në vete. Mos punoni të kremteve, po mblihdhuni në kishë, ashtu siç urdhëron i tërëfuqishmi dhe mos harroni porositë e tij se Zoti vonon, po nuk harron.

Si tha edhe ca fjalë të tjera, prifti bërtiti:

— Gjithë javën do të lutem, që po të punojë njeri ditën e shtunë, që bien të dyzet shenjtorët, Zoti ta ndëshkojë mirë e të venë mend edhe të tjerët. Mallëkimi rraftë mbi atë që punon ditët e kremte.

Kështu na mallëkoi prifti. Po mua nuk më mbushej kapllojja. Isha i ri, më ziente gjaku si ndozot ty, dhe kisha qejf të bëja të kundërtën e asaj që thonin të tjerët. Sidomos doja të bëja të kundërtën e asaj që thosh Papa Tolja. E urreja priftin, s'doja ta shikoja me sy. Ç'është e drejta, Zotin e besoja atëhere, po jo symbyllur si shumë të tjerë. Unë xheç kisha kënduar nëpër libra dhe më ishin hapur ca sytë

E bëra top mendjen: vendosa që ditën e dyzet shenjtorëve të punoja. Me këtë desha t'u thosha të tjerëve se fjalët e priftit ishin gënjeshtër. Si thashë ashtu edhe bëra: mora belin, futa sëpatën në brez dhe u nisa për në punë. Punova si kalë tërë mëngjezin dhe në drekë thashë të pushoja gjersa të thyente vapa. Vajta e u ula poshtë një lisi të madh. U freskova, hëngra bukë dhe u shtriva. Nga që isha lodhur, sytë m'u mbyllën në çast. I kisha bërë a s'i kisha bërë dy minuta gjumë kur

u zgjova i llahtarisur. Dikush më kish goditur me dru në kokë. Desha të ngrihem, po nuk munda. Dy vetë, të veshur si engjëj, me nga një kopaçe në dorë, po më binin ku të dhemb e ku s'të dhemb. I humba fuqitë e ndjenjat dhe nuk lëviza fare. Një nga ata engjëjt më derdhi në kokë ujët e matarasë sime. U përmënda dhe dëgjova si nëpër ëndërr një zë që thosh:

— Dolle nga udha e Zotit, o i mallëkuar! Punon edhe ditët e kremte që perëndia ka urdhëruar të festohen nëpër kisha anembanë botës. Zoti na dërgoi ne, dy engjëjve, të të sjellim në rrugë të mbarë. Na!

Dhe më ranë prapë sa më bënë peshk të njomë, themi ne këtej. Pastaj u zhdukën. Nuk pashë dot nga ikën e nga vanë. Kisha humbur ndjenjat.

Erdha në vete natën vonë, kur ish freskuar koha. Trupi më dhembte dhe ndjeja frikë. Dy engjëjt më kishin tmerruar: mund t'i kish dërguar Zoti me të vërtetë. Ndofta kish edhe Zot, megjithse librat që kisha kënduar thoshin jo. Mbase gënjenin librat...

Duke u mbështetur mbi bel, mora rrugën për në fshat. Ecë e ecë, më në fund arrita më të ngrysur. Kur dola nga rruga e madhe ku kish shtëpinë prifti e desha të futem në rrugicë, pashë dy veta që ecnin rrezave si hije. U fsheha dhe prita të kalonin. Kur ishin afër meje, njëri tha:

— Ishalla na thërret prifti të rrahim edhe ndonjë tjetër. Unë jam gati të rrah gjithë botën për para...

Tjetri ja priti:

— Mos folë se ka sy e veshë edhe dheu. S'ke çfarë thua... Na pagoi mirë urata.



— Plot na dha. Po sikur të na kish dhënë edhe nga një okë vaj, nuk do kish bërë keq.

Kaq thanë dhe u kthyen në një qosh.

Sa dëgjova këto fjalë në çast më ikën të dhëmburat dhe që atëhere m'u mbush mëndja top se nuk ka Zot. Librat paskeshin të drejtë. Më hipi një inat që nuk tregohet me gojë. Thashë nëpër dhëmbë:

— Ama këta qenkan engjëjt që më dërgoi perëndia? Prit, o Papa Tole, se do të ta shpërblej. Unë do të të dërgoj djajtë.

Arrita me gjysëm shpirti në shtëpi, ca nga plagët e ca nga marazi. U shtriva dhe më zuri gjumi top. Të nesërmen nuk u ngrita dot dhe thirra një fqinjë të më jepte të paktën një gotë ujë, se s'kisha njeri. Edhe i martuar nuk qeshë. Erdhi e shkreta fqinjë e më shërbeu. Sillej e sillej e diç desh të më thosh, po i vinte turp siç dukej.

— Ç'ke o Vanthi? — i thashë.

— Hiç gjë... , tha ajo.

— Nxirre të shkretën se ç'ç ke në zemër... , Dhe Vanthia e zbrazi më së fundi:

— Ke bërë gjynah, o Risto, dhe e pagove mirë. Nuk dëgjove priftin ndaj arrite në këtë derexhe... Të ngopën të dyzet shenjtorët me dajak. E ka marrë vesh gjithë fshati. Mua më vjen keq ndaj të shërbej, se ndryshe kam frikën e Zotit...

Qëndrova dy-tri ditë shtrirë, pastaj e mora veten dhe dola në fshat. Të gjithë më rrinin pak mënjanë e më vështronin me bisht të syrit. Unë qeshja me vete edhe me të tjerët dhe thosha:

— Mos u mërzitni se pas dyzet-shenjtorëve do të vijnë njëmijë dreqër!

Për engjëjt, për mua dhe për drurin që kisha ngrënë me urdhër të perëndisë, ishin thurur përralla. Ca thoshin kështu, ca thoshin ashtu. Një thosh se Riston e kishin rrahur dymbëdhjet engjëj që zbritën nga qielli dhe betohej për kokën e djalit të vetëm se i kish parë me sytë e tij. Një tjetër thosh se nuk ishin engjëj po dreqër... Çdo njeri fliste sipas midesë.

Fshati ziente e unë zieja. Prifti nuk ndihej fare. Fërkonte duart se ua kishte futur frikën njerëzve e dhitë do t'i ngopeshin me bukë gruri, qypat plot me vaj e portofoli me lekë. Prifti qeshte, unë haja veten me dhëmbë.

Nuk e lashë të ftohen gjakërat. Të enjten ish Shën-Triadha. U përgatita për këtë ditë.

Kur ranë kambanat, nga çdo shtëpi dolën njerëzit me meshë e me shishe plot vaj nëpër duar dhe u drejtuan për në kishë. Unë zbrita në kopësht, preva një degë ulliri të trashë dhe e rregullova bukur me një gollogungë në fund. Mora pastaj ca karton e bëra një maskë të mirë, me dy brirë të mëdhenj. E vura dhe u pashë në pasqyrë. Dukësia tamam si djall. Më keq akoma: si kryetar i dreqërve. Hodha edhe një rrobe të zezë në supe dhe prita sa erdhi mbrëmja.

Ish errur dhe nëpër rrugë nuk lëvizte njeri. Dola nga shtëpia. Eca hijeve e rrëzave dhe arrita tek shtëpia e Papa Toles. Ngjita murin dhe rashë në oborr. Prita pak aty prapa një turre me dru. Prifti doli me dhinë e me kecërit në oborr. Mbante një thes në krahë. U ul në një fron, nxorri thikën që e mbante në brez dhe priste meshë e ua hidhte dhive. Ajo hante e fërkohej pas rrasos së priftit.



Avash avash ju afrova dhe i dhashë një kopaçe në duar. I ra thika e mesha dhe u shtri sa gjatë gjërë. Nisi të bërtasë. Që të mos dëgjohej, i futa një shuk me lecka në gojë... Pastaj i dhashë ca stape të tjera. Kur u shtri pa ndjenja, mora musllukun që ish varur në mur dhe ja derdha në kokë. U përmënd më në fund dhe më shikoi i çakërdisur. I thashë:

— Jam kryedjalli vetë. Më kanë dërguar nga skëtërra që të të sjell në rrugë të mbarë, se ke dalë nga udha e Zotit. Kur të tjerët s'kanë as bukë misri për të ngrënë, ti i ushqen dhinë me bukë të gatuar me maja site. Naa!

Dhe ja mbështolla prapë. Prifti hapte sytë e më bënte shenja me duar. Po unë nuk mbahesha nga inati. Më së fundi më shkrepri një mendje... Po sikur ta nxirrja nëpër fshat që ta shikonin të gjithë? I thashë:

— Dëgjo këtu, o uratë! Nëqoftëse ti u dërgon të tjerëve engjëj të blerë me napolonë, Risto Pitja të dërgon dreqin vetë pa i dhënë asnjë grosh. Ngreu dhe ec përpara.

Prifti nuk ngrihej dot. M'u desh t'i jap dorën e ta branis rrugëve të fshatit. Kur rruga qe e keqe, më duhej ta mbaja në kurriz. Si ecëm e ecëm më në fund dolëm në shesh. Kafenetë ishin hapur, dëgjohej zhurmë e madhe. E tërhoqa priftin dhe u futa në kafenenë më të madhe. Atje po pinin e po luanin letra.

Kur hymë brenda, unë si djall e prifti gjysëm i vdekur, të gjithëve u ngriu gjaku. I qetësova dhe u thashë:

— E njihni këtë?

— Po! — thirrën ata të gjithë bashkë. —  
Është Papa Tolja.

— Emrin ja dini po poshtërsitë jo!

— Pse?!

— Tani urata do t'ju tregojë pse. Hajt folë!

Ja hoqa shukun me leckën nga goja dhe e shtyva përpara.

— Pa na thuaj cilët engjëj e rahën ditën e dyzet shenjtorëve, Risto Piten?

Prifti nisi të flasë gëc-mëc, se mezi merrte frymë.

— Ata që rrahën Riston nuk ishin engjëj po njerëz...

Na kafenë u dëgjua një: ah!

— Cilët ishin ata njerëz dhe nga ishin?

— Ishin Petro Nika e Josif Kici nga fshati fqinjë, nga Lajthishta.

— Sa i pagove?

— Nga tre napolona.

— Po pse i dërgove ta rrahin?

— Se... se...

— Po e them unë — thashë dhe ua tregova të gjitha ashtu siç po t'i tregoj edhe ty sonte. Ata qeshën të tërë dhe kush ish me çakërqef nisi ta ngacmojë:

— Uratë, po ty kush të ka bërë pelte?

— Djalli vetë... Ja ky këtu.

Unë hoqa nga supet rroben e zezë, flaka tutje stapin dhe hoqa maskën. Të gjithë u habitën dhe thanë:

— Ua, qenka Ristua!

Filluan thumbat e të qeshurat. Unë e mora priftin dhe e çova në shtëpinë e tij. Burrat që ishin në kafene dolën pas meje dhe shkuan në-



për shtëpi për të dhënë lajmin. Kudo ndezën dritat dhe gratë dolën nëpër dyer e nisën muhabetin.

Ndaj të gdhirë, kur të gjithë kishin rënë të flinin, prifti, duke tërhequr nga pas dhinë, duke u mbështetur në një shkop e duke mbajtur një thes në kurriz iku nga fshati dhe nuk u kthye më kurrë. Edhe ndonjë prift tjetër nuk na erdhi në fshat, siç duket nga frika. Kështu mbetëm pa prift për vjete të tërë.

\* \* \*

Kaq më tha xha Ristua atë natë dhe më shikoi duke qeshur. Unë ula kokën dhe pëshpërita:

— Paskam trokitur vërtet gabim në derën tënde... Erdha të të mbaj leksion unë ty, o xha Risto, po ndodhi e kundërta: më mbajte ti mua.

— Xha Ristua m'u përgjegj:

— Këtej nga ne i thonë ndryshe...

— Si?

— Erdhe për lesh e u ktheve i qethur!

Qeshën të dy. Unë qesha nga zorri se më kish dështuar leksioni i parë ateist, për të cilin isha përgatitur aq kohë dhe kisha thurur aq ëndërra të bukura.

## KRIJIMI

### Novelë

#### 1.

Skulptori i ri u ul buzë lumit. Vjeshta e kishte turbulluar ujin dhe i kishte zverdhur fletët. Lumi rridhte si gjithnjë në shtratin e vet ndanë shelgjeve dhe shqopeve, ashtu siç pat rrjedhur kur ai ishte edhe më i ri, kur lufta kishte kaluar plot zhurmë dhe kishte lënë në ndërgegjen e tij ato gjurmë që lë stuhia, kur tund e përmbys ç'gjen përpara dhe kur natyra, pemët, zogjtë, uji gjithçka pret të lindë dielli. Rridhte si në fëmininë e tij, kur vinin gjithë shokët e lagjes dhe laheshin fshehurazi nga më të mëdhenjtë. Rrëshqiste përjetësisht, sikur asgjë s'kishte ndodhur: brezat vinin e iknin dhe ai qëndronte po aty, bënte po atë lëvizje, sikur donte të tregonte madhësinë dhe qetësinë e tokës që e sheh jetën me gjakftohtësi dhe me gjerësinë e horizonteve. Ujët kalonte me një shushurimë të lehtë, qetësonjëse. Ishte mëngjez dhe skulptori, që sapo kishte mbaruar institutin në Tiranë dhe ishte kthyer në shtëpi, po sodiste mallet e murme, kodrat që vinin poshtë tyre, fermën



përkarshi, varrezat e dëshmorëve dhe uzinën që ndodhej aty afër. Po, jeta kishte ndryshuar dhe kjo zhurmë indiferente, kjo natyrë e palëvizshme, sikur tregonte më mirë se çfarë kishte ndryshuar, se ajo që ndryshon nuk është në sipërfaqe po në thellësi, brenda dallgëve, në rrymat e ujit, poshtë sipërfaqes.

Nga kjo ndjenjë e përgjithshme dhe disi e turbullt që i jepte frymëzim dhe e mbante aty buzë lumit, ndërsa thithte një cigare, ai kaloi në mendime të tjera, për punën që do të bënte. Kishte mbaruar institutin, pedagogët e kishin lavdëruar, i kishin thënë se ka talent, po ai e ndjente mirë se ato që kishte krijuar gjer tani ishin të zakonshme, ndofta të rëndomta, (pedagogët e përdornin shpesh këtë fjalë) dhe nuk i kishin dhënë atë kënaqësi të madhe krijonjëse, për të cilën shpesh flitet për artistët. Kur do ta ndjente një kënaqësi të tillë? A do të ishte vetëm kënaqësi, apo gjithmonë e përzjerë me ndrojtjen, ç'do të thonë kur ta shohin veprën, ç'përshtypje do të bëjë?... Ai kishte ende përvojë të paktë, po që tani e ndjente se, ndofta, gëzim më i madh dhe siguri më e madhe mund t'i vinte, po gjithmonë do ta shoqëronte ajo ndrojtja, ajo etapa përpara njerëzve, përpara atyre që me sy të rreptë, sado mirëdashës, kërkojnë të dalë në shesh e vërteta dhe arti t'i ngjajë medoemos jetës, asaj që shohim dhe që ëndërrojmë çdo ditë ose në çaste të rralla të jetës sonë. Pa këtë të vërtetë nuk mund të ketë art, mendoi ai. Pa këtë të vërtetë ne do të jemi gënjeshtarë dhe njerëzit do të kenë të drejtë të na shohin me përbuzje dhe mospërfillje. Sepse, kur del përpara njerëzve dhe u thua që unë dua të tregoj për ju të vërtetën në

art, që ju ta shihni, të gëzoheni dhe të thoni: «po tamam kështu është» dhe kur nuk e bën këtë po shpik ca gjëra të paqena, atëhere ata kanë të drejtë të të përbuzin.

Aty afër ishte balta argjiloze, bojëhiri, e butë e pastër. Balta dhe arka që skulptori kishte marrë me vete. Kësaj balte të qetë, të përjetshme, indiferente i duhej dhënë jetë. Jetë, mendoj skulptori, dritë, që njeriu të kalojë pranë dhe të mbajë këmbët, të ndjejë diçka, t'i bëhet një nyjë në grykë dhe të mendojë: po, ai ka qenë ose mund të ketë qenë njeri i mirë, e vlen barra qiranë ta mbash mend...

«Mjaft qëndrova buzë lumit dhe u freskova këtë mëngjez vjeshte — tha skulptori me vete, duhet filluar». Po nuk lëvizi menjëherë nga vendi. Shikoi malet, varrezën e dëshmorëve, psherëtiu dhe pastaj u ngrit... «Duhet t'i jap jetë Agos, partizanit të lagjes sonë, që vdiq duke u ndeshur me fashistët. Agua... Unë kam qenë shumë i vogël po ndofta e mbaj mend vërtet, apo. ngaqë më kanë treguar, më duket ashtu, ishte një djalë shumë i ri, i gjallë, flokëverdhe (flokët i binin mënjanë) me sy të mprehtë, që u thoshte shpesh shokëve: «Ç'të presim, t'u biem një sahat e më parë». Agua, që ishte i dashur me shokët, që nuk mësonte mirë në shkollë, që këndonte bukur labçe, që i pëlqente broshurat ilegale, të cilat shkonin atëhere dorë më dorë në grupet e edukimit komunist të rinisë. Agua, që ishte vrarë në fillim të luftës në një ndeshje të çetës së parë partizane të atij rrethi.

**Këto** i kishte dëgjuar skulptori dhe i dukej sikur i kishte jetuar, sikur e kishte ndjekur në çdo hap Agon. Kështu mendonte tani duke shi-



kuar baltën argjilore buzë lumit, atë baltë të pastër, të butë, bojëhiri që qëndronte gjithë jetën pranë lumit. Dhe, padashur, i shkuan nëpër mend monumentet që kishte parë në vendet historike apo nëpër libra, statujat e qeta, madhështore dhe të përsosura greke, romake dhe ilire, veprat mesjetare, ku përmes figurave kishëtare, përmes statujëve dhe shënmërive spikatnin sytë e mëdhenj tragjikë të njerëzve të periudhave të errëta, dëshpërimi i tyre i thellë dhe shpresa e heshtur në të ardhmen. Po, arti ishte gjë e madhe dhe të jesh artist, do të thotë të marrësh përsipër një barrë të rëndë, po aspak të frikshme. Malet e mëdha dhe kodrat i ngjanin një amfiteatri madhështor. Në këtë amfiteatër janë çfaqur shumë tragjedi, janë çfaqur skena heroike dhe të dëshpëruara, po me krenarinë dhe lartësinë e tij, ky pejzazh të zgjon më shumë heroizëm, ndjenja të fuqishme dhe të pamposhtura.

Frynte era e vjeshtës. Shelgjet fërfërinin. Aty më tutje edhe kavakët e drejtë, të lartë, përkundeshin, duke praruar me gjethe tokën e njomur dhe të murrëtyer.

Skulptori futi duart në baltë dhe zuri të mbushte arkën. Argjili ngjishej pas arkës si brumë i ardhur mirë. Ai punonte dhe ndjente kënaqësi. Duart e tij ishin të mëdha, të fuqishme dhe sytë i ndrisnin me një bukuri të çiltër, të thjeshtë.

## 2.

Skulptori e ngriti arkën në sup dhe mori rrugën për në shtëpi, në lagjen e poshtme të qy-

tetit. Arka e mbushur me baltë rëndonte, po ai ishte i fuqishëm dhe e mbante mirë, ecte lirisht, njëherë buzë lumit, pastaj xhadesë. Kalonte vetëm, më të rrallë haste ndonjë kalimtar që e përshëndeste ose e shikonte me kureshtje. Pesha nuk e mundonte, ishte i lumtur që po ja fillonte punës, që do të merrej me diçka të pavarur, që nuk do t'i qëndronte më mbi kokë ndonjë pedagog dhe që nuk do t'i kujtonin oreçast se ai ishte student, se detyra e tyre kryesore ishte shkollore, se prej tyre nuk kërkohej... Këto i dinte dhe i kuptonte, po tani duhej krijuar jeta, i duhej dhënë gjallëri baltës që qëndronte në arkën mbi supet e tij. Ai do ta bënte disa herë këtë udhë me arkën në krahë, do të mblidhte dhe do të ngjishte baltën, gjersa pastaj, në armaturën e ngritur, të fillonte krijimin e një jete sa të njohur aq edhe të panjohur për njerëzit.

Frynte erë vjeshte. Nga plepat ndanë rrugës binin gjethe, që fërfërinin me një zhurmë të lehtë, gazmore. Një tufë gjethesh ranë mbi baltën prej argjili dhe mbi supet e skulptorit. Vjeshta kishte ardhur me ngjyra të praruara bojë hiri e të murme, me një qiell përgjysmë të veshur e me fërshëllimën e vazhdueshme të erës, që frynte nga gryka.

Balta rëndonte, po ai ecte në xhade duke trokitur me këpucët e rënda. Ky brumë ishte materia e parë që do të merrte formën e Agos. Nga gatimi i tij varej gjithçka.

Para se të merrte të përpjetën drejt shtëpisë, ai deshi të çlodhej pak dhe vendosi të hynte në klubin e uzinës, aty ndanë xhadesë. Kishte



qenë edhe herë të tjera në këtë klub, ishte i vogël, po i gjallë: hynin e dilnin punëtorë, ndonjë fshatar që i binte rruga. Pinin kafe, raki, konjak e fërnet. Rrinin nga pak dhe iknin. Më shpesh në këmbë. Klubi nuk u ngjante atyre kafeneve, ku njerëzit ngulen me orë të tëra dhe nuk lëvizin.

E la arkën pranë një tavoline, në qoshe dhe u ul. Te banaku kishte pak njerëz. Tryezat ishin bosh. Porositi një raki, shkoi e nxori vetë dhe u ul përsëri në tryezë. Filloi ta pijë ngadalë. Rakia i dukej e shijshme.

— Paskeni raki të mirë! — i tha banakierit, një burri të shëndoshë, me mëngë të përveshura.

— E mirë është, — tha banakieri, duke i buzëqeshur. Kishte dëgjuar fjalë të mira, për këtë «artist» të ri dhe prandaj e shihte me simpati. Ky ishte djali i usta Mihalit, Gjergji. Në lagje dhe në qytet ata që e njihnin, thoshin se kishte dalë «pikturist», ca të tjerë thoshin se do të gdhendë si i ati, veç se i ati bënte mure e shtëpi, kurse ky ta nxjerr njerinë si të gjallë. «Qysh e nxjerrin a derëzi? — pyeste ndonjë plak, ndërsa rrinte në kafenenë e qytetit, në hijen e rapit. E shohin dhe ta japin të gjallë». «E more, — thoshte ndonjë më i regjur, — s'është gjë e madhe, e kanë mësuar nëpër libra, shohin si kanë bërë të tjerët, bëjnë edhe ata...» — «Jo, more, — ndërhynte ndonjë tjetër, më i mësuar, apo që e kishte dëgjuar nga djemtë, — Ajo është punë e madhe, duhet të jesh i zoti që të bësh atë punë.»

Skulptori pinte raki, shihte punëtorët që po hynin më shpesh tani në klub dhe herë pas here ja hidhte sytë baltës. Rakia ishte e fortë dhe filloi ta turbullojë pak, duke i zgjuar një ndje-

një të këndshme. Shqiptarët gjithmonë e kanë pirë rakinë, mendoj; këtë lëng të kulluar rrushi që shpesh duket si pika kristali. Ky lëng sikur fsheh brenda ndjenja të zjarrta, fjalë, këngë, zhurmë. Ky lëng është si një jetë e ngjeshur, e përqendruar, që mund të sjellë gëzim ose hidhërim. E shikonte si me habi gotën e rakisë dhe ndjente një entuziazëm që i vinte nga momenti i përfytyruar, nga mëngjezi i vjeshtës, nga balta dhe nga rakia.

— E ç'e ke atë arkë, more Gjergj? — e pyeti një punëtor që po ngrinte një gotë konjak te banaku. Ishin nga një lagje dhe njiheshin.

— Siç e sheh, me baltë, — tha Gjergji.

— Pse me baltë e kenë punën ju?

— Ashtu fillon, nga balta.

— S'e kam ditur. Hajde, ç'baltë e ngjeshur!  
— tha punëtori duke ju afruar.

— Ulu, merr një raki, — i tha Gjergji.

— Më ikën koha, po hajt të marr një.

Punëtori i uzinës u ul përkundrejt skulptorit, duke mos ja hequr sytë baltës. E pyeti se në ç'punë do t'i hynte. Gjergji i tregoi.

— E ju qenkeni si perëndia, nga balta bëni njerëz — qeshi punëtori, duke ngritur gotën me raki. Pastaj e çoku me të Gjergjit dhe uroi:

— Punë të mbarë, more djalë. Le të bëhet balta njeri. Njeri i vërtetë i tokës sonë që ta shohim dhe të çuditemi. Të themi që Agua jeton, Agua na sheh...

— Faleminderit, — tha skulptori, i prekur nga fjalët e tij.

Dëgjuan edhe të tjerë që kishin ardhur në klub dhe u mblodhën rreth arkës, duke parë me



një vështrim të qetë e solemn baltën bojë hiri, skulptorin e ri, që rrinte midis tyre me sy të ndritur dhe të qeshur.

— Punë të zorshme kanë, — tha dikush. — Këtu ka vetëm baltë, pa bëje të shohim njeri.

Sytë e të gjithëve u përqëndruan atje.

— Shiko, ta nxjerrësh mirë Agon! — tha njëri miqësisht.

Ata shikonin skulptorin dhe arkën. Ndofta mundoheshin të pëfytyronin monumentin e ardhshëm dhe i buzëqeshnin këtij përfytyrimi. I buzëqeshnin punës, krijimit, sepse ata të gjithë e dinin ç'do të thotë të sajosh diçka nga hiçi, të mos i ndahesh maqinës, detajit, veglës, gjersa ta shpiesh punën e nisur gjer në fund. Ata e shihnin me respekt këtë djalosh të ri të qytetit të tyre, që gjer para-disa vjetësh vraponte rrugëve, që po fillonte një punë të madhe. Ky vështrim i tyre, atë mëngjez vjeshte pranë uzinës, ndërsa era frynte dhe hidhte andej-këndeje gjethet e verdha të plepave që endeshin si në një valle gazmore, — ky ishte urimi më i mirë për punën që po niste.

### 3.

Shtëpia e usta Mihalit ishte e vjetër, po akoma mbahej mirë më këmbë. Sa herë e shikonte Gjergji shtëpinë e tij, si edhe shumë shtëpi të tjera të qytetit, sa herë ngrinte kokën dhe shihte strehët e dala, qemerët, penxheret me hekura e taraba, që i ngjanin si sy të trishtuar, muret e larta, i zgjohej në shpirt një ndjenjë e veçantë që e lidhte me vendlindjen, një ndjenjë e

turbullt që e gëzonte, e habiste dhe njëherazi e fuste në një dëshpërim të pakuptueshëm dhe të papritur. Ç'fuqi ka arkitektura, — mendonte ai, tani që ishte kthyer nga studimet — Shtëpia, qyteti, vendi i tërë, me mënyrën si është ngritur më këmbë, të fut në një atmosferë të caktuar. Ti shtang përpara tij dhe të zgjohen kujtime, të vijnë në mend gjyshërit, të afërmit, kohët e shkuara, mendon për mençurinë e tyre dhe për pasurinë shpirtërore që kanë pasur. I mendon këto, po muret e larta, penxheret, portat e mëdha, të mbyllura mirë, të sjellin në mend gjithashtu errësirën që kemi çarë e po çajmë, trishtimin e ditëve të dikurshme hijen e rëndë të jetës, vajtimet e vajzave pas tarabave dhe hekurave. Të rënda, të vrejtura, pa gaz në buzë duken këto shtëpi që shpesh mbahen të forta mbi shkëmbenj, buzë përroit e rrëzë malit...»

Brenda një shtëpie të tillë, ku fisi i tij kishte jetuar brez pas brezi (muratorë të zotët, që kishin ndërtuar me duart e tyre shumë shtëpi të qytetit), ai do të krijonte statujën e një partizani, diçka të re, madhështore dhe të gëzueshme që kishte dalë nga këto shtëpi, po që tani u takonte Shqipërisë, njerëzve, botës.

Në dhomën e sipërme të shtëpisë, në një dhomë të madhe nga veriu, që vinte e hapur përpara, me ca trarë të trashë e të vjetër, skulptori filloi punën. Ajo dhomë u shërbente si çardak, rrinin në verë, kur bënte vapë, ndernin këmishët. Në dimër ajo qëndronte më shumë e mbyllur.

Mëngjezeve Gjergji punonte në shkollë, ku jepte vizatim, pasdite punonte në shtëpi. Mendjen e kishte te statuja.



Si do të ishte ky partizan? Si do të vendosej balta që të mirrnin formë idetë, disi të përgjithshme gjer tani, në kokën e skulptorit? Mendimi i krijimit nuk i ndahej gjithë ato ditë e net, kudo që ndodhej, me këdo që bisedonte. Pyeti për Agon, pa disa fotografi të tij, po ai mendonte se nuk duhej hetuar e zbuluar shumë gjëra nga jeta e dëshmorit, sepse ai, fundja, do të bënte një statujë që t'i ngjante dëshmorit (kjo nuk ishte punë e vështirë), po më tepër do të mendohej të arrinte në një përgjithësim, të krijonte figurën e partizanit dhe në këtë, siç mendonte ai, mjaftonte më shumë, frymëzimi që kishte, dashuria për partizanët, zjarri që i vlonte përbrenda dhe puna këmbëngulëse që do të bënte. «Unë dua të bëj diçka të fuqishme një sintezë, skulptura nuk ka nevojë për hollësi të jetës së përditshme» — mendonte skulptori.

Dhe kështu filloi të bënte skicat e para gjersa arriti në një ide pak a shumë të formuar. Ai vendosi të krijonte figurën e Agos me kapotë, me kapellë partizane dhe me të dy duart të ngritura lart: në njërën dorë, të ngritur përgjysmë do të mbante një pushkë, ndërsa tjetrën do ta shtrinte lart në shenjë kushtrimi, me një gjest energjik, të dukshëm. Fytyra do të kishte forcë shprehëse, burrërore, goja do të ishte gjysmë e hapur (nuk duhej tepëruar me këtë detaj) që të kuptohej ideja e thirrjes, e kushtrimit. Dhe kështu do të dilte një monument i gjallë, energjik që do t'u zgjonte njerëzve ndjenja të forta. Bëri bocetin, në përgjithësi u kënaq me idenë e vet, dhe u bë gati të fillonte nga puna.

Mbi kavaletin filloi të bëjë armaturën —

kryqe prej hekuri, — zuri të mbërthejë copa dërrasash. Dhoma ishte e lartë dhe «skeleti» i njeriut të ardhshëm qëndronte atje lirisht, duke i dhënë asaj një pamje krejt tjetër nga ajo që kishite pasur gjithmonë. «Dhoma plakë po bëhet një atelie e mirë» mendoi me gëzim Gjergji dhe pastaj, për një kohë të gjatë u muar me ngjeshjen e baltës. Kjo punë e lodhshme ishte e domosdoshme. Herë pas here vinte nëna, e shikonte dhe i thoshte: «Të të ndihmoj edhe unë, more bir», po Gjergji qeshte dhe vazhdonte punën. Kurse i ati hynte ndonjëherë me kasketën e tij prej muratori, ulej në një fron, pinte cigare, i dridhte nga një edhe të birit dhe shikonte me vëmendje dhe respekt të fshehur punën e tij. Nga jeta e vet ai e dinte se puna e nxirrte njerinë në dritë, ja ajo punë që në fillim ishte e mërzitshme, e lodhshme, punë pa duk e që pastaj bëhej e gjallë e kuptueshme dhe plot bukuri.

Skulptori u ul pranë statujës së ardhme, ndezi një cigare dhe tërë entuziazëm, po edhe me shqetësim, mendonte punën që kishte përpara. Pastaj e hodhi cigaren jashtë, nga faqja e zbuluar e dhomës, dhe me stekë në dorë, zuri të vendoste baltë në armaturën e ngritur. Punonte me nxitim; balta kërciste dhe ngjishej pas hekurit, në dërrasa. Punoj disa pas dite me radhë, të dielave mbyllej brenda prishte, ndreqte përsëri, herë gëzohej herë shqetësohej, ndonjëherë binte në dëshpërim, po prapë e merrte veten dhe gjallërohej. Dalngadalë skulptura merrte formë. Midis baltës po shquanin tiparet njerëzore. Nganjëherë puna e vet i pëlqente dhe e entuziazmonte, po shpesh i dukej e vrazhdë, nuk i durohej sa ta përfun-



donte. Kishte çaste kur mendonte se përfytyrimi nuk puqej me atë që i delte në të vërtetë, po dora vazhdonte punën e saj. Më ndryshe, në ndryshe nga ç'kishte menduar ai, po i delte statuja. Herë pas here shihte fotografinë e Agos, po ai mundahej ta gjallëronte, t'i jepte një shprehje më të qartë e më energjike. Kur statuja nisi të merrte pamje të qartë, ndonëse më ndryshe nga ajo që kishte parafytyruar dhe që ëndërronte, ai e ndjeu veten të kënaqur. Më në fund, pas një pune të gjatë me ngulm dhe të vazhdueshëm, atij ju duk se po e shikonte një njeri — në dhomën e tij të fëminisë — po e shikonte Agua, siç ishte në fotografi, po më i gjallë, më me temperament, me një vështrim shqiponje, me duar të ngritura lart, me këmbë pak të hapura. Për një çast, kur u largua prej statujës, ndërsa po fshinte djersën në ballë, atij ju duk sikur ndjeu në dhomë thirrjen «Para partizanë!» Duhej akoma punë, por kryesorja ishte arritur. Mori frymë tërë kënaqësi, ndezi një cigare, doli në faqen e zbuluar të dhomës dhe u mbështet te një tra. «Kjo është puna ime e parë serioze» — tha me vete dhe mendoi suksesin e krijimit, të mbarimit të një pune që i kushtoi kohë, ndjenja dhe nerva. Gjithçka përjashta, në horizont, i dukej ndryshe: malet, lumi përkarshi, qiparisat e heshtur. Ishte gëzim të jetoje dhe të krijoje për këtë tokë, për këta njerëz. . .

Pas pak ai doli, thirri nënën (i ati nuk ndodhej në shtëpi). Nëna tërë gaz, që djali e mbaroi punën dhe do të rrinte më në fund i qetë, ngjiti shkallët, hapi derën dhe pa statujën e partizanit, të Agos. Ajo kishte parë vetëm disa statuja që

fshin vendosur në qytet, ca buste në lagje e në shkolla aty afër. E shikoi një copë herë. Gjergji e ndiqte me sy plot ethe, sadoqë nëna nuk dinte nga ato punë. Në fytyrën e saj, ai nuk pa asnjë lëvizje, asnjë emocion, vetëm përpjekje për të kuptuar diçka, për t'i hyrë disi brenda këtij njeriu që kish ngritur i biri e që dukej sikur shqetësohej, thërriste këtu në dhomën e madhe që kishte parë gjithmonë njerëz dhe sende të qeta.

Po ajo i buzëqeshi të birit, e përqafoi dhe i tha:

— Shyqyr që e mbarove. Bëfsh edhe të tjera.

Kjo e qetësoi disi Gjergjin, po prapë atij ju duk se mori një goditje në zemër nga ftohtësia e syve të nënës kur ajo e pa statujën.

Ai donte me çdo kusht të merrte vesh mendimin e të atit, ose më mirë përshtypjet e tij. Babai ishte njeri i përmbajtur dhe, si mjeshtër i vjetër, e ndjente dhe e kuptonte punën e tjetrit. Natyrisht, ai nuk jepte dot gjykime të qarta dhe të prera për vepra arti; por Gjergjit nuk i duheshin aqë fjalët e mira, se sa ai vështrimi pas kontaktit të parë me veprën e kryer, shprehja e fytyrës, rrëshqitja e mendimit në sy e në fytyrë, që shumë njerëzve u kuptohet pa shumë vështirësi.

Usta Mihali erdhi në shtëpi aty nga mbrëmja, pasi kishte pirë një kafe te kafeneja e qytetit; kaloi dalngadalë mbi kalldrëm, ngjiti shkallët e shtëpisë dhe, kur i tha i biri për statujën e mbaruar në argjil, nënqeshi. Veshi rrobat e shtëpisë, lau duart dhe me një gëzim të dukshëm për natyrën e tij të përmbajtur, u ngjit në dhomën e



sipërme. Usta Mihali, gjatë punimit të statujës, rrallë herë kishte hyrë në dhomën e punës, meqë edhe i biri nuk kishte qejf ta shihte ndokush vepërën të pambaruar. Ju afrua ngadalë statujës, me duar prapa, e pa me vëmendje të ekzagjeruar e dukej sikur çuditej, sikur nuk u besonte dot syve që djali i tij kishte bërë gjithë këtë punë. «Ky është si njeri i gjallë, djali i im ditka të punojë» — i shkoi ndër mend plakut, ndërsa e ndjeu veten krenar. «Po se ç'ka ky njeri, nuk është si ata partizanët që mbaj mend unë, thoshte me vete plaku, ndërsa i biri nuk ja ndante sytë. Se ç'ka... As Agos nuk i ngjan shumë, megjithëse Gjergji thotë se s'është nevoja t'i ngjajë krejt. Ndofta, këta e dinë. Po sidoqoftë Gjergji ditka të punojë...»

— Mirë më duket, more bir, me sa kuptoj unë. Shiko, pyet shokët e tu. Pyet ata që e mbajnë mend më mirë Agon... Po mirë e ke nisur...

Usta Mihali e pa të birin me sy të dashur dhe të ngrohtë; i ra krahëve lehtë. Gjergjit i pëlqeu vështrimi i t'et dhe fjalët, sadoqë, brenda syve të tij vinte re një dyshim të fshehur. Vetë i ati me fytyrë të gdhendur e si të rrahur nga dielli e nga erërat, i dukej si një statujë e gjallë, e thellë, me vështrim të brendshëm të përmbajtur, ndonëse pak të lodhur.

«Nuk i bëri ndonjë përshtypje të madhe, — tha më vete Gjergji, pasi mbeti vetëm në dhomë, ballë për ballë me krijimin e vet. — Unë shpresoja që kjo vepër t'i rrëmbente njerëzit me vështrimin e parë. Po ç'budalla që jam! Gjer tani e kanë parë vetëm prindërit. Ata nuk merren me

këto gjëra, dhe nuk mund të çfaqin entuziazëm si të tjerët, si shokët, si ata punëtorët që më përgëzuan te klubi, kur u mblodhën rreth arkës me baltë».

Nëna e thirri për të ngrënë darkën, po atij nuk i ikej që andej. Shoi dritën dhe u ul në një fron, në krye të dhomës. Qielli ishte i veshur. Hëna dilte më rrallë nga retë, pastaj humbiste midis tyre, duke u dhënë reve ngjyra të panumërtat. Ai u kthye prapa dhe pa përsëri siluetën e statujës, me duart e ngritura lart, gjoksin përpara dhe këmbët pak të hapura. I lindi një ndjenjë në fillim si e huaj, e rëndë, që ai desh ta sprapshte menjëherë. Partizani i krijuar prej tij, ju duk i largët, i panjohur, që ngrinte vetëm duart lart, thërriste, po as skulptori vetë nuk e dinte mirë ç'njeri ishte, përse e kishte ngritur atë pushkë lart. Ky mendim që i erdhi në kokë, në një hop, nuk mund të ndalej lehtë. Ai mori udhën e vetë. A e ndjente ai veten sonte, në këtë dhomë, se rrinte pranë me statujën e një njeriu trim, po të thjeshtë, që kishte botën e tij, të cilit kishte dëshirë t'i qëndroje afër, por edhe të bisedoje me të përzemërsisht, për luftrat, për trimërinë dhe për dashurinë e thjeshtë? Skulptori u tremb kur mendoi se vepra e tij nuk e kishte këtë gjë. .. «Por jo, — tha me vete, — këto janë dyshime të kota».

Gjithë atë natë Gjergji bëri një gjumë të shqetësuar. I dilte në ëndërr sikur hynte në dhomë një grup i madh njerëzish. Asnjë nuk fliste, e shihnin atë me inat dhe iknin si të zemëruar. Ju bë sikur partizani lëvizti nga vendi i nervozuar dhe erdhi rrotull nëpër dhomë e pastaj u



shndërrua në një Ago të vërtetë të gjallë. «E ç'më ke nxjerrë kështu, a derëzi, pse kështu kam qenë unë?» — i tha ai. U zgjua dhe e ndjeu veten në ankth. Duhej të merrte vesh sa më shpejt të vërtetën. Mos vallë e kishte bërë shumë shpejt veprën e tij thuajse të parë? Mos ishte mjaftuar vetëm me ca të dhëna të përgjithshme dhe nuk kishte vrarë mendjen për atë që do të rikrijonte, për jetën e tij, për shpirtin e tij? Mos e kishte nxjerrë padashur pak fodull e të kapardisur? Si mund të arrihej përgjithësimi i vërtetë pa ditur shumë gjëra? Mos ishte treguar në krye entuziast, me pretendime të mëdha, po, në të vërtetë, mendjelehtë? Këto mendime ai nuk i kishte pasur ndonjëherë në jetën e tij të shkurtër prej skulptori.

#### 4.

Të nesërmen shkoi menjëherë te shoku i Agos, të cilin e kishte pyetur më parë shpejt e shpejt dhe i kishte thënë se desh të takohej përsëri disa herë me radhë, po që mjaftuar me atë, sepse ishte nisur nga mendimi se s'ka nevojë, megjë do të bënte një përgjithësim, një sintezë. Tani desh ta takonte shokun e Agos, sepse sidoqoftë statuja ishte bërë për një hero të caktuar dhe duhej të delte karakteri i tij, sado që skulptori nuk merrej me fotografime. Veç asaj shoku i Agos i ishte dukur njeri që kuptonte nga arti. Ai kishte një punë me përgjegjësi në Komitetin Ekzekutiv të qytetit.

E takoi në zyrë. Ai e priti shumë mirë dhe

i tha se do të vinte pas ndonjë ore, sa të mbaronte diçka që kishte në dorë. U takuan në një kafene dhe që andej u nisën për në shtëpi të Gjergjit. Shoku i Agos e pyeti për usta Mihalín, foli me dashuri për punën e tij, për muret, për shtëpitë që ngrinte. Ecnin nëpër rrugë e nëpër rrugica. «Kështu pat ecur ky dikur, shumë vjet përpara, me Agon, doemos me hap të gjallë rinor — mendoj Gjergji. — Çfarë kanë biseduar me njëri tjetrin, përse kanë menduar?..»

— Punova me qejf, — tha Gjergji — po nuk di si do të më ketë dalë.

— Do ta shohim, — tha shoku i dëshmorit, me një nënqeshje dashamirëse.

Gjergji vuri re se ai ecte shpejt, pinte cigare pas cigaresh dhe përshëndetej me shumë njerëz në rrugë.

— E more, si u bë ajo puna jote... — i thoshte njërit. — E rini, si ja shpie? — i drejtohej me të qeshur ndonjë të kaluari në moshë.

— Kështu si ju ka qenë edhe Agua? — pyeti papritur Gjergji. Tjetri qeshi i kënaqur:

— Jo, ka qenë më i hedhur, më i qeshur. Ish-te një shok i zjarrtë — tha ai dhe, duke u menduar, rregulloi me njerën dorë flokët përgjysmë të thinjur.

Kur hapën portën e shtëpisë, skulptori ishte i shqetësuar dhe zemra i rrihte me forcë.

Shoku i Agos hyri brenda.

— E moj teto, si vete? — ju drejtua nënës së Gjergjit që nga praku. U ngjiti lart me të shpejtë. E shikoi statujën me vëmendje një copë herë. Ju kthye nga anë të ndryshme, e pa me kujdes. Mori frymë thellë.



— Eh, Agua... Ishte shok i mirë, — tha. U ul në një fron përkarshi figurës së heroit dhe ndezi një cigare. I dha dhe Gjergjit, i cili rrinte më këmbë tërë shqetësim.

— Si të them, mor shoku Gjergj, — tha pak, duke e shikuar në sy i menduar. — I hyre një pune të madhe dhe ka diçka të fuqishme, ka diçka nga energjia e tij. Po, ndofta, ata që e kanë njohur mirë nuk janë kurrë të kënaqur plotësisht. Dhe është e natyrshme... Nuk dua të ta thyej zemrën, sepse e shoh që ke dashuri për punën, për Agon e shokët e tij... Po...

Në këtë kohë hyri nëna, u dha kafënë, bisedoi pak dhe doli përsëri.

— Ju i dini më mirë punët e artit. Po dhe ne, mendoj se mund të themi një fjalë, sepse ju nuk i bëni për vete, apo jo?

— Kini plotësisht të drejtë.

— Ashtu është... Unë e kuptoj që nuk ka nevojë të bëhet kopja e një fotografie, që Agua duhet të të kujtojë partizanin? Po a ka dalë shpirti i tij, natyra e tij, a ka dalë, më në fund, partizani. Unë nuk kuptoj shumë, po më duket se jeni nxituar. Nuk keni menduar sa duhet dhe s'keni hyrë dot në botën e madhe të partizanëve, të komunistëve në atë kohë dhe, më lejoni t'ju them, edhe sot, sepse gjërat janë të lidhura. Unë dua të shoh një monument të Agos që të më dredhë, të më kujtojë atë kohë, atë thjeshtësi dhe madhësi të atyre njerëzve, atë heroizëm pa bujë dhe atë vështrim largpamës që na vjen edhe sot mu në zemër dhe na jep jetë... Ndofta kërkoj shumë, i dashur Gjergj, ti mos u dëshpëro, kështu e ka puna juaj. Ju kini të bëni me gjithë

popullin... Por unë kam besim se ju do të bëni vepra të mira.

Gjergji ishte zbehur. Thithte cigaren dhe rrinte kokulur.

— Ndofta kini të drejtë, — tha pas një pauze.

— Më kujtohet, Gjergj, — tha pas pak shoku i Agos, — kur delnim shëtitje me të, ditët e para të luftës. Lexonim ndonjë broshurë fshehurazi. Agos i shkrepnin sytë. Këndonte shumë. Kur dëgjonte këngë, vinte papritur, u hidhte krahët shokëve e niste edhe ai të këndonte. Bënte shpesh shaka. «Po të vritem unë, më thoshte me të qeshur, të më mbash një fjalim, ta qash fare». Sa të hidhura m'u dukën këto fjalë, kur u vra vërtet!... Do të të tregoj, more shoku Gjergj, me hollësi. Ti dëgjo. Të gjitha nuk do të të hyjnë në punë, po ti mblidh, fut në xhep ato që të duhen. Kur kalonim bashkë me çetën fshat më fshat, më fliste shpesh për shtëpinë e tij, për një man që kishte në oborr: nganjëherë, më të rrallë, për një fqinjë që e ndihmonte në punët e luftës, dhe sidomos për nënën... Ishtë njeri i butë, hokatar, po në luftë hidhej i pari, i shkrepnin sytë, tundte kapelën me yll dhe thoshte: «Eh, fashist, a t'u shoftë fara, prite shqipon se të erdhi...» Më kujtohet, më thoshte shpesh se, pas luftës, ëndërronte për një punë në qytetin e tij, desh të bëhej kovaç, se pat punuar ca kohë si çirak dhe i pat pëlqyer puna me hekurin. «Po do të punojmë për vete, — thoshte. — Nuk do të na urdhërojë njeri...» Kur u vra, unë u ndodha pranë tij. E mori një plumb në kraharor. I hapi pak sytë, më shikoi, më shtrëngoi dorën, buzëqeshi: «Më



vrinë, a u shofshin, — tha. — Nënës i thuaj të mos qajë...» Humbi përsëri, pastaj i çeli sytë dhe tha, pa e ngritur zërin, po me zëmërim të thellë dhe me nofulla të shtrënguara: «Fashizmi! Sa gjë e ndyrë... Mos e lini në Shqipëri farën e tij...» — Kështu ka ndodhur, or Gjergj.

Skulptori dëgjonte me sy të hapur, me emocion. A kishte një ndjenjë të tillë në veprën e tij? «Sa i thjeshtë është heroizmi, sa i thellë!» — mendoi ai dhe i shtrëngoi dorën shokut të Agos, duke e falënderuar për fjalët që i tha.

## 5.

Në mbrëmje u kthye prapë te dhoma, te froni ku ulej zakonisht. Pinte cigare, shihte natën vjeshtarake dhe horizontin e rrethuar nga malet. Padashur i kujtoheshin vepra të njohura skulpturale, buste, statuje, ansamble që të mbeteshin në mendje si një e tërë, e lidhur. Ato ishin vepra të thjeshta në dukje, të qeta, po ç'botë ndjenjash dhe mendimesh sillnin më vete, si të ngulitej ai vështrim i mermerit të ftohtë, i dy gropave të syve, në dukje, pa jetë, po që fshihte brenda një mendim të madh! Ju kujtuan vepra të mëdha botërore, vepra të skulptorëve tanë, të pedagogëve e të shokëve të tij. I erdhi në mend një kokë e zbuluar në Pojan, vështrimi i saj që çante largësinë e kohës dhe vinte gjer tek ne. Skulptura kishte qëndruar në dhe me shekuj, pastaj doli dhe, mbi atë vend të lartë e të bleruar, ku e kishin vendosur, shihte fushat, malet, duke sjellë pas vetes lashtësinë, fisnikërinë dhe

mendimin e thelluar e si të menduar para të fshetave të botës, para gjithësisë, lëvizjes, përpara ditëve dhe netëve që ikin dhe fshiheshin diku... «Skulptura e vërtetë duhet të ta zgjojë këtë ndjenjë mendonte ai. Ti sheh një perëndeshë greke, një skllav, një filozof, me vijat e lakuara të trupit, me harmoninë e përkryer të formave, me shprehjen e urrejtjes kundër tiranisë, apo me ballin e rrudhur nga pesha e mendimit dhe pas tyre të duket se sheh një qytet të tërë, se ndjen lëvizjet e njerëzve, ndjen kohën dhe ritmin e saj».

Të nesërmen nëna i tregoi se, gjatë kohës që ai ishte në shkollë, kishin ardhur ca plaka të lagjes për të parë Agon që e kishin dashur si djalin e tyre. Gjithë lagja e kishte marrë vesh, thoshte nëna e gëzuar. Plakat u mallëngjyen dhe e lëvduan Gjergjin. Pastaj zbritën poshtë dhe qëndruan për të pirë një kafe. Folën për Agon, ja kujtuan të gjitha punët dhe shakatë që bënte, kujtuan edhe nënën e tij që tani ishte në një qytet tjetër. Ky lajm e gëzoi Gjergjin, po sepse i la në shpirt dhe një trishtim të lehtë.

Për ca ditë me radhë, Gjergji thirri edhe shkollë të tjerë: një mësues të shqipës që e deshte dhe e kuptonte artin, atë punëtorin, me të cilin pinë bashkë te klubi dhe të tjerë. Ai kuptoi se fjalët e shokut të Agos qenë me vend dhe se vepra, ndonëse jo pa seriozitet dhe pa gjallëri, nuk i kënaqte njerëzit. Ndonjë e shpjegonte, ashtu si edhe ai vetë atë natë, ndonjë thoshte thjeshtë se nuk i ngjan Agos apo se nuk është nevoja t'i ngrejë të dy duart lart, se duhet të jetë më i qetë dhe më i thellë. Mësuesi i shqipës i tha:

— Të përgëzoi, Gjergj, për fillimin e punës.



Ideja si të thuash, është e guximshme. Unë nuk jam i zanatit, po piktura dhe skulptura më pëlqejnë. Unë mendoj se ne, si të thuash, na duhen vepra të ndryshme e, në radhë të parë, të forta, energjike, siç ke patur në mend të bësh ti. Po asnjëherë nuk duhet harruar se heroizmi ynë nuk duhet të jetë i sipërfaqshëm, deklarativ dhe pompoz. Ky Agua yt sikur kërkon ta vejë në pah trimërinë e vet. Kurse, si të thuash, nuk ka qenë kështu. Ti e kupton më mirë se unë, po një vepër skulpture ku bëhet thirrje për sulm, të më falësh, nuk duhet të jetë natyraliste, me fytyrë të egërsuar, gojë të hapur, gjoksin e dalë, dhe duart të ngritura sikur do të largohej nga toka. Heronjtë janë njerëz të thjeshtë të popullit, ata duhen njohur, duhet njohur mendimi dhe vepra e tyre dhe pastaj mund të krijohet për ta... Mës ma merr, si të thuash, për keq, — tha mësuesi i shqipes, — po unë dua të ta them hapët mendimin dhe kam besim tek ti se mund ta arrish këtë...

Edhe ky ishte një dush tjetër i ftohtë. Gjergji u mendua, u zemërua pak, po, duke ndjerë vështrimin e sinqertë të shokut dhe, mbi të gjitha, duke hyrë dalngadalë në të vërtetën e atyre fjalëve, e pa atë me mirëdashje e falënderim dhe i shtrëngoi dorën.

— Duhet nisur nga e para, — tha ai dhe sytë i qeshën dhe i ndritën përsëri si ditën kur mblo dhi baltën e parë argjilozë.

Përsëri do të qëndronte përballë asaj balte bojëhiri, të pastër, të butë, që gjëndeje ndanë lumit, — e ftohtë dhe indiferente. Duhet gatuar ajo baltë, mendoi ai natën në dhomë, pasi ikën shokët

—duhet gatuar me dashuri, me urrejtje, me ëndrra, duhet mbujtur me lotë e me pasion që edhe njerëzit të ndjejnë atë që ke ndjerë ti, kur e ke gatuar, kur ke qenë vetëm dhe ballë për ballë me të.





## L E N D A

	Faqe
Një betejë pa armë <i>M. Shtegtari</i> .....	3
Udha e bardhë <i>E. Mandia</i> .....	13
Rruga e ngushtë <i>F. Lubonja</i> .....	21
Bardha <i>F. Mullaçmeri</i> .....	37
Si një këngë që u këndohet trimave <i>V. Koreshi</i> ....	48
Burrëri <i>K. Kosta</i> .....	59
Një fjalim i shënuar për jetën time <i>I. Spasse</i> .....	69
Në kishim një rrugë <i>N. Thëllimi</i> .....	77
Dashuria për shokun <i>Gj. Ndojaj</i> .....	85
Shkolla e natës <i>Gj. Zheji</i> .....	93
Zëra në mjegull <i>T. Laço</i> .....	106
Tefta <i>P. Zoto</i> .....	118
Si më dështoi leksioni <i>M. Fsaka</i> .....	132
Krijimi (novelë) <i>D. Shaplllo</i> .....	142